



# BULETIN

Botim i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

Nr. 1, mars 2012

## DREJTËSIA GJINORE *Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit*

*Buletin i rasteve nga jurisprudenca e gjykatave kombëtare e ndërkombëtare,  
si dhe institucioneve të pavarura.*



*Empowered lives.  
Resilient nations.*



Ky projekt dhe ky botim u mbështetën nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe nga Qeveria e Suedisë. Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) apo të Qeverisë suedeze.

## **DREJTËSIA GJINORE**

### **Buletin**

#### **Botim i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare**

Nr. 1, mars 2013

*Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit.*

*Buletin i rasteve nga jurisprudenca e gjykatave kombëtare e ndërkombëtare, si dhe institucioneve të pavarura.*

#### **Përgatitën për botim:**

Prof. Dr. Aurela Anastasi, Drejtore Ekzekutive

Av. Aurela Bozo,

Av. Besa Saraçi,

Emira Shkurti (LLM) eksperte e UNDP

**Përktheu:** Svjetllana Anastasi, Simon Ziu

**Arti grafik:** BlueLine studio

© Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

**Adresa:** Rr. Vaso Pasha, Pall.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë.

Tel: +355 42259795; +355 42241914

Shtypur në shtypshkronjën “Dajti 2000”, Tiranë

Ky botim është publikuar edhe në faqen e Internetit të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare:  
[www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)

Botim i Qendrës për Nisma  
Ligjore Qytetare



**EDITORIAL:** Legjislacioni shqiptar në dimensionin gjinor dhe roli i shoqërisë civile për zbatimin e tij, me vështrim të posaçëm aksesin në drejtësi.

- Aurela Anastasi

5

## I. JURISPRUDENCA GJINORE KOMBËTARE. PRAKTIKA E QENDRËS PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

**1.** Kërkesë e Qendrës Për Nisma Ligjore Qytetare, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, me objekt: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 991/3, datë 02.03.2010, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, 'Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme"; Interpretimi përfundimtar i nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me zbatimin e ligjit "Për taksat kombëtare", mbi bazën e parimit të aftësisë paguese.

9

**2.** Gjykata Kushtetuese e RSH. Vendim nr.7, dt. 27.02.2013.

17

**3.** Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Informacion. Drejtuar Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi zbatimin e nenit 113 të Kodit Penal të RSH.

24

**4.** Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi. Rekomandim nr. 49, dt. 13.02.2012, për shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal

26

**5.** Informacion. Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi, për shkeljen e ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" si dhe të ligjit nr. 9970 datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", nga Ndërmarrja CEZ shpërndarje sh.a., Drejtoria rajonale Tiranë, dhe Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë.

27

**6.** Vendim i Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë, "Për Lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes".

30

## II. JURISPRUDENCA NDËRKOMBËTARE

### Vendime të Komitetit të CEDAW-t.

**1.** V.K. kundër Bullgarisë, Mbrojtja nga dhuna në Familje.

33

**2.** A.S. kundër Hungarisë, Mbrojtja e shëndetit riprodhues të grave.

45

Botim i Qendrës për Nisma  
Ligjore Qytetare**Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)**

**1.** Gratë, shtatzënia, ndërprerja e shtatzënisë; shëndeti; jeta private. A-ja, B-ja dhe C-ja kundër Irlandës.

48

**2.** Gratë, dhuna; jeta private. A kundër Kroacisë

50

**3.** Gratë, dhuna; jeta private; liria & siguria. Hajduova kundër Sllovakisë

50

**4.** Detyrimi pozitiv i shteteve për të ngritur dhe zbatuar me efektivitet një sistem penal që ndëshkon të gjitha format e marrëdhënieve seksuale me dhunë. M.C kundër Bullgarisë

51

**5.** Personat me aftësi të kufizuara ; seancë dëgjimore korrekte; detyrimet pozitive. Farkas kundër Rumanisë

53

**6.** Diskriminim; lëvizje; migracion; jetë familjare. Kiyutin kundër Ruisë

54

**7.** Arsimimi; feja. Lautsi & Orsi kundër Italisë

55

**8.** Liria & siguria. arrestimi; trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës. Kharchenko kundër Ukrainës

58

**9.** jeta; liria & siguria; tortura; mjetet juridike. Carabulea kundër Rumanisë

59

**10.** Jeta, vetëvrasje. Tsintsabadze kundër Gjeorgjisë

60

**11.** Lëvizje; azil; jetë, trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës; mjete juridike; M.S.S kundër Belgjikës dhe Greqisë

61

**Vendime të Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale (KEDS)**

**1.** Strehimi; jeta familjare; Qendra e të drejtave për strehim dhe dëbime kundër Italisë

63

## Editorial

### LEGJISLACIONI SHQIPTAR NE DIMENSIONIN GJINOR DHE ROLI I SHOQËRISË CIVILE PËR ZBATIMIN E TIJ, ME VËSHTRIM TË POSAÇËM AKSESIN NË DREJTËSI.

Një sërë lëvizjesh shoqërore dhe institucionale të zhvilluara në 10 vitet e fundit në Shqipëri, kanë çuar në përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e barazisë dhe të mosdiskriminimit e në mënyrë të veçantë, të barazisë gjinore. Vlen të përmendet miratimi i një pakete ligjesh që logjikisht plotësojnë njëri-tjetrin në këtë fushë. Është fjala për ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri” (2008), ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (2006) (i ndryshuar), ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (2010) etj. Gjithashtu, ndryshime të rëndësishme i janë bërë Kodit Penal të Republikës, i cili u amendua me disa dispozita të reja që forconin mbrojtjen nga dhuna në familje dhe parandalimin e saj, me një vështrim të posaçëm mbrojtjen e fëmijëve.

Të gjitha këto ligje ishin produkt i bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, si dhe mbështetjes së donatorëve dhe partnerëve të qeverisë e shoqërisë civile. Në këta të fundit, do të përmendja veçanërisht, UNDP dhe UN Women, USAID, Komisioni Evropian, OSBE-ODHIR, Qeveria suedeze, ajo holandeze etj. Ky bashkëpunim i gjerë, ka qenë një faktor i rëndësishëm për parapërgatitjen e institucioneve dhe të shoqërisë shqiptare, që jo vetëm t'i mirëpresë këto ligje, por të jetë e gatshme për ndryshim, duke i zbatuar ato. Madje, miratimi i ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", përfaqëson rastin e vetëm të një ligji shqiptar mbi nismën ligjvënëse popullore, prej më shumë se 20000 mijë zgjedhësish, e cila është parashikuar si një opsion i rëndësishëm i demokracisë së drejtpërdrejtë, në Kushtetutën e Shqipërisë.

Gjatë hartimit dhe miratimit të ligjeve të mësipërme, është shfaqur hapur një farë skepticizmi, në lidhje me mundësinë e zbatimit të tyre. Për këtë ka pasur përgjithësisht, debate të gjera me grupet e interesit dhe profesionistët e sistemit të drejtësisë. Ky dyshim, buronte sidomos nga fakti se, ato konsideroheshin më tepër si ligje që i imponoheshin shoqërisë shqiptare në kuadrin e përjasjes së legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare, se sa si ligje për të cilat shoqëria shqiptare ka pasur nevojë realisht. Në fakt, duhet të themi se të dy faktorët e mësipërm kanë bashkëvepruar me njëri-tjetrin. Natyrisht nuk mund të mohojmë nevojën për të përbushur standardet, por njëkohësisht duhet të themi me zë të lartë se, shoqëria shqiptare ka pasur dhe ka shumë nevojë për to.

Sidoqoftë, kjo situatë duket se u përballua, por nuk ka përfunduar ende, pasi mund të themi se e kemi fituar betejën nëse këto ligje gjejnë zbatim real. Shoqëria civile dhe shteti shqiptar ndodhen sot përpara sfidave dhe nevojave për zbatimin e këtyre ligjeve. Një nga drejtimet kryesore është mënyra se si qytetari shqiptar do të përdorë dhe do të kërkojë të drejtat e parashikuara nga këto ligje, gjë nga e cila do të varet edhe aksesin e tyre në drejtësi. Kjo është arsyeja që e gjithë puna e shoqërisë civile, të mos mbetet vetëm e fokusuar në ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të qytetarëve, por në mbështetjen e tyre duke përdorur të gjitha mjetet që njeh ky legjislacion për organizatat e shoqërisë civile me “interesa legjitimë”, me qëllim aksesin në drejtësi të qytetarëve.

Duke dashur të përmbledh disa çështje, të cilat ne i konsiderojmë në punën tonë si kontribute të reja që këto ligje kanë sjellë, shënojmë si vijon:

**Së pari**, përmes tyre u rregulluan ligjërisht një sërë institutesh të reja për zbatimin e parimeve

kushtetuese të barazisë dhe mosdiskriminimit. Të tilla, janë: masat kundër dhunës, instituti i padisë publike, barazia formale dhe ajo substanciale, diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, përshtatja e arsyeshme, listë të hapur të shkaqeve për mosdiskriminim. Sidoqoftë, në asnjërin prej ligjeve të sipërpërmendura nuk u arrit të parashikohet i ashtuquajtur i instituti i “përmbysjes së barrës së provës”. Deri me daljen e këtyre ligjeve, këto koncepte njiheshin vetëm në kuadrin e doktrinës dhe teorisë të së drejtës, por nuk zbatoheshin në dhënien e drejtësisë. Megjithatë nuk ka asnjë vështirësi për zbatimin e tyre sot, pasi për të kuptuar mënyrën e zbatimit në drejtësi të tyre, një ndihmesë të veçantë na jep jurisprudenca e gjykatave Ndërkombëtare, veçanërisht e GJEDNJ, GJED, Komitetit i CEDAW, etj.

**Së dyti**, në saje të këtij legjislacioni të miratuar rishtazi, u zgjerua aksesin në organet e drejtësisë dhe u krijuan organe të pavarura dhe të specializuara. Do të përmend këtu, veçanërisht Komisionerin antidiskriminim, si një organ i pavarur i administratës publike me funksione *quasi* gjyqësore. Gjithashtu, këto ligje sollën rritjen e aksesit në drejtësi edhe në saje të parashikimit të detyrave të reja për gjykatat dhe organet e tjera ndihmëse të dhënies së drejtësisë (P.sh., urdhrat e mbrojtjes, padia publike, kërkimi në gjykatë i dëmshpërblimit për rastet e diskriminimit etj.).

**Së treti**, u bë e mundur të institucionalizohet bashkëpunimi midis organeve të pushtetit qendror e vendor, me organizatat jofitimprurëse. Këto të fundit u parashikuan si organizatat me interesa legjitime, të cilat mund të paraqesin çështje përpara organeve shtetërore dhe të bëjnë kërkesëpadi përpara gjykatës, në emër të personave të diskriminuar ose viktimave të dhunës. U rritën mjetet ligjore të organizatave të shoqërisë civile për të vënë në lëvizje organet e drejtësisë, përfshirë edhe organet quasi-gjyqësore, siç është Komisioneri antidiskriminim, ose ato të administratës publike.

### **Për sa më sipër, cilat janë rezultatet që kemi?**

Në lidhje me zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, duket qartë një rritje e dukshme e denoncimeve dhe e kërkesave në gjykatë për urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes. Vetëm gjatë vitit 2011, në të gjithë Republikën, pranë policisë ka pasur 2181 denoncime, nga të cilat janë marrë në mbrojtje me urdhra mbrojtjeje 1345 raste. Le të kujtojmë se në vitin 2008, gjashtë muaj pasi ligji kishte hyrë në fuqi, ka pasur gjithsej pranë policisë rreth 822 denoncime dhe 377 urdhra mbrojtjeje. Ndihma e shoqërisë civile ka konsistuar, jo vetëm në ndërgjegjësim e tubime, por edhe në ndjekjen e rasteve konkrete, duke synuar krijimin e praktikave të reja në gjykatë dhe zbatimin e afateve ligjore nga kjo e fundit. Nga ana tjetër një kontribut i rëndësishëm i shoqërisë civile është edhe studimi për herë të parë i kostove të zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje, i cili do të përmirësojë problemet e buxhetimit gjinor në këtë kuadër, si dhe do të zbardhë më mirë vlerën dhe efektivitetin e punës së aktorëve që punojnë me zbatimin e këtij legjislacioni.

Në fakt, nuk premtojnë ende të njëjtin impakt në lidhje me aksesin në drejtësi, dy ligjet e tjera të paketës, ai i barazisë gjinore dhe ai antidiskriminim. Në lidhje me to kemi mundur të shpiem gjatë dy viteve të fundit, vetëm pak raste në gjykatë. Megjithatë, raste mjaft të rëndësishme janë paraqitur përpara Komisionerit kundër diskriminimit, kërkesat përpara të cilit mendoj se duhet të rriten e intensifikohen. Në krahasim me Komisionerë në vende të tjera mendoj se kërkesat e shoqërisë civile ndaj Komisionerit, janë të pakta. Kjo, edhe për faktin se mjaft nga konceptet me të cilat operon ky organ, në bazë të ligjit, hasin me kundërshtitë e tabutë e krijuara në realitetin shoqëror. Këtu duhet të mbahet parasysh se disa raste mund të paraqiten edhe përpara Avokatit të Popullit, për mbrojtjen nga diskriminimi, që vjen nga organet e administratës Publike. Në lidhje me këtë gjendje:

**Së pari**, ende ka nevojë për njohje të instituteve të reja të këtyre ligjeve dhe për një rritje të profesionalizmit, veçanërisht të avokatëve dhe të juristëve që punojnë pranë shoqërisë civile. Problemet e diskriminimit gjinor ekzistojnë, por në pak raste personat i evidentojnë ato dhe në

aq më pak raste, i drejtohen gjykatës. Veçanërisht problemet e diskriminimit gjinor ndeshen në çështjet e pronësisë e të trashëgimisë, në çështjet e punësimit dhe të kontributeve, etj. Sidoqoftë, ato kanë fituar një farë legjitimiteti në shoqëri, gjë që i bën kategoritë e ndryshme të diskriminuara të bashkëjetojnë me to, pa i konsideruar si çështje për t'u denoncuar dhe për të kërkuar dëmshpërblimin. Gjithashtu, duhet theksuar se kërkesa në gjykatë për këto raste konkretizohet dhe kurorëzohet vetëm me kërkesën për shpërblimin e dëmit. Por, mentaliteti në shoqërinë shqiptare, përbën gjithashtu, një pengesë për aksesin në drejtësi. Ai mund të përmblihet mirë nga një shprehje e urtë popullore e shqiptarëve, sipas së cilës: "Jeta dhe nderi nuk blihen me para". Natyrisht ka edhe arsye të tjera sociale, si frika nga shantazhet ose përndjekja e paditësit/ses. Kjo frikë ekziston si, kur punëdhënësi është organ shtetëror, edhe kur është person fizik a juridik privat.

**Së dyti**, pengesat që sjellin taksat e larta gjyqësore në këtë rast, edhe pse ato nuk janë shkak i vetëm dhe nuk përbëjnë pengesë për aksesin në Komisionerin antidiskriminim. Sipas dispozitave të ligjeve, të gjitha mundësitë në drejtësi për zbatimin e ligjit për barazinë gjinore në shoqëri dhe mosdiskriminimin, lidhen me kërkimin e dëmshpërblimit. Ky komponent është sanksionuar edhe në një sërë konventash dhe aktesh ndërkombëtare. Por, duket se ka krijuar një kundërshti të madhe fakti që nga njëra anë, shteti shqiptar është angazhuar seriozisht të përmbushë detyrimet që vijnë nga këto akte ndërkombëtare, ndërsa nga ana tjetër, me dispozitat e fundit nënligjore ka rritur në mënyrë të paarsyeshme detyrimet për gjykatën, veçanërisht në paditë për shpërblimin e dëmit. Kështu, legjislacioni përkatës parashikon për paditë për shpërblimin e dëmit, me vlerë të objektit të padisë mbi 100000 lekë, një tarifë prej 3% të vlerës së kërkuar. Ndërkohë që, ato me vlerë të objektit të padisë deri në 100000 lekë kanë një tarifë gjyqësore 1%. Nga ky fakt, shkelet parimi i proporcionalitetit, i cili është një nga parimet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarit. Pra, sa më i madh dëmi i shkaktuar, aq më e madhe tarifa për të paraqitur kërkesën, aq më i ulët aksesin në drejtësi. Pengesë sjell edhe fakti që të gjitha këto tarifa paguheshin paraprakisht dhe paditësi nuk ka asnjë akses për shqyrtimin e kërkesëpadisë.

**Së treti**, mendoj se disa pengesa për aksesin në drejtësi lidhen edhe me çështje procedurale, të cilat në pamje të parë duken shumë teknike, por nuk janë pa rëndësi. Zbatimi i ligjeve "Për barazinë gjinore në Shoqëri" dhe "Për mbrojtjen nga diskriminimi" nuk do të sillnin për gjyqtarin vështirësi nga pikëpamja materiale, por edhe nga ana procedurale. Qendra jonë, gjatë ofrimit të përfaqësimit ligjor të grave dhe vajzave përpara gjykatës, është përpjekur që të kërkojë nga kjo e fundit, ndjekjen e procedurave më të favorshme për palët dhe qytetarët, me qëllim që çështjet teknike e procedurale e debatet mbi to, të mos shndërrohen në pengesa për një proces të rregullt gjyqësor, brenda afateve të arsyeshme dhe për më tepër, të mos shndërrohen në një mundim pa fund dhe përmbyllje të gjykimeve pa dobishmërinë e duhur.

Në pamundësi për të trajtuar të gjitha problemet, mendoj ta përmbyll fjalën time me disa konkluzione:

1. Ka nevojë për vëmendje të veçantë nga ana e shoqërisë civile, për rritjen e fatësimit të saj, për përdorimin e të gjitha mjeteve që ligjet dhe kushtetuta u kanë njohur organizatave të shoqërisë civile, në emër të qytetarëve, në kërkimin e të drejtave të tyre.
2. Ka nevojë të rritet dhe të forcohet bashkëpunimi, midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Avokatit të Popullit, Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo presupozon jo vetëm dërgimin e rasteve dhe të problemeve të identifikuara nga ana e shoqërisë civile, por edhe ushtrimin e presionit ndaj tyre, që jo vetëm të dalin me vendime efektive, por edhe të ndjekin zbatimin e këtyre vendimeve.
3. Organizatat e shoqërisë civile në përgjithësi dhe ato të grave në veçanti, kanë nevojë të forcojnë përgatitjen e tyre profesionale, me qëllim krijimin e kapaciteteve për parashtrimin e kërkesave e të ankesave, apo të kërkesëpadive, jo vetëm pranë gjykatave

kombëtare, por edhe pranë gjykatave ose institucioneve ndërkombëtare, si CEDAW, Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut, etj.

4. Nevojitet bashkëpunimi i shoqërisë civile me dhomat e Avokatisë, asaj Kombëtare e atyre të rretheve, për trajnimin e Avokatëve dhe krijimin e specialistëve në këtë fushë, me qëllim që të kualifikohen dhe të shpien çështjet e barazisë gjinore përpara gjykatave dhe institucioneve të tjera.
5. Nevojitet bashkëpunimi i shoqërisë civile me Shkollën e Lartë të Magjistraturës, me qëllim nxitjen e trajnimit të gjyqtarëve e prokurorëve me çështjet e zbatimit të këtyre ligjeve, e veçanërisht, të ndryshimeve të reja të Kodit Penal.
6. Gjatë punës sonë, mund të evidentojmë edhe nevoja për ndryshime ligjore, por mendoj se për këtë kemi nevojë të krijojmë edhe disa përvoja gjyqësore, përpara se të arrijmë në konkluzione të sakta dhe të evidentojmë mirë problemet që bëhen pengesë, për zbatimin me efikasitet të këtij legjislacioni.



# I. Jurisprudenca gjinore Kombëtare. Praktika e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

## 1

### KËRKESË DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE TË RSH, ME OBJEKT:

*Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë nr. 991/3, datë 02.03.2010, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme"; Interpretimi përfundimtar i nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me zbatimin e ligjit "Për taksat kombëtare", mbi bazën e parimit të aftësisë paguese.*

**Kërkuese:** Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

**Data e kërkesës:** 18 Korrik 2012

#### Baza kushtetuese:

1. **Kushtetuta e RSH**, (ligj nr. 8417, dt. 21.10.1998, i ndryshuar), neni 155, neni 118, neni 18, neni 42/2, neni 54/1, neni 59.1/e, neni 131/a/c, neni 124/1, neni 134.1/f.
2. **"Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas"**, konventa e Cedaw-t, Ratifikuar me ligj nr. 7767, dt. 9.11.1993, neni 2/c.
3. **"Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile e politike"**, aderuar më 4 Tetor 1991, neni 3/a dhe neni 14.
4. **"Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut"**, ratifikuar me ligj nr. 8137, dt. 31.7.1996, neni 14, neni 13, neni 6/1.
5. **"Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar"** (neni 25, pika 2), dhe **Protokollin e Trafikimit në plotësim të saj**, "Mbi

parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht të grave dhe fëmijëve" (neni 6/6), ratifikuar me ligjin nr. 8920, dt. 11.07.2002.

6. Ligji nr. 8577, dt. 10.02.2000 **"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH"**.

**Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)**, paraqet kërkesën me objektin e sipërshtuar dhe parashtron si më poshtë vijon:

**Lidhur me subjektin që paraqet kërkesën:** Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) është një Organizatë Jofitimprurëse, me statusin ligjor "Qendër", e regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, nr. 8, dt. 06.11, 2001, fillimisht, e emërtuar si "Qendra Avokatore për Gratë". Më pas, me vendim të organeve drejtuese, ajo është mbiquajtur "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare", ndryshim i cili është depozituar në Gjykatën e Shkallës së I-rë, Tiranë, me vendim 8/1, dt. 14.12.2004.

Që nga viti 1996, kur kjo Qendër u krijua si një projekt i Shoqatës së Grave Juriste, ajo ka ofruar këshillime ligjore, përfaqësim në gjykatë dhe pranë institucioneve qendrore e vendore, veçanërisht për gratë e vajzat e dhunuara, si dhe për ato që nuk kanë mundësi financiare të mbrohen me avokat. Ajo ka pasur dhe ka si qëllim të veprimtarisë së saj: *"Të ofrojë ndihmë ligjore, pa shpërblim, për shtetas të varfër, në mënyrë të veçantë për gratë e varfra e të dhunuara, përfshi këtu edhe vënien në dispozicion të një avokati për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, deri në shqyrtimin përfundimtar të tyre, pranë policisë, prokurorisë, pranë Gjykatës Kushtetuese, ose në gjykata ndërkombëtare, si dhe ndërmjetësim për të realizuar të drejtat e këtyre shtetasve pranë organeve të administratës publike apo të pushtetit vendor..."*

Për sa më sipër, në përputhje me objektin dhe misionin e veprimtarisë së saj, "Qendra për

nisma ligjore qytetare” konsideron mbrojtjen e të drejtave njerëzore, në veçanti të grave dhe vajzave, si interesa të vetë organizatës. Gjithashtu, për kategoritë më të varfra, Qendra ka qenë e aftë të marrë përsipër edhe shpenzime të ndryshme që nevojiten për mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore. Kështu, në zbatim të projekteve që parashikojnë zërin përkatës, Qendra është e detyruar të paguajë shpenzime të nevojshme për tarifa të administratës gjyqësore, për prokura e veprime të tjera noteriale, tarifa të Zyrës së Përmbarrimit, etj.

Për sa më sipër, jemi në gjendje të provojmë me anë të dokumentacionit përkatës se, *kërkesa që paraqesim është e lidhur gjerësisht dhe ngushtësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë me interesat kushtetuese dhe ligjore të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare*. Në këtë mënyrë kjo kërkesë, është proceduralisht korrekte në bazë të nenit 134, pika 1/f dhe 2 e Kushtetutës së RSh.

### **Lidhur me objektin e kërkesës, parashtrjëmë:**

**Situata ligjore.** Hyrja në fuqi e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, shfuqizoi ligjin “Për sistemin e taksave në RSh” të vitit 2002, në të cilin ishin parashikuar taksat mbi aktet gjyqësore. Ai solli ndryshime të rëndësishme në klasifikimin e detyrimeve financiare të qytetarëve për gjykatën dhe organet e tjera ndihmëse të drejtësisë. Ligji “Për taksat kombëtare” (2008), i konsideroi këto taksa, si tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore, të barazvlefshme me “taksat mbi aktet”, të sanksionuara në Kodin e Procedurës Civile. Ky barazvlerësim u bë shprehimisht nga një udhëzim i dalë në bazë e për zbatim të këtij ligji, pra, nga udhëzimi nr. 13, dt. 12.02.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore...”. Në pikën 5 të tij, vendoset: “*Termi ‘tarifë’, në pikën 8 të shkronjës A të shtojcës 1, ka të njëjtin kuptim me termin ‘taksë mbi aktet’, i përdorur në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile*”. Por, ky udhëzim vendosi njëkohësisht, masa të reja të tarifave për veprimet e shërbimet që kryhen nga administrata gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria dhe Noteria. Në përgjithësi, këto tarifa rezultuan të dyfishuara në raport me “taksat mbi aktet” të vendosura në lidhjen 5 të ligjit “Për sistemin e taksave të RSh”, të vitit 2002.

Më tej, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë, bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 11 të Ligjit, nr. 10065, dt. 29.09.2009, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, ka nxjerrë Udhëzimin nr.991/3, datë 02.03.2010, ”Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02,2009, “**Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme**”. Sipas këtij udhëzimi, në harkun kohor të një viti, masa e këtyre tarifave u rrit disa herë më shumë.

Në praktikën e përditshme të punës sonë për përfaqësimin në gjykatë të personave në pamundësi ekonomike, kemi konstatuar se ky fakt, ka sjellë pengesa e vështirësi të dukshme për realizimin e eksesit të tyre në Gjykatë. Le të marrim një shembull: në lidhje me paditë e zgjidhjes së martesës, në bazë të ligjit “Për taksat Kombëtare” të vitit 2002, taksa korresponduese ishte 1500 lekë, në udhëzimin nr. 13, dt. 12.02.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore...”, dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, tarifa korresponduese për kërkesëpadinë e zgjidhjes së martesës, u bë 3000 lekë. Vetëm një vit më pas, në bazë të udhëzimit që kërkojmë të bëhet objekt gjykimi, ”Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, “**Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme**”, kjo tarifë u rrit plot 3 herë, pra u bë 9000 lekë.

Akoma më i vështirë bëhet aksesimi në gjykatë për viktimat e krimeve të dhunshme për të cilat kërkojmë shpërblimin e dëmit material e moral. Për një padi për kërkimin e dëmit, me vlerë mbi 100 000 lekë, viktimat, duhet të paguajë një tarifë të barabartë me 3% të vlerës së dëmit të kërkuar. Duhet thënë se në kushtet aktuale, jo vetëm viktimat, por edhe Qendra jonë, është vulnerabel për të paguar një shumë të tillë. Parashikimet ligjore nuk lehtësojnë nga detyrimet financiare as viktimat e krimeve të dhunshme që kërkojnë dëmin material, me padinë civile në procesin penal.

Nga interpretimi literal i Ligjit dhe Udhëzimit në fjalë, nuk kemi asnjë mundësi të kuptojmë logjikën ekonomike mbi të cilën janë mbështetur

organet kompetente për rritjen e këtyre tarifave deri në këtë masë. Së paku, ne nuk arrijmë të dallojmë asnjë lidhje shkakësore midis ndryshimeve ligjore dhe ndryshimeve të tarifave përkatëse.

Paraprakisht, parashtrijmë se Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", neni 11, pika c dhe ligji nr. 10065, dt. 29.09.2009, "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", neni 3 pika 2, si dhe Udhëzimi nr. 991/3, datë 02.03.2010, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, "**Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme**", nuk janë në pajtim me Kushtetutën e RSH.

Por, kërkesa aktuale që Qendra për Nisma Ligjore Qytetare po paraqet përpara jush për gjykim, ka për objekt vetëm shfuqizimin e udhëzimit në fjalë dhe, interpretimin përfundimtar të nenit 155 të Kushtetutës. Kjo, për arsye se nuk jemi përpara afateve procedurale për të kërkuar edhe shfuqizimin e ligjit "Për taksat kombëtare".

**Analiza Kushtetuese.** Udhëzimi nr. 991/3, datë 02.03.2010, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, "**Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme**", nuk është në pajtim me Kushtetutën e RSH. Në lidhje me këtë parashtrisë paraqesim argumentet që vijojnë:

### 1. Në lidhje me nenin 155 të Kushtetutës së RSh,

Në pjesën e 13 të Kushtetutës së RSh, mbi "Financat Publike", Neni 155 sanksionon se: "**Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligjit nuk mund ti jepet fuqi prapavepruese**". Ne mendojmë se kur kushtetutvënësi thekson se "lehtësimi ose përjashtimi prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare i kategorive të caktuara të pagesve, caktohet me ligj", në fakt, ka dashur të afirmojë një parim të rëndësishëm e të njohur kushtetues, parimin e aftësisë paguese, ose siç quhet ndryshe atë të aftësisë kontribuuese. Në Kushtetutat e vendeve anëtare të Bashkimit

Evropian, si Gjermani, Itali e Francë, ky parim është afirmuar qartë si një parim kushtetues në detyrimet financiare të shtetasve. Kështu, p.sh., në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës Italiane, afirmohet se, "**Kushdo duhet të kontribuojë në shpenzimet publike, në raport me të ardhurat e tij**". Në bazë të këtij parimi, përcaktohen edhe kufijtë e aftësisë paguese. Në themel të parimit të aftësisë paguese qëndron kërkesa: asnjë subjekt nuk mund t'i kërkohej një detyrim financiar superior, nga ai që i është dhënë në mënyrë të drejtë nga *aftësia ose zotësia e tij për tatim*.

Është e vërtetë se në Kushtetutën e RSh, parimi i aftësisë paguese nuk është shprehur në mënyrë të hapur. Megjithatë, fryma që përshkon të gjithë legjislacionin fiskal në tërësi, është e tillë që na jep të kuptojmë se një parim i tillë, është i pranishëm.

Përmes rezervës ligjore absolute që ka parashikuar në nenin 155 të saj, Kushtetuta e RSH ka sanksionuar dy parime themelore që përshkojnë të gjithë sistemin fiskal në Republikën e Shqipërisë, parimin e ligjshmërisë dhe atë të aftësisë paguese. Kështu, mbetet detyrë e ligjvënësit që, me ligj të miratuar nga Kuvendi, të përcaktojë edhe detyrimet financiare për shërbimet gjyqësore, përmbarimore, noteriale, etj. mbi bazën e aftësisë paguese të subjekteve. Ose, së paku, midis detyrimit financiar që sanksionohet në aktin përkatës ligjor dhe aftësisë paguese, duhet të ketë një lidhje logjike. P.sh., një nga tarifatat të shërbimeve të administratës gjyqësore që rezultojnë shumë e lartë dhe e papërbalueshme, është masa e tarifës për paditë me objekt shpërbllimin e dëmit me vlerë mbi 100 000 lekë. Ajo është e barabartë me 3% të vlerës së kërkuar në objektin e kërkesëpadisë. Ne mendojmë se në këtë rast nuk ka logjikë ligjore masa më e madhe e kësaj tarife, në raport me objektet e kërkesëpadive të tjera. E themi këtë, pasi shqyrtimi i kërkesëpadive të këtij lloji nuk sjell asnjë ndryshim në veprimet e shërbimit që jep gjykata në këtë rast. Veprimet procedurale që do të kryhen janë të njëjta, prandaj nuk justifikohet një tarifë shërbimi më e lartë. Nëse qëllimi i ligjvënësit ka qenë të tashmë të ardhurën që pala kreditore fiton në përfundim të gjykimit, kjo nuk ka asnjë lidhje me tarifatat që paguhen paraprakisht, por lidhet me tatimin mbi të ardhurën që merr pala kreditore në kuadrin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të Gjykatës.

Subjektet lëvizëse që mund të paraqesin këtë lloj padie në gjykatë janë nga më të ndryshmet. Paditësit/et mund të jenë viktima të krimeve të

dhunshme, të papunë, të aksidentuar, etj., Pra, nuk ka logjikë juridike edhe nga pikëpamja e aftësisë së tyre paguese.

Edhe detyrimi për parapagimin e tarifës për një objekt të tillë kërkesëpadie, nuk ka bazë juridiko-kushtetuese. Kjo bëhet më e qartë kur gjykojmë mbi të drejtën e paditësit për të kërkuar si dëmshpërblim, një shumë në proporcion me dëmin e pësuar, p.sh., në rastin e dëmit material. Madje, në rastin e kërimit të dëmit material kërkesa është e bazuar mbi aktet që provojnë realisht, humbjet e pësuar. Pra, logjika juridike e kërkon që masa e dëmit të jetë në përpjesëtim të drejtë me masën e dëmit të pësuar. Por, vendosja e masës së tarifës në përqindje, në proporcion me shumën e dëmshpërblimit, do t'i vendoste në raporte të zhdrejta ose joproportionale subjektet e dëmtuara, në raport me aksesin e tyre për të kërkuar dëmshpërblimin. Pra, nga ky udhëzim përfitojmë këtë disproporcion: Sa më i madh të jetë dëmi i pësuar nga veprimet e kundërligjshme, aq më e madhe është barriera për t'iu drejtuar Gjykatës dhe aq më i ulët bëhet aksesin qytetar në organet e drejtësisë, për të kërkuar shpërblimin e këtij dëmi. Kjo kundërshti e bën dispozitën në kundërshtim me Kushtetutën, e cila mbështetet në parimet kryesore si, pandashmëria e të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe detyrimi i organeve të pushtetit publik për të kontribuar në realizimin e këtyre të drejtave (neni 15 i Kushtetutës).

Vlera e rritur e tarifës, për paditë që kërkojnë shpërblimin e dëmit, e cila shkon deri në 3% të dëmit të kërkuar, nuk është në përputhje me kushtetutën, parë në raport me standardet ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato evropiane në veçanti. Dëmshpërblimi dhe aksesin në organet e drejtësisë në lidhje me të, po konsiderohet gjithmonë e më tepër nga aktet ndërkombëtare, si një element i qenësishëm i vetë dhënies së drejtësisë. Kështu, Shqipëria ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare universale dhe rajonale, të cilat sanksionojnë detyrimet e shteteve që të sigurojnë mjetet dhe procedurat e përshtatshme për të siguruar kompensimin për dëmin që u është shkaktuar. Kështu, në *Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar* (neni 25, pika 2), parashikohet sa më sipër kur sanksionohet shprehimisht: “Çdo shtet palë duhet të vendosë procedurat e duhura, të cilat do të sigurojnë mundësi kompensimi dhe zhdëmtimi për viktimat e veprave penale të përfshira në këtë Konventë”. Ky detyrim është shprehur edhe në

nenin 6/6 të Protokollit të trafikimit, në plotësim të saj.

Në këtë frymë janë edhe një sërë Konventash evropiane, të cilat janë ratifikuar nga Shteti shqiptar. P.sh., Konventa Evropiane “Për dëmshpërblimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, ratifikuar me ligjin nr. 9265, dt. 29.07.2004; Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9642, datë 20.11.2006 (neni 15/3,4). E njëjta logjikë vepron edhe në kuadër të Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11.5.2011 (neni 29, 30), e cila është nënshkruar nga Shteti shqiptar, në pritje të ratifikimit të saj.

Rritja e tarifës gjyqësore për kërkimin të dëmit në këtë rast, nuk përputhet aspak me detyrat që duhet të përmbushë Shqipëria, që të sigurojë aksesin e viktimave ose trashëgimtarëve të tyre, për të kërkuar dëmin material e moral të ardhur nga veprat e dhunshme. Faktikisht, në rastet e ndjekura nga avokatet e Qendrës sonë, kemi pasur disa raste të heqjes dorë nga kërkimi i dëmit të ardhur nga vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe dy procese të mbetura të papërfunduara për këtë shkak.

Një disproporcionalitet kushtetues krijohet në kuadër të zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare në bazë të akteve të sipërpërmendura. Pra, ndërsa aktet ndërkombëtare kërkojnë nga shtetet që të marrin të gjitha masat për të rritur aksesin e viktimave për të kërkuar dëmshpërblimin, mjaft më e lartë është barriera financiare për kategoritë e kërimit të shpërblimit të dëmit, pra aq më i ulët është aksesin në organet e drejtësisë së këtij target grupi. Në këto kushte, logjika e ligjit që cakton një tarifë shumë më të lartë, lidhur me masën e dëmit të kërkuar, nuk qëndron. Ajo bëhet një pengesë dhe barrierë e padiskutueshme për aksesin qytetar në organet e drejtësisë. Për më tepër, një qëndrim i tillë i legjislacionit shqiptar e konsideron një përfitim dëmshpërblimin, ndërkohë që vjen në kundërshtim me frymën aktuale të standardeve ndërkombëtare. Këto të fundit, e konsiderojnë kompensimin e viktimave si aspekt të rëndësishëm të dhënies së drejtësisë, krahas ndëshkimit të fajtorëve.

Në lidhje me sa më sipër, edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka paraqitur Ministrin të Financave, Z. Ridvan Bode, një Rekomandim Nr. Dok. 201000938/3, mbi bazën e ankesës së Qendrës

për Nisma Ligjore Qytetare. Në pikën 2 dhe 3 të të cilit thuhet shprehimisht: “Të revokohet nr.991/3, datë 02.03.2010, ”Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02,2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe të saktësohet në aktet e reja në mënyrë përfundimtare kuptimi i taksës gjyqësore, duke parashikuar një kategorizim të saj, bazuar në ta ardhurat vjetore të paditësit/paditëses”.

*Pra, nga interpretimi literal, logjik e teleologjik i dispozitave të mësipërme, konstatojmë se, Udhëzimi që kërkohet të bëhet objekt gjykimi, nuk është hartuar në përputhje me parimin kushtetues të aftësisë paguese. Udhëzimi e ka anashkaluar ose shmangur këtë parim, për të cilin ne mendojmë se është në Kushtetutë, pavarësisht se nuk shprehet me të njëjtat fjalë. Udhëzimi ka sanksionuar detyrime financiare uniforme, pavarësisht nga statusi ekonomik i subjekteve. Nga ana tjetër, masa e tarifave të vendosura është bërë pa një kriter ekonomik e juridik, ose së paku nga analiza e masave të tarifave nuk arrijmë të identifikojmë ndonjë parim a sistem në përputhje me logjikën ekonomik-juridike.*

*Për sa më sipër, mund të themi se Udhëzimi nr. 991/3, datë 02.03.2010, duke shmangur parimin e aftësisë paguese, është i papajtueshëm me nenin 155 të Kushtetutës. Për këtë është e nevojshme që Gjykata Kushtetuese të kryejë edhe interpretimin përfundimtar të nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me parimin e aftësisë paguese, me qëllim që ajo të evidentojë qartë se, ky nen ka shprehur pikërisht këtë parim kur ka sanksionuar se, “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare e vendor, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj...”.*

## **2. Në lidhje me nenin 155, në bashkëveprim me nenin 118 të Kushtetutës.**

Duke shqyrtuar më tej përmbajtjen Udhëzimit që kërkohet të bëhet objekt i gjykimit Kushtetues, na rezulton se ky akt nuk është hartuar në përputhje me parimin e ligjshmërisë, që buron nga kuptimi i rezervës ligjore të parashikuar nga neni 155 në bashkëveprim me nenin 118 të Kushtetutës. Në nenin 118/2 të Kushtetutës sanksionohet se, “...2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve

*nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte...”.*

Neni 11/2 i Ligjit Nr. 10 065, dt. 29.01.2009, “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9975, dt.28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, vendos: “Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse”. Pra, sikurse shihet nga përmbajtja e këtij neni, ligji ka autorizuar nxjerrjen e akteve nënligjore, ka përcaktuar organin kompetent, çështjet që duhet të rregullohen, por nuk ka përcaktuar parimet në bazë të të cilave duhet të nxirren këto akte. Mungesa e këtyre të fundit, krijon një deficit të madh për një zbatim kushtetues të nenit 155 të Kushtetutës, nga udhëzimi objekt shqyrtimi. Kjo është arsyeja që nuk arrijmë të identifikojmë ndonjë sistem të logjikës juridike, ose ekonomike, ose juridiko-ekonomike në lidhje me masën e tarifave të vendosura.

Gjithashtu, ligji mund të kishte përcaktuar vetë, edhe kategoritë që lehtësohen apo përjashtohen nga këto detyrime tatimore. Këtë e ka bërë për disa nga llojet e taksave të Republikës së Shqipërisë, por në asnjë rast nuk e ka bërë për taksat mbi aktet ose për tarifatat e shërbimeve të administratës gjyqësore, të Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ne mendojmë se këtu nuk është fjala për një ometim legjislativ, por për një mohim të parimit të aftësisë paguese, parë që në asnjërin prej redaktimeve të ligjit “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, që nga viti 2002, nuk ka pasur përjashtime e lehtësime për këtë kategori të detyruarish financiarisht. Për rrjedhojë, edhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 991/3, datë 02.03.2010, ka dalë në zbatim të një neni ligjor të paplotë, duke mos zbatuar parimet kushtetuese që përbëjnë thelbin e marrëdhënieve që rregullojnë.

*Përsa më sipër, arrijmë në konkluzionin se Neni 11/2 i Ligjit Nr. 10 065, dt. 29.01.2009, “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9975, dt.28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr.991/3, datë 02.03.2010, ”Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02,2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të*

*pasurive të paluajtshme”, nuk respektojnë nenin 155 të Kushtetutës në bashkëveprim me nenin 118 të saj, duke shkelur parimin e ligjshmërisë.*

### 3. Në lidhje me nenin 18 të Kushtetutës

Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 991/3, datë 02.03.2010, nuk është në pajtim edhe me nenin 18 të Kushtetutës. Ky nen afirmon një nga parimet e përgjithshme që përshkon të gjithë katalogun e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta. Shkelja e tij, passjell edhe shkeljen e të drejtave të tjera të parashikuara në Kushtetutë, e në rastin tonë, të drejtën për akses të barabartë për një gjykim të drejtë.

*Prima facia* duket sikur udhëzimi në fjalë, sanksionon detyrime të barabarta për të gjithë, nuk bën dallime dhe respekton parimin e barazisë. Por, në një vështrim analitik të parimit të barazisë e mosdiskriminimit, në lidhje me ligjin “Për taksat Kombëtare” dhe me udhëzimin përkatës, arrijmë në konkluzionin, se ky i fundit, duke mos marrë parasysh gjendjen ekonomike në përcaktimin e masës së tarifave, nuk është në përputhje me parimin e barazisë thelbësore, ose substanciale. Në këtë gjendje që paraqitet, ky udhëzim krijon diskriminim të drejtpërdrejtë substancial, madje edhe diskriminim të tërthortë.

Për të kuptuar sa më sipër, le t'i drejtohemi ligjit nr. 10221, dt. 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ai e përkufizon diskriminimin e drejtpërdrejtë si atë *formë të diskriminimit që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, se sa një person tjetër, apo një grup tjetër personash, në një situatë të njëjtë a të ngjashme, për cilindo shkak të përmendur në këtë ligj.* (neni 3/2). Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka konsideruar se, diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të ushtrohet jo vetëm në kuptimin formal, pra, trajtim i pabarabartë i çështjeve të barabarta, por edhe në kuptimin substancial, pra, trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta. Të dyja rastet sipas kësaj gjykate, hyjnë në gamën e nenit 14 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut. Rastet më klasike që provojnë këtë qëndrim janë çështjet *Thlimenos kundër Greqisë* dhe *Glor kundër Zvicrës*. Në këto raste, duket qartë se diskriminimi nuk mund të lind vetëm nga trajtimi i subjekteve ndryshe, pra duke aplikuar standarde të ndryshme në situata të ngjashme, por edhe duke ofruar një trajtim të njëjtë për persona

që ndodhen në rrethana apo situata të ndryshme. Në rastin tonë, diskriminimi lind për shkak të gjendjes ekonomike të personit dhe mund të themi se ndodhemi përpara diskriminimit të drejtpërdrejtë substancial për shkak të gjendjes ekonomike. P.sh., në praktikën e qendrës sonë, rastet më tipike që ilustrojnë sa më sipër, janë rastet për shpërblimin e dëmit për viktimat e trafikimit, rastet e zgjidhjes së martesës, si dhe ato të largimit nga puna pa shkaqe të arsyeshme. Në këto raste, kemi mbetur në mes të procedurave për shkak të mospagimit të tarifave, kemi përballuar me shpenzimet e Qendrës kur kemi pasur mundësi për rastet më vulnerabël, ose kemi hequr dorë nga kërkimi i shpërblimit të dëmit për shkak të vulnerabilitetit.

Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr.991/3, datë 02.03.2010, ka krijuar raste edhe për diskriminim të tërthortë. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka përcaktuar se “*një kriter apo praktikë, që në dukje shfaqet si e paanshme, mund ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme në raport me të tjerët, për shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit...*”. Ky sanksionim ligjor është shprehur qartë edhe nga Jurisprudenca e GJEDNJ (*shih Glor kundër Zvicrës*). Ky diskriminim quhet diskriminim i tërthortë. Pra, ai ndodh edhe kur subjekti përkatës nuk ka ose nuk ka pasur fare për qëllim që të diskriminojë për ndonjë shkak. Megjithatë, parë me kujdes, Udhëzimi në fjalë krijon një diskriminim të tërthortë për disa shkaqe, sidomos për shkak të gjinisë, për shkak të moshës, për shkak të aftësisë së kufizuar, të cilat lidhen me shtresat në pamundësi ekonomike. P.sh., nëse studiojmë praktikën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, rezulton se numri më i madh i viktimave të trafikut që kërkojnë dëmshpërblim, ose numri më i madh i viktimave të dhunës në familje që kërkojnë divorcin, janë gra. Këto të fundit, në përgjithësi janë më vulnerabël se sa burrat, për shkak se kanë shërbyer në shtëpi dhe kanë qenë pa punë, ose për shkak se të ardhurat e tyre administrohen nga burrat në bazë të zakoneve familjare, ose për shkak se mund të jenë larguar nga shtëpia bashkëshortore për t'i shpëtuar dhunës. Për rrjedhojë, pamundësia e tyre për të paguar në bazë të udhëzimit bën që të ndodhemi përpara diskriminimit të tërthortë për shkak të gjinisë, gjë që mund të provohet nga një studim statistikor për gjendjen ekonomike të kërkuesve në këto raste.

*Për sa më sipër*, parashtrojmë mospajtimin me Kushtetutën të Udhëzimit të Ministrit të

Financave dhe Ministrin të Drejtësisë, nr. 991/3, datë 02.03.2010, për shkak se janë të papajtueshëm me nenin 18 të saj dhe nuk respektojnë parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit.

**4. Në lidhje me nenin 42/2 të Kushtetutës, me nenin 2/c të “Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”, (Konventa e CEDAW-t)”, me nenin 3/a dhe nenin 14 të “Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile e politike”, me nenin 13, 14 dhe 6/1 të “Konventës evropiane për të drejtat e njeriut”, parashtrijmë si më poshtë vijon.**

Udhëzimi objekt shqyrtimi, vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me aktet Ndërkombëtare, të cilat sanksionojnë si të drejtë themelore të Njeriut, të drejtën që çdo person të ketë të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe sigurinë e një mjeti juridik efektiv, kur i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në Kushtetutë, aktet ndërkombëtare dhe në ligj.

Të gjitha këto akte, si neni 42/2 i Kushtetutës së RSh, edhe nenet përkatëse në Konventat ndërkombëtare të sipërcituara, kërkojnë që Shteti të përmbushë detyrimet e tij në tre aspekte të rëndësishme. Në radhë të parë, t'u sigurojë të gjithë qytetarëve të tij akses në sistemin e drejtësisë; së dyti, ky akses të jetë i barabartë; së treti, të ketë një proces të rregullt gjyqësor dhe mjeti juridik, të jetë efektiv. Në këtë kuadër, parashtrijmë përpara Gjykatës Kushtetuese pretendimin tonë se akti që kërkohet të bëhet objekt gjykimi kushtetues me anën e kësaj kërkesë, krijon barriera të paarsyeshme për disa shtresa të popullsisë, pasi janë tarifa mjaft të shtrenjta dhe në mjaft raste të papërballueshme. Për këtë, duhet të përmendim edhe faktin se pala paditëse në një proces gjyqësor, duhet të përballojë shpenzimet e parashikuara për shërbimet e ofruara nga të gjitha subjektet e udhëzimit, pra, i duhet të paguajë si tarifën për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, për ato të noterisë (p.sh., prokurorë, vërtetimet njësisë me origjinalin etj.), për ato të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme (p.sh., certifikatën e pronësisë). Të mos harrojmë se në raste të tjera pala ka barrë të paguajë tarifën përkatëse për të gjitha institucionet ku pajiset me prova. Për më tepër, në rastin kur pala paditëse del kreditore në përfundim të procesit gjyqësor, tarifa mjaft të shtrenjta duhet të paguajë edhe pranë Zyrës së Përmbartimit, për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës.

Një përlllogaritje e thjeshtë e të gjithë procesit na bën të ndërgjegjshëm se në mjaft raste, këto tarifa e shndërrojnë procesin gjyqësor në një luks të shtrenjtë për një pjesë të popullsisë dhe në një pamundësi, për shtresat në nevojë të saj. Në këto kushte nuk mund të flasim për akses të barabartë në gjyqësor dhe as për mundësinë e një gjykimi të drejtë, si të drejta kushtetuese.

**5. Në lidhje me nenin 54/1 dhe 59.1/e të Kushtetutës**

Në lidhje me nenin 54/1 dhe 59.1/e të Kushtetutës, neni 54/1 i saj, afirmon detyrimin e shtetit për të marrë masa pozitive me qëllim mbrojtjen e veçantë të fëmijëve, të rinjve, grave shtatzëna dhe nënave të reja. Një natyrë tjetër ka neni 59.1/e i Kushtetutës, i cili përcakton si objektiv social, përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët. Konkretisht, për masat pozitive që do të merren për lehtësimin nga detyrimet financiare mbi aksesin e tyre në Gjykatë, vendos Kuvendi me nismën ose mendimin e Qeverisë. Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave ka detyrë të studiojë në cilin prej këtyre kategorive është rasti që të parashikohen lehtësime ose përjashtime nga detyrimet financiare, dhe në ç'masë. Madje, Këshilli i Ministrave mund të propozojë edhe kategori të tjera që duhet të parashikohen me ligj, siç mund të jenë kategorizimet sipas të ardhurave, ose shtresat vulnerabël, të cilët nuk kanë mundësi për të paguar. Një kategori që përjashtohet nga taksat mund të ishin të gjitha palët që pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga personat e veshur me funksion zyrtar. Megjithatë, është bërë e qartë se, shteti ka detyrë dhe është përgjegjës për mbrojtjen e qytetarëve të vet, jo vetëm kur dhuna ka ardhur si rezultat i veprimeve të paligjshme të personave zyrtarë, por edhe kur ajo vjen nga persona privatë. Prandaj, një kategori e tillë e përjashtuar nga taksat duhet të jetë padyshim edhe viktimat e veprave të dhunshme që kërkon shpërblimin e dëmit. Këto, jo vetëm nuk kanë ndonjë lehtësi për shkak se nuk u është garantuar mbrojtja e jetës, shëndetit, e dinjitetit, por duhet të paguajnë një tarifë mjaft të lartë, deri në 3%, lidhur me masën e dëmshpërblimit që kërkojnë.

Edhe në këtë rast ne mendojmë se nuk është fjala për një ometim legjislativ, por për një mohim të parimit të barazisë thelbësore, për faktin se në asnjërin prej redaktimeve ligjore të ligjit ”Për

taksat kombëtare”, i ndryshuar, që nga viti 2002, nuk ka pasur përjashtime e lehtësime për ndonjë nga kategoritë e sipërpërmendura, ose për ndonjë kategori tjetër.

Për më tepër, udhëzimi që kërkohet të bëhet objekt gjykimi, nuk parashikon ndonjë lehtësi procedurale për mënyrën e pagimit të detyrimit. Përveç faktit se tarifatat janë shumë të larta, ato kanë vetëm një mënyrë pagimi, parapagimin. Ky fakt e rëndon udhëzimin si antikushetues, pasi në këtë mënyrë ai *par excellence*, pengon aksesin në gjykatë, të shtresave që nuk kanë mundësi paguese.

### 6. Në lidhje me qartësinë e ligjit.

Tashmë është bërë i qartë qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese të RSh në lidhje me qartësinë e normave juridike. Në një sërë vendimesh të saj, kjo Gjykatë ka theksuar se paqartësia e një ligji mund të sjellë papajtueshmëri me Kushtetutën, atëherë kur për shkak të tyre ka ardhur moszbatimi i ligjit ose zbatimi i gabuar i tij. (Vendimet GJK nr. 34/2005, 14/2006, 36/2007 etj). Shtrohet pyetja: A i qëndron këtij testi Udhëzimi objekt gjykimi?

Neni 11/2 i Ligjit Nr. 10065, dt. 29.01.2009, “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9975, dt. 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, autorizon Ministrin e Financave dhe institucionet përkatëse që të përcaktojnë vetëm nivelet minimale të tarifave të shërbimit. Kjo gjë e rëndon edhe më tepër situatën e aksesit në organet e drejtësisë për shtresat në pamundësi financiare. A do të thotë kjo që mund të ketë edhe tarifa më të larta të përcaktuara me ligj? Nuk duket qartë se çfarë ka dashur të thotë ligjvënësi me termin “tarifa minimale”.

Një konfuzion normash krijohet midis udhëzimit në fjalë dhe Kodit të Procedurës Civile. Nuk ka asnjë qartësi se përse taksat mbi aktet janë barasvlershme me tarifatat. A mund të bëhej ky barazvlerësim nga një udhëzim dikasteri, ndërkohë që është e shkruar e zeza mbi të bardhë në Kodin e Procedurës Civile?

Gjithashtu, udhëzimi ka krijuar paqartësi edhe në shtojcën nr.1 të tij, të titulluar, “*Tarifa për veprimet dhe shërbimet që kryhen nga administrata*

*gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, prokuroria, noteria dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*”, pika 7/2/d. Në këtë pikë është përcaktuar shprehimisht se, masa e tarifës gjyqësore për “paditë për kthim në punë” është 0 lekë. Por, avokatet e Qendrës sonë, kanë konstatuar se në të gjitha rastet e ndjekura pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, për depozitimin e kërkesë-padive në lidhje me konfliktet në marrëdhëniet e punës, paditësit/et paguajnë tarifën gjyqësore në masën prej 12.000 lekë, kurse pranë Gjykatës së Shkallës së I-rë, Vlorë, ata paguajnë tarifën 0 lekë. Ne mendojmë se shkak për këtë kundërshti është bërë terminologjia e përdorur nga udhëzimi. Ajo është e pasaktë, e vjetruar dhe nuk i përgjigjet plotësisht terminologjisë të përdorur në Kodin e Punës. Për mendimin tonë, nga një interpretim teleologjik, tarifa nuk duhet të bëhet pengesë që të gjitha paditë që çohen në gjykatë dhe kanë objekt zgjidhjen e pasojave të konflikteve në marrëdhëniet e punës, duhet të trajtohen sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi. Por kjo nuk është shprehur, duke u dhënë aksesin me 0 lekë vetëm punonjësve të administratës publike që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, pasi vetëm për ta Kodi parashikon kthimin në punë.

Përfundimisht, në bazë të nenit 131/a/c, 124/1, 134.1/f. dhe neneve përkatëse të Ligjit nr. 8577, dt. 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH”, kërkojmë që kjo Gjykatë të pranojë për gjykim kërkesën e paraqitur si më sipër dhe, në përfundim të tij, të vendosë sipas objektit të kësaj kërkesë:

*Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr.991/3, datë 02.03.2010, ”Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”;*

*Interpretimi përfundimtar i nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me zbatimin e ligjit “Për taksat kombëtare”, mbi bazën e parimit të aftësisë paguese.*



## 2

### GJYKATA KUSHTETUESE E RSH

Vendim Nr. 7, dt. 27.02.2013

**Kërkues:** *Gjykata e rrethit gjyqësor Pogradec, Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë;*

*Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive, Prof. av. Aurela Anastasi.*

*Subjekte të interesuara: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Çefa, me autorizim;*

*Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim;*

*Ministria e Financave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.*

**OBJEKTI:** -Kontrolli i kushtetutshmërisë së nenit 11/2, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;

- Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 991/3, datë 02.03.2010, “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, ‘Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”;
- Interpretimi përfundimtar i nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, mbi bazën e parimit të aftësisë paguese.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 18, 42, 54/1, 59/1 shkronja “e”, 118, 122, 124/1, 134/1 shkronja “d”, 145/2 dhe 155 të Kushtetutës; neni 6 i KEDNJ-së; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike.

Gjykata Kushtetuese ka vërejtur si vijon: Hyrja në fuqi e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” (në vijim “ligji nr. 9975/2008”) shfuqizoi ligjin “Për sistemin e taksave në RSH” të vitit 2002, i cili parashikonte ndër të tjera, edhe taksat mbi aktet gjyqësore. Sipas nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, të ndryshuar<sup>1</sup>, nivelet minimale të tarifave për veprime e shërbime të administratës gjyqësore përcaktohen me anë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse.

1. Udhëzimi nr. 13, datë 12.02.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, (në vijim “udhëzimi nr. 13/2009”), i nxjerrë për këtë qëllim, në pikën 5, parashikon se termi “tarifë” ka të njëjtin kuptim me termin “taksë mbi aktet”, i përdorur në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Në datën 02.03.2010, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë kanë nxjerrë Udhëzimin nr. 991/3, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 13/2009”, (në vijim “udhëzimi nr. 991/3-2010”), ku janë përcaktuar në terma konkretë vlerat e tarifave përkatëse të shërbimit.

2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec (gjykata referuese), është paraqitur për gjykim çështja me objekt “Shpërblim i dëmit të shkaktuar”. Padiësja D.N. ka kërkuar nga Bashkia Pogradec, në cilësinë e të paditurës, shpërblimin me pagën e dy muajve të plotë për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës me afat të caktuar, pagimin e 3 muajve të plotë për mosrespektim të afateve të njoftimit për zgjidhjen e kontratës si dhe shpërblimin me pagën e një viti pune të plotë për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës pa shkaqe të justifikuara. Meqenëse vlera e objektit të padisë, (400 000 lekë), i kalonte 100 000 lekë, pala e paditur, Bashkia Pogradec, kërkoi përpara gjykatës, që në kërkesat paraprake, parapagimin e taksës gjyqësore mbi aktet në masën 3% të vlerës së objektit të padisë. Këtë kërkesë pala e paditur e ka mbështetur në nenet 154, 154/a të Kodit të Procedurës Civile, Udhëzimin nr. 991/3-2010 si dhe nenin 11 të ligjit nr. 9975/2008, të ndryshuar.

3. Padiësja ka pretenduar pamundësinë

<sup>1</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 10065, datë 29.09.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”

financiare për të parapaguar këtë taksë, pamundësi të cilën ajo e ka provuar para gjykatës me anë të disa akteve (certifikatë familjare, vërtetim i Zyrës Vendore të Punësimit, vërtetim i ZVRPP-së Pogradec, vërtetim i Bashkisë Pogradec, etj). Gjykata referuese ka konstatuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e kërkesës paraprake, që ka të bëjë me masën e taksës gjyqësore, përbëhet nga: nenet 102-110 të KPC-së; neni 11 i ligjit nr. 9975/2008 dhe Udhëzimi nr. 991/3-2010. Mbi bazën e këtyre akteve juridike, në kushtet e një padie të rrjedhur nga një marrëdhënie kontraktore, me vlerë që i kalon 100 000 lekë, është i detyrueshëm parapagimi i tarifës gjyqësore në masën 3% të vlerës së padisë, nga pagimi i së cilës ligji nuk përjashton asnjë kategori personash. Parapagimi i tarifës gjyqësore është kusht i detyrueshëm për vazhdimin e gjykimit; në rast të kundërt, gjykata i kthen aktet pa kryer veprime (neni 154/a dhe 156 i KPC-së).

4. Në këto kushte, gjykata referuese ka vlerësuar se ndodhet përpara një situatë procedurale që pengon vazhdimin e gjykimit për arsye se, paditësja, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi është e detyruar të parapaguajë tarifën gjyqësore prej 3% të vlerës së padisë, shumë të cilën ajo nuk ka mundësi financiare për ta paguar. Pasi ka analizuar tërësinë e përmbajtjes së akteve ligjore, që përcaktojnë detyrimin e pagimit të tarifës gjyqësore, dhe ka konkluduar se disa dispozita ligjore specifike të këtyre akteve paraqesin probleme kushtetutshmërie, gjykata referuese ka pezulluar gjykimin e themelit dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

5. Një rast analog me objekt “shpërblim dëmi” është paraqitur edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjykata referuese), e cila për të njëjtat arsye e ka pezulluar gjykimin dhe i është drejtuar Gjykatës.

6. **Gjykatat referuese**, kanë pretenduar se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar* dhe Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë nr. 991/3-2010, nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe në mënyrë të përmblodhur, kanë parashtruar këto argumente:

6.1 Aktet ligjore konkrete shfaqin probleme antikushtetutshmërie në drejtim të cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi e kushtëzojnë aksesin me parapagimin e plotë (100%) të tarifës gjyqësore në masën 3% të vlerës së objektit të padisë dhe nuk parashikojnë përjashtime në rastet e

pamundësisë financiare për bërjen e kësaj pagese;

6.2 Ky kufizim i së drejtës së aksesit është *jo proporcional* dhe njëkohësisht *diskriminues*, në tejkalim të kriterëve të përcaktuara nga nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës;

6.3 Është shkelur rezerva ligjore absolute, e parashikuar në nenin 155 të Kushtetutës, në lidhje me caktimin e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare vetëm me ligj;

6.4 Neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, si dispozitë deleguese, përveç përcaktimit të organit kompetent për nxjerrjen e udhëzimit, nuk plotëson detyrimet e tjera kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore;

6.5 Aktet ligjore, objekt shqyrtimi, nuk janë në përputhje me KEDNJ-në dhe të drejtën e Bashkimit Evropian, të cilat garantojnë një proces të rregullt ligjor dhe, në këtë kontekst, edhe të drejtën e aksesit në gjykatë.

7. **Kërkuesi, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ)** ka parashtruar këto argumente:

7.1 Udhëzimi nr. 991/3-2010 nuk është në pajtim me nenin 18 të Kushtetutës. Ky udhëzim, duke vendosur tarifa të barabarta për të gjithë, krijon *diskriminim* të drejtpërdrejtë, thelbësor, për shkak të gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale si dhe mund të krijojë gjithashtu edhe diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë, moshës apo aftësisë së kufizuar;

7.2 Vendosja e tarifave gjyqësore të papërbalueshme për një shtresë të caktuar të popullsisë krijon barriera të paarsyeshme që *cenojnë të drejtën kushtetuese për akses në gjykatë*, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor. Udhëzimi, objekt shqyrtimi, nuk është hartuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të garancisë së thelbit të së drejtës për akses në gjykatë;

7.3 Shteti nuk ka përmbushur detyrimin e tij për mbrojtjen e veçantë që duhet t’u ofrojë personave në nevojë, të përcaktuar në nenet 54 e 59 të Kushtetutës, duke mos

parashikuar asnjë përjashtim/lehtësim nga tarifa gjyqësore për këto kategori personash, që do të mundësonte aksesin e tyre në gjykatë;

7.4 Udhëzimi nr. 991/3-2010 ka anashkaluar parimin e aftësisë paguese, të shprehur në mënyrë implicite në nenin 155 të Kushtetutës, dhe, për këtë arsye, është i papajtueshëm me këtë nen;

7.5 Është cenuar *parimi i ligjshmërisë*, për shkak se udhëzimi nr. 991/3-2010 nuk ka respektuar kushtet e përcaktuara në nenin 155 të Kushtetutës, në bashkëveprim me nenin 118 të saj;

8.6 Si ligji nr. 9975/2008, ashtu edhe udhëzimi nr. 991/3-2010, nuk janë të qartë në lidhje me përcaktimin e termit “tarifë minimale”. “Tarifa” është barasvlerësuar me “taksën mbi aktet” nëpërmjet një udhëzimi, duke krijuar konfuzion normash midis vetë udhëzimit dhe nenit 156 të KPC-së. *Paqartësia* e normës juridike, në këtë rast, është bërë shkak për një aplikim jo uniform të saj në gjykatat e zakonshme, në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës.

8. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë,** ka parashtruar prapësimet si vijon:

8.1 Kërkuesi, QNLQ-ja, nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për interpretimin e nenit 155 të Kushtetutës, pasi nuk i plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, më konkretisht nga vendimi nr. 24, datë 09.06.2011, për të kërkuar interpretimin e këtij neni;

8.2 QNLQ-ja nuk legjitimohet në kërkimin për papajtueshmëri të ligjit dhe aktit normativ, objekt shqyrtimi, me Kushtetutën, për shkak se një kërkesë e tillë mund të bëhet vetëm për çështje që lidhen me interesat e saj. QNLQ-ja nuk e plotëson këtë kriter të parashikuar në nenin 134/2 të Kushtetutës, sepse normat e kundërshtuara nuk cenojnë interesat dhe qëllimin e veprimtarisë së saj që konsiston në dhënien e ndihmës ligjore për shtresat e varfra dhe, në mënyrë të veçantë, për gratë e dhunuara.

8.3 Gjykatat referuese nuk legjitimohen, sepse ligji i kundërshtuar nuk zbatohet në çështjen në shqyrtim dhe nuk ekziston një

lidhje e drejtpërdrejtë mes këtij ligji dhe zgjidhjes së çështjes konkrete;

8.4 Ligji, objekt shqyrtimi, i plotëson kriteret e vendosura nga neni 17 i Kushtetutës, pasi kufizimi i një të drejte, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, është bërë me ligj dhe në shërbim të interesit publik, në përputhje me politikat e shtetit për grumbullimin e të ardhurave të ligjshme;

8.5 Ligjvënësi ka respektuar nenin 118 të Kushtetutës në nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse, duke pasur parasysh se vetë ligji autorizon nxjerrjen e udhëzimit, përcakton organet kompetente, çështjen që rregullohet dhe parimet në bazë të të cilave është nxjerrë ky udhëzim;

8.6 Përcaktimi i “tarifave të shërbimit”, si një e drejtë e ligjvënësit, dhe ngarkimi i institucioneve përgjegjëse për nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit, nuk cenojnë nenin 42 të Kushtetutës;

8.7 Ligji që kundërshtohet nuk diskriminon asnjë grup të caktuar shtetasish kundrejt të tjerëve, por vetëm vendos “tarifa shërbimi” për sektorë të ndryshëm dhe përcaktimin e niveleve minimale të këtyre tarifave ia delegon akteve nënligjore.

9. **Subjektet e interesuara, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave,** kanë parashtruar prapësimet si vijon:

10.1 Gjykatat referuese nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, pasi nuk kanë plotësuar kriteret që parashikon neni 145/2 i Kushtetutës për të iniciuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit. Nuk ka pasur çështje konkrete për gjykim, për arsye se mospagimi i taksës mbi aktet ka penguar fillimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve civile të paraqitura në gjykatat referuese. Mungon edhe lidhja e drejtpërdrejtë midis dispozitës së kundërshtuar dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

10.2 QNLQ-ja nuk legjitimohet për shkak se norma e kundërshtuar nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta apo të tërthorta mbi objektin apo qëllimin e veprimtarisë së saj. Kjo qendër nuk ka ushtruar ankimin administrativ dhe nuk i është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm,

duke mos shteruar në këtë mënyrë mjetet ligjore të disponueshme;

- 10.3 Kërkimi i QNLQ-së për interpretimin përfundimtar të nenit 155 të Kushtetutës është i papranueshëm, sepse nuk plotëson kriteret kushtetuese të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës;
- 10.4 Ometimi ligjor, në lidhje me përjashtimin e kategorive vulnerabël nga parapagimi i tarifës gjyqësore, nuk mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues;
- 10.5 Parapagimi i tarifës gjyqësore është i nevojshëm për të garantuar funksionimin e rregullt të veprimtarisë gjyqësore dhe i shërben interesit të përgjithshëm publik;
- 10.6 Ligji, objekt shqyrtimi, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, bazuar dhe në statistikën zyrtare të cilat pasqyrojnë respektimin e kësaj të drejte. Vendosja e tarifës së shërbimit ka për qëllim pikërisht garantimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, pasi për kryerjen e shërbimeve gjykata kryen shpenzime për funksionimin dhe administrimin e saj. Që prej vitit 2002 kur u vendos kjo taksë, emërtimi i të cilës ndryshoi në “tarifë” me ligjin nr. 9975/2008, nuk është parashikuar ndonjë përjashtim për kategori të caktuara dhe as nuk është parashtruar ndonjëherë çështja e kushtetutshmërisë përpara Gjykatës.
- 10.7 Aktet nënligjore përkatëse kanë dalë në kuadër të rezervës ligjore relative për të përcaktuar tarifën minimale të shërbimit dhe në përputhje të plotë me kriteret që përcakton neni 118 i Kushtetutës;
- 10.8 Ligji konkret nuk cenon parimin e barazisë, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi nuk bën diferencim në taksimin e qytetarëve nëse shërbimi që kërkohet është i njëjtë.

10. Gjykata Kushtetuese, përpara se të analizojë themelin e kërkesës, vlerëson të nevojshme të ndalet fillimisht te pretendimet e përfaqësuesve të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, për sa i takon legjitimitet të kërkesve përpara kësaj Gjykate.

### A. Për legjitimitetin e kërkesve

11. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, kanë ngritur pretendimin se kërkesit nuk legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës në lidhje me kërkimin për papajtueshmëri me Kushtetutën të akteve ligjore përkatëse, objekt shqyrtimi.

12. Çështjen e legjitimitetit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijjnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate, për t’u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tij.

13. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrorë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 6, datë 17.02.2012; nr. 30, datë 17.06.2010; nr. 2, datë 03.02.2010; nr. 13, datë 04.05.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata çmon se gjykatat referuese i kanë plotësuar kërkesat si më sipër, duke identifikuar ligjin e zbatueshëm, lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitave ligjore që kundërshtohen, dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes së themelit si dhe duke parashtruar arsyet për jokushtetutshmërinë e ligjit, referuar në normat dhe parimet konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht,

ato legjitimohen<sup>2</sup> t'i drejtohen Gjykatës në lidhje me kërkimin për kontroll incidental të dispozitës ligjore, objekt shqyrtimi.

15. Për sa i përket legjitimitit të QNLQ-së, Gjykata nënvizon se, në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciues, që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. “Organizatata e tjera”, të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “F” të Kushtetutës, janë ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimet nr. 5, datë 16.02.2012; nr. 11, datë 06.04.2010 dhe nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 43, datë 06.10.2011; nr. 4, datë 23.02.2011; nr.31, datë 18.06.2010; dhe nr. 16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata

2 Gjyqtarët V. Kristo dhe V. Tusha votuan kundër legjitimitit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

konstaton, bazuar edhe në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, se “qendra” është person juridik pa anëtarësi, që ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e shërbimeve dhe realizimin e projekteve për qëllime në të mirë dhe në interes të publikut, me fonde dhe të ardhura të siguruara sipas ligjit (neni 11). QNLQ-ja është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar si person juridik me vendimin gjyqësor nr. 8, datë 06.11.2001. Qëllimi i kësaj organizate, sipas nenit 4 të Statutit, i ndryshuar me vendimin gjyqësor nr. 8/1, datë 14.12.2004, është “të ofrojë ndihmë ligjore, pa shpërblim, për shtetas të varfër, në mënyrë të veçantë për gratë e varfra e të dhunuara, përfshi këtu dhe vënien në dispozicion të një avokati për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, deri në shqyrtimin përfundimtar të tyre, pranë policisë, prokurorisë, pranë Gjykatës Kushtetuese, ose në gjykata ndërkombëtare, si dhe ndërmjetësimin për të realizuar të drejtat e këtyre shtetasve pranë organeve të administratës publike apo të pushtetit vendor”.

18. Duke e vlerësuar legjitimitimin e QNLQ-së në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se kjo qendër nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi abstrakt kushtetues, për arsye se nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar apo veprimtarisë që ajo kryen dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, të cilat kërkon të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Gjithashtu, në vlerësimin e Gjykatës, ajo nuk ka arritur të provojë një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete. Referuar statusit të saj juridik, si një qendër së cilës i mungon anëtarësia, ajo nuk përfaqëson interesa të anëtarëve të saj, por, në cilësinë e organizatës jofitimprurëse, ndjek një qëllim në të mirë dhe interes të publikut duke ofruar, ndër të tjera, ndihmë ligjore falas (*pro bono*) për disa shtresa të caktuara të popullsisë, të cilat nuk kanë mundësi të përballojnë financiarisht shërbimet e një mbrojtësi ligjor apo shpenzimet gjyqësore.

19. Në këto kushte, për arsyet e mësipërme, Gjykata çmon se QNLQ-ja nuk legjitimohet<sup>3</sup> t’i drejtohet Gjykatës, për të kërkuar kontrollin

3 Gjyqtarët Xh. Zaganjori, F. Hoxha dhe A. Thanza votuan “pro” legjitimitit të QNLQ-së.

## **kushtetues të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi.**

### **B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës**

20. Gjykatat referuese pretendojnë se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, i ndryshuar, nuk është në pajtim me Kushtetutën, pasi e kushtëzon aksesin në gjykatë me parapagimin e plotë të tarifës për shërbime gjyqësore, dhe nuk parashikon përjashtime në rastet e pamundësisë financiare për kryerjen e kësaj pagese.

21. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se “Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Aksesin në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera (*shih vendimet nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 23.02.2011; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Edhe GJEDNJ-ja ka pohuar se neni 6 § 1 garanton të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës. Ajo ka konsideruar se sipas këtij neni, detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Gjykata ka rikujtuar edhe njëherë se ajo asnjëherë nuk e ka përjashtuar mundësinë që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim financiar në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në

një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte (*Shih Kreuz kundër Polonisë, 19 qershor 2001, perifraksim*). Në disa çështje konkrete, në lidhje me pagesën paraprake të tarifave gjyqësore, GJEDNJ-ja, ka marrë parasysh mundësinë financiare të aplikantit për të paguar tarifën dhe fazën e procesit gjyqësor në të cilin është vendosur ky kufizim, si faktorë materialë për të përcaktuar nëse aplikanti e ka gëzuar të drejtën e aksesit (*shih Kreuz kundër Polonisë, nr. 28249/95, § § 58-67, ECHR 2001 VI; Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 63.945 / 00, § 33-43, ECHR 2006 VII (ekstrakte), Adnan Özdemir kundër Turqisë; vendimi i datës 20 maj 2010*).

23. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se sipas nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, të ndryshuar, përcaktimi i niveleve minimale të tarifave të shërbimit, ku përfshihen *inter alia* edhe tarifatat për veprime e shërbime të administratës gjyqësore, bëhet me anë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse. Siç shihet qartë, nga përmbajtja normative e nenit, kjo është një dispozitë deleguese, e cila i jep Ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse të drejtën të përcaktojnë me udhëzim nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përkufizuara në ligj. Në vlerësimin e Gjykatës, kjo normë nuk e pengon aksesin e individit në gjykatë, por vetëm delegon kompetencën për përcaktimin e niveleve minimale të tarifave të shërbimit te institucionet përkatëse të administratës publike.

24. Për të garantuar të drejtën e një individit për t’iu drejtuar gjykatës, zbatimi i nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, të ndryshuar, duhet parë në raport me rregullimet e tjera ligjore që disiplinojnë paraqitjen e padisë. Më konkretisht, Gjykata e sheh të arsyeshme të ndalet te dispozitatat përkatëse të KPC-së që trajtojnë këtë aspekt të procesit gjyqësor. Sipas dispozitave procedurale civile, gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë (neni 1). Për ngritjen e padisë dhe në momentin e paraqitjes së saj paguhet taksa mbi aktet, në rastet dhe në masën e caktuar sipas ligjit (nenet 102; 156). Taksa mbi aktet paguhet në bazë të vlerës së padisë (neni 104). Shpenzimet gjyqësore parapagohen nga pala kërkuese por gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe

gjendjen pasurore të palëve, mund të ngarkojë njëri-njëri ose të dyja palët që të paguajnë shpenzimet e tyre, pavarësisht se kush prej tyre ka kërkuar pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimit ose të këqyrjes (neni 105). Gjyqtari vendos për përjashtimin e paditësit nga pagimi i taksës mbi aktet, në rastet e përcaktuara nga ligji (neni 158/a). Personat që, sipas dispozitave për taksën mbi aktet, përjashtohen nga pagimi i taksës, përjashtohen edhe nga pagimi i shpenzimeve të tjera gjyqësore (neni 105/b). Taksa mbi aktet dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, nga pagimi i të cilave pala është përjashtuar sipas nenit 105/b, i ngarkohen palës tjetër në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata (neni 106).

25. Çdo individ që i drejtohet me padi gjykatës, është i detyruar të parapaguajë taksën mbi aktet (ose “tarifën për shërbime gjyqësore”, sipas udhëzimit nr. 13/2009, *supra*), e cila caktohet mbi bazën e vlerës së padisë. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve të sipërcituara të KPC-së, gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e të drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas dispozitave procedurale civile, në rastet e përjashtimit të individit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet edhe taksa mbi aktet, këto shpenzime përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit (neni 105/b). Nga ana tjetër, ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t’u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të individëve, duke kryer shpenzimet përkatëse (nenet 10 dhe 14 të ligjit).

26. Nëpërmjet interpretimit sistematik të dispozitave të mësipërme të KPC-së si dhe analogjisë me ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” (përkatësisht nenet 2,10,13,14), arrihet qartësisht në përfundimin se qëllimi i këtij kuadri ligjor është të garantojë aksesin në gjykatë për të gjithë individët që i drejtohen gjykatës. Në funksion të këtij garantimi, si dhe të frymës që

ligjvënësi ka dashur të përçojë në këtë kontekst ligjor, Gjykata thekson se i takon gjyqtarit të hetojë, mbi bazën e dokumentacionit provues të pamundësisë ekonomike të paraqitur nga paditësi, dhe të vlerësojë, duke iu referuar legjislacionit procedural civil dhe rregullimeve ligjore përkatëse, nëse është rasti për përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore.

27. Për sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se, neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

### C. Për pretendimin e cenimit të nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 118 të saj

28. Gjykatat referuese kanë parashtruar se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, duke ia deleguar formalisht dhe substancialisht të drejtën e caktimit të tarifave Ministrave përkatës me udhëzim, bie ndesh me rezervën ligjore të parashikuar nga neni 155 i Kushtetutës që ia ka lejuar vetëm ligjit të drejtën për të vendosur taksa, tatime apo detyrime financiare kombëtare e vendore. Përveç kësaj, gjykatat referuese argumentojnë se neni 11/2 nuk plotëson detyrimet kushtetuese, të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës, për nxjerrjen e akteve nënligjore.

29. Neni 155 i Kushtetutës parashikon se “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj...”. Ndërsa neni 118 i Kushtetutës sanksionon se “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte”.

30. Gjykata çmon se rezerva ligjore që parashikon neni 155 i Kushtetutës për sa i përket, *inter alia*, caktimit të taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare kombëtare e vendore, është një rezervë ligjore relative. Në rastin e *rezervës ligjore absolute* Gjykata ka theksuar se është norma kushtetuese ajo që ia rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete, ndërsa në rastin e *rezervës ligjore relative*, çështja konkrete

mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore (*shih vendimin nr. 19, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e Gjykatës duhet dalluar koncepti i taksës, si një detyrim financiar që duhet paguar nga të gjithë individët, nga ai i tarifës së shërbimit, që në rastin konkret është një detyrim financiar i cili paguhet në këmbim të një shërbimi në fushën gjyqësore. Termi “ligj” i përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka raste që nënkupton një interpretim të gjerë duke përfshirë dhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit “ligj” në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo të aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës (*shih vendimin nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin e rezervës ligjore relative, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat nga njëra anë e detyrojnë ligjvënësin t’u përmbahet atyre në mënyrë rigorozë dhe nga ana tjetër orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore.

31. Në rastin konkret, neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, ia ka deleguar përcaktimin e niveleve minimale të tarifave të shërbimit, ku përfshihen dhe tarifat për veprime e shërbime të administratës gjyqësore, Ministrinë të Financave dhe institucioneve përkatëse të cilët autorizohen të nxjerrin për këtë qëllim një udhëzim të përbashkët. Gjykata vlerëson se kjo dispozitë deleguese, ndryshe nga sa pretendojnë gjykatat referuese, respekton rezervën ligjore relative, të parashikuar në nenin 155, si dhe kriteret për nxjerrjen e akteve nënligjore, të sanksionuara në nenin 118. Kështu, neni objekt shqyrtimi, ka autorizuar nxjerrjen e akteve nënligjore, ka përcaktuar organin kompetent si dhe çështjet specifike që duhen rregulluar mbi bazën e parimeve kryesore në fushën e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare.

32. Për sa më sipër, Gjykata nuk gjen elemente të cenimit të standardeve, të përcaktuara në nenet 118 dhe 155 të Kushtetutës, nga përmbajtja normative e nenit 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*.

33. Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar* nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe

nuk bie ndesh me standardet e përcaktuara në nenet 118 dhe 155 të Kushtetutës. Për pasojë, kërkesa për shfuqizimin e tij është e pabazuar dhe duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

### V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.

**Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.**

## 3

### QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

#### Informacion

**Drejtuar:** Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**Data e informacionit:** 13/01/2012

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) është një organizatë jo fitimprurëse e cila ka në misionin e saj mbështetjen, ndihmën dhe edukimin e shtetasve, me përparësi gratë dhe vajzat, me qëllim që të rritet aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë, përmes ofrimit të shërbimeve ligjore falas. Gjthashtu kjo organizatë në ofrimin e shërbimit ligjor falas është angazhuar edhe në zbatimin e ligjit nr. 9970 datë 24.7.2008 “Për barazisë gjinore në shoqëri” dhe ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Bazuar në nenin 32 germa c), ë) të ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, paraqet këtë informacion me shpjegimet që vijojnë:

Në kuadër të veprimtarisë së saj të shërbimit ligjor falas, QNL ka përfaqësuar në proces gjyqësor çështjen penale të B.Q-së, akuzuar për prostitucion në bazë të nenit 113 të Kodit Penal.



Në rastin konkret të B.Q-së Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin... 2011, ka vendosur deklarimin e saj fajtores për kryerjen e veprës penale të "Prostitucionit", parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit me vendimin...2011, e la në fuqi këtë vendim.

Në këtë proces ne kemi pretenduar dhe pretendojmë se neni 113 i Kodit Penal me të cilin B.Q është akuzuar e dënuar, shkel parimin e barazisë gjinore, duke e diskriminuar tërthorazi, për shkak të gjinisë. Ndërsa objekt i kësaj figure janë marrëdhëniet juridike të vendosura për ndalimin e ushtrimit të prostitucionit, me qëllim mbrojtjen e moralit dhe të dinjitetit të personit, duket qartë se nga ana objektive, element thelbësor për këtë figurë krimi, është marrja e shpërblimit për ushtrimin e prostitucionit. Për rrjedhojë, subjekt i kësaj vepre penale, është personi që ka marrë shpërblim si rezultat i kryerjes së marrëdhënieve seksuale, gjë që i jep karakter diskriminues parashikimit ligjor në këtë vepër, për shkak se që ajo të kryhet duhet të ekzistojnë medoemos dy subjekte. Në këtë mënyrë, duhet theksuar se, në bazë të Kushtetutës, legjislatori duhet t'i mbrojë të gjithë qytetarët e tij në mënyrë të barabartë nga shkelja e dinjitetit. Por, në këtë rast nuk ndodh kështu, pasi nuk është mbajtur parasysh se, veprimet kriminale me të cilat konsumohet kjo vepër penale, kryhen jo vetëm nga përfituesi i shpërblimit, por edhe nga personi që përfiton marrëdhënie seksuale, në mënyrë të paligjshme, si dhe nga persona të tretë që mund të përfitojnë në mënyra të ndryshme, si rezultat i ushtrimit të prostitucionit. Prandaj, si personi që ka përfituar marrëdhënie seksuale, edhe ai/ajo që kryejnë marrëdhënie seksuale kundrejt shpërblimit, mund të kenë shkelur normat e moralit shoqëror dhe kanë cënuar dinjitetin e personit. Por, kjo nuk do të thotë se, për këtë duhet të mbajë përgjegjësi vetëm personi që përfiton paratë, pasi edhe personi tjetër që i ka dhënë paratë kundrejt përfitimit seksual, ka shkelur normat e moralit shoqëror dhe dinjitetin e personit. Nëse qëllimi i ligjvënësit ka qenë që të mbrojë normat morale të shoqërisë, atëherë ai duhet të mbante parasysh faktin se dënimi për këtë vepër nuk mund të jetë diskriminues. Në këtë rast jemi përpara një diskriminimi të tërthortë, i cili në të njëjtën mënyrë me atë të drejtpërdrejtë e bën nenin antikushtetues.

Nëse do të mbanim parasysh interpretimin statistikor për të zgjidhur këtë çështje, ashtu sikurse veprojnë zakonisht gjykatat ndërkombëtare të të

drejtave të Njeriut, rezultojnë, se në zbatim të kësaj dispozite penale, pothuajse të gjithë personat e dënuar kanë qenë gratë dhe vajzat të cilat kanë pranuar të hyjnë në marrëdhënie seksuale kundrejt shpërblimit dhe ofertës së kryer nga mashkulli, për shkak të vulnerabilitetit të tyre. Vulnerabiliteti i tyre, varfëria, papunësia, i fut gratë në një risk të veçantë të dhunës e të abuzimit. Kjo duket qartë edhe nga mënyra se si është interpretuar vazhdimisht nga Gjykata dhe vazhdon të interpretohet konkretisht në rastin, ky nen. Praktika të tilla ligjore e gjyqësore, janë të papajtueshme me gëzimin e barabartë të respektit ndaj dinjitetit të gruas dhe gëzimin e barabartë të të drejtave prej saj.

E gjithë sa më sipër, duket qartë edhe nga standardet e përcaktuara nga aktet ndërkombëtare, të cilat Shqipëria i ka ratifikuar. Kështu, Komiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për eliminimin e diskriminimit ndaj grave (CEDAW), në interpretim të nenit 6 të Konventës së CEDAW-t, pas raportimit periodik të fundit që Shteti shqiptar paraqiti në OKB, i rekomandon qartazi shtetit Shqiptar, që Kodi Penal të ndryshohet me qëllim që viktimat të mos i nënshtrohen ndjekjes penale dhe dënimit penal. Ky komitet ka ripërtëritur shqetësimin e tij të veçantë, që gjendet në vërejtjet e mëparshme përmbyllëse [A/58/38 (Supp), par.70], sipas të cilit, viktimat e trafikimit dhe prostitutat vazhdojnë t'i nënshtrohen dënimit penal në pajtim me kodin penal.

Në këto kushte, kjo dispozitë, vjen në kundërshtim me Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e cila është një konventë e ratifikuar nga Shteti shqiptar, prandaj në bazë të nenit 116 dhe 122 të Kushtetutës, ka epërsi mbi ligjet e brendshme të vendit. Për shkak të interpretimit që i ka bërë Komiteti i CEDAW-t kësaj konvente, sipas të cilit, sikurse e shpjeguem më sipër, shprehet shqetësimi për ndëshkimin e prostitutave në bazë të Kodit penal, ne e konsiderojmë nenin 113 të Kodit Penal, si një dispozitë që vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo për faktin se Komiteti i CEDAW-t është organi kompetent që mund të bëjë interpretimin përfundimtar të Konventës së CEDAW-t.

Një argument tjetër buron edhe nga interpretimi krahasimor i dispozitës. Për këtë, mjafton të analizojmë përvojat në shtete të tjera në lidhje me këtë dispozitë. Vëmë re se në mjaft shtete, janë bërë reforma në Kodin Penal, qysh në vitet 1970 e në

vijim, ku është shfuqizuar një dispozitë e ngjashme me nenin 113 të Kodit tonë Penal, nga legjislacionet e këtyre vendeve. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga doktrina shqiptare, e cila në interpretimin e këtij neni shprehet për nevojën e heqjes së tij.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 32 germa c), ë), të ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, informojmë me qëllim që Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ushtrojë kompetencën për të bërë rekomandime autoriteteve kompetente për shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal, pasi shkel parimin e barazisë gjinore, duke e diskriminuar tërthorazi gratë dhe vajzat për shkak të gjinisë.

## 4

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

**Rekomandim nr. 49, dt. 13.02.2012, për shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal.**

**Drejtuar:** Z. Ilir RUSMALI, Kryetar i Komisionit për Çështje Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kuvendi i RSH.

**Për dijëni:** Znj. Jozefina (ÇOBA) TOPALLI, Kryetare e Kuvendit,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I nderuar zoti Kryetar,

Në zbatim të kompetencave ligjore të parashikuara nga neni 32, pika 1, gërma “ë”, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2011 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku thuhet se : “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, Ju drejtohem për sa më poshtë:

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ardhur një informacion nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), organizatë jo fitimprurëse e cila ka në misionin e saj mbështetjen, ndihmën dhe edukimin e shtetasve, me përparësi

gratë dhe vajzat, me qëllim që të rritet aksesimi i tyre në sistemin e drejtësisë.

Kjo organizatë ka ngritur shqetësimin se, neni 113 i Kodit Penal shkel parimin e barazisë gjinore, duke diskriminuar tërthorazi, për shkak të gjinisë, pasi veprimet kriminale me të cilat konsumohet kjo vepër, kryhen jo vetëm nga përfituesi i shpërblimit, por edhe nga personi që përfiton marrëdhënie seksuale, në mënyrë të paligjshme, si dhe nga persona që mund të përfitojnë në mënyra të ndryshme, nga ushtrimi i prostitucionit. Nga praktikat gjyqësore të njohura prej saj, është vënë re se në zbatim të kësaj dispozite, pothuajse të gjithë personat e dënuar kanë qënë gratë dhe vajzat, të cilat kanë pranuar të hyjnë në marrëdhënie seksuale kundrejt shpërblimit dhe të ofertës së kryer nga mashkulli, për shkak të vulnerabilitetit të tyre. Pra, potencialisht është e mundur që të dënohen edhe viktimat e trafikimit.

Në vijim të këtij informacioni, Komisioneri, ka marrë në shqyrtim praktikat gjyqësore të sjella në vëmendje nga kjo organizatë, raportet e organizatave ndërkombëtare dhe konkretisht në konkluzionet përfundimtare, që ka dhënë Komiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për eliminimin e diskriminimit ndaj grave (CEDAW), në lidhje me raportimin e III-të periodik të Shqipërisë në 26 Korrik 2010, ku ndër të tjera, shprehet se: **“Komiteti përsërit shqetësimin e tij, të përfshirë dhe në vëzhgimet e mëparshme përfundimtare, se prostitutat dhe viktimat e trafikimit kanë ngel ende subjekt që dënohen sipas nenit 113 të Kodit Penal”**.

Shqipëria, ka aderuar që prej vitit 1993 në Konventën e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” dhe raporton pranë CEDAW, mbi zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” dhe theksojmë këtu se, Komiteti CEDAW është organi kompetent që mund të bëjë interpretimin përfundimtar të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”.

Bazuar në neni 116 dhe 122/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë, kanë epërsi ndaj ligjeve të vendit të cilat nuk pajtohen me to. Në kushtet kur, neni 113 i Kodit Penal, vjen në kundërshtim me Konventën, si një akt që në bazë të Kushtetutës ka

epërsi mbi ligjet e brendshme, atëherë ky nen bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se neni 113 i Kodit Penal, bie në kundërshtim me parimin e barasisë, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, pasi diskriminon në mënyrë të tërthortë gratë dhe vajzat për shkak të gjinisë.

Në përputhje me përkufizimin që ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* i bën diskriminimit të tërthortë në paragrafin e 3-të të nenit 3 të tij, neni 113 i Kodit Penal, një dispozitë ligjore e cila në dukje është e paanshme, vendos grupin e grave dhe të vajzave në kushte jo të favorshme për shkak të gjinisë së tyre, një shkak ky i parashtruar në nenin 1 të ligjit, në raport me personat që përfitojnë marrëdhënie seksuale në mënyrë të paligjshme apo personat që mund të përfitojnë në mënyra të ndryshme, nga ushtrimi i prostitucionit, të cilët edhe pse me veprimet e tyre konsumojnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal, nuk ndëshkohen. Nëse synimi i legjislatorit me sanksionimin si veprë penale të këtyre sjelljeve është mbrojtja e moralit të shoqërisë, atëherë edhe ndëshkimi duhet të ishte i njejtë. Pra, efekti i kësaj dispozite është i ndryshëm për këto dy grupe personash dhe konkretisht i vendos gratë dhe vajzat nën një trajtim më pak të favorshëm.

Efektet që sjell neni 113 i Kodit Penal, bien në kundërshtim edhe me detyrimet ndërkombëtare të marra nga shtetit shqiptar në drejtim të mbrojtjes së grave dhe vajzave, duke qenë se ai ka ratifikuar aktet ndërkombëtare në këtë fushë, si dhe angazhimet e brendshme të tij, përmes miratimit të strategjive kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore.

Sa më sipër dhe bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ë”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2011 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*:

#### REKOMANDOJMË:

- **Shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal me qëllim që viktimat e trafikimit të mos bëhen subjekte të ndjekjes penale dhe ndëshkimit.**

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

**Irma BARAKU**

#### KOMISIONERI

**Koment:** Kuvendi nuk e shfuqizoi nenin 113 të Kodit Penal, por e ndryshoi atë. Neni 113 Kodit Penal sanksiononte:

*“Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.*

Ligji nr. 23/2012, dt. 1.3.2012, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendosi:*

*‘...në nenin 113, shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje: “Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”’*

## 5

### INFORMACION

#### KOMISIONERES PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

**Lënda:** Informacion për shkeljen e ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* si dhe të ligjit nr. 9970 datë 24.7.2008 *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*, nga Ndërmarrja CEZ shpërndarje sh.a., Drejtoria rajonale Tiranë, dhe Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë.

**Drejtuar:** Znj. Irma Baraku, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**Parashtruesi i informacionit:** QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 10221 datë 4.2.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, neni 20, pika 1/a, neni 32 gërma c dhe neni 3, pika 9.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), në kuadrin e veprimtarisë së saj për ofrimin e ndihmës ligjore falas, ka ardhur në dijeni të një fakti, të cilin e parashtron përpara jush me anën e këtij informacioni.

1. Në lidhje me interesin legjitim të organizatës sqarojmë se, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

(QNL), është një organizatë jo fitimprurëse e cila ka në misionin e saj mbështetjen, ndihmën dhe edukimin e shtetasve, me përparësi gratë dhe vajzat, me qëllim që të rritet aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë. Kjo organizatë jep shërbim ligjor falas për zbatimin e Ligjit nr. 9970 datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe të Ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Në kuadër të kësaj veprimtarie, bazuar në nenin 32 gërma c, ë), të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, po paraqesim informacionin si më poshtë.

## 2. Në lidhje me faktet për shkeljen e ligjit, sqarohet si vijon:

- Pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, në dt. 2.4.2013, është paraqitur qytetarja A. C., e cila ka pretenduar se ajo së bashku me dy fëmijët e saj ka rreth 15 ditë pa ujë dhe energji elektrike. Ndërkohë që ajo ndodhet në këtë situatë, është shtatzënë në muajin e nëntë dhe pret të lindë nga dita në ditë. Sipas saj, shkak është bërë fakti se, ish-bashkëshorti i saj, në emër të të cilit është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, përkatësisht nga këto dy subjekte, ka kërkuar pezullimin e përkohshëm të kontratave me CEZ shpërndarje sh.a., Rajoni Tiranë, dhe me Ndërmarrjen Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë.
- Ajo ka zgjidhur martesën me bashkëshortin dhe vazhdon të jetojë në banesën bashkëshortore me dy fëmijët nga martesa me ish-bashkëshortin, ndërkohë që vetë është shtatzënë në muajin e nëntë nga një lidhje e re. Gjithashtu, ajo shpjegon se është në proces gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore dhe aktualisht, çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë.
- Ish-bashkëshorti, duke shfrytëzuar vendimin e gjykatës së Apelit Tiranë, në lidhje me pjesëtimin e pasurisë, si dhe faktin se vetëm ai njihet si kontraktues i këtyre shërbimeve, ka kërkuar pezullimin e përkohshëm të kontratave me CEZ shpërndarje sh.a., Tiranë dhe me Ndërmarrjen Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë.
- Ndërmarrja CEZ shpërndarje sh.a. dhe Ujësjellës Kanalizime, Tiranë, kanë vepruar menjëherë në përgjigje të kësaj kërkesë, duke zgjidhur kontratat e energjisë dhe të ujit, me pasojë ndërprerjen e energjisë elektrike dhe ujit në banesë.
- Subjektet janë vënë në dijeni, se në banesë banojnë ish-bashkëshortja me dy fëmijët; nga ana e saj znj. A. C., ish-bashkëshorte, ka kërkuar dhe ka shprehur gatishmërinë që kontratat e furnizimit të vazhdojnë edhe në emrin e saj, deri në përfundim të gjykimit, por të dyja subjektet e sipërpërmendura kanë refuzuar të ofrojnë shërbime, duke pretenduar se kontrata është vetëm në emrin e kryefamiljarit dhe ata njohin vetëm atë si kontraktues.
- Drejtoria Rajonale Tiranë, me shkresën e saj të dt. 30.03.2013, e cila i është dorëzuar ankueses më 5.4.2013, i përgjigjet asaj se në kryerjen e këtij veprimi, Ndërmarrja CEZ është bazuar në nenin 5.3 të Kontratës tip për furnizim me energji elektrike, të miratuar me Vendim të ERE-s, që vendos: “*Klienti mund të kërkojë pezullimin e kontratës për një periudhë të caktuar sipas kërkesës së tij. Furnizuesi do të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara për këtë qëllim. Klienti do bëjë kërkesë për rilidhjen e energjisë pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit*”. Në përfundim, Ndërmarrja i kërkon qytetares që t’i drejtohet gjykatës për të marrë një masë sigurimi padie për rilidhjen e energjisë elektrike.
- Ndërkohë, pranë Drejtorisë e ujësjellësit, Tiranë, qytetarja nuk ka dërguar ndonjë ankesë me shkrim, por është ankuar me gojë pranë sportelit përkatës për pritjen e qytetarëve dhe ka marrë, në përgjithësi të njëjtën përgjigje.

## 3. Arsyetimi i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare mbi informacionin shkeljen e ligjit "Për mbrojtjen nga Diskriminimi", nga të dyja subjektet e sipërpërmendura. Duke marrë shkas nga ky rast, ne si Qendër parashtrijmë se, CEZ shpërndarje sh.a., Tiranë dhe Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime Tiranë, kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9970 datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, si dhe me Ligjin nr. 10221 datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga

diskriminimi". Së pari, këto subjekte nuk kanë mbajtur parasysh faktin se, në këtë banesë, banojnë ish-bashkëshortja me fëmijët e mitur, të cilët kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat elementare për ujë, në bazë të legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar; së dyti, nuk ka asnjë titull ekzekutiv që të urdhërojë zgjidhjen e kontratave të ish-bashkëshortit me të dyja subjektet dhe këto veprime janë kryer ndërkohë që nëdorësit e ligjshëm banojnë në shtëpi; së treti, Këto subjekte nuk e njohin aksesin e barabartë që duhet të kenë bashkëshortët apo ish-bashkëshortët, për të kontraktuar shërbimet e ujit dhe të energjisë elektrike. Në aktet e tyre ligjore e nënligjore, përveç emërimit Klienti familjar, nuk ka asnjë dispozitë tjetër që mbron familjen nga mungesa e aksesit ndaj energjisë dhe ujit, në rastin e abuzimit që bën titullari i kontratës me të drejtën e tij si titullar i palës kontraktuese. Faktikisht, këto kontrata përmbushen duke realizuar detyrimet nga të dy bashkëshortët, duke paguar rregullisht së bashku të gjitha detyrimet për energjinë elektrike dhe ujin e shpenzuar. Prandaj, fakti që kontrata lidhet vetëm në emër të bashkëshortit, nuk do të thotë mohim i të drejtave të bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre. Për më tepër, në rastin e Znj. A. C., ish-bashkëshorti i saj është larguar nga banesa në vitin 2007 dhe të gjitha detyrimet deri më sot, janë paguar rregullisht prej saj.

Në kontratën tip të miratuar me vendim të ERE-s, për furnizimin me energji elektrike për klientët familjarë, edhe pse një emërtim i tillë, nuk parashikohet asnjë përkufizim se çfarë do të thotë klient familjar, se cila do të jetë pozita e Titullarit të Palës kontraktuese, kur kjo e fundit është familje, nuk ka të parashikuar asnjë detyrim për respektimin e familjes, fëmijëve, bashkëshortëve, të moshuarve, ose të familjarëve që banojnë nën të njëjtën strehë me titullarin e kontratës së furnizimit. Kontrata sillet ndaj titullarit të palës kontraktuese familjare, sikur ky të ishte një njeri i vetëm dhe ka një mënyrë aq liberale, sa ç'mund të ndodhte me lirinë kontraktore të një subjekti privat çfarëdo. Kështu, në kontratë nuk ka asnjë kusht për lirinë e titullarit kontraktues për ndërprerjen ose pezullimin e saj, duke i dhënë mundësi këtij të fundit, që të abuzojë me këtë të drejtë. Për rrjedhojë, në këtë rast, është shkelur parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve, parimi i barazisë gjinore, si dhe parimi se interesi i fëmijës është interesi më i lartë, parime të parashikuara nga Kushtetuta e

RSH, ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri", si dhe nga aktet ndërkombëtare.

Praktika e sipërpërmendur reflekton se ka një diskriminim të Znj. A. C., në raport me bashkëshortin e saj, jo vetëm diskriminim për shkak të të qenurit grua, por edhe për shkak të statusit civil si grua e divorcuar. Mendojmë se mund të jetë fjala edhe për diskriminim për shkak të shtatëzënisë së Znj. A.C., pasi ajo është duke pritur një fëmijë nga një lidhje të re që ka krijuar pas divorcit dhe është shtatëzënë në muajin e nëntë pas kësaj lidhjeje. Përfundimisht, mendojmë se ka diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë, shtatëzënisë, gjendjes martesore, gjendjes civile. Mosmarrja e masave të përshtatshme për eliminimin e pabarazisë kontraktore në kuadrin e ofrimit të shërbimeve nga këto ente publike, do të na shpinte në një precedent të rrezikshëm për të gjitha rastet e tjera kur bashkëshortët mbështetur në tituj kontraktuesish, përdorin mjete të paligjshme dhe abuzive për të ushtruan presion ose dhunë psikologjike mbi bashkëshortin tjetër, ose mbi anëtarët e tjerë të familjes, duke përdorur institucionet publike.

Praktikat diskriminuese bien ndesh me detyrimet e shtetit shqiptar si shtet Palë i Konventës së OKB-së, "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave" CEDAW, e konkretisht me detyrimet që i burojnë nga neni 2, pika d) *Të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim;* pika e) *Të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave nga çdo individ, organizatë apo ndërmarrje; dhe pika f) Të marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për të ndryshuar ose shfuqizuar ligjet ekzistuese, rregulloret, zakonet dhe praktikat të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj grave.*

Për sa më sipër :

Ju lutemi ushtroni kompetencat tuaja për ndalimin e diskriminimit nga këto dy subjekte në ofrimin e shërbimeve, bazuar në nenin 32 germa c, dh, e, ë të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" si dhe të nenit 2, pika f, të "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", dhe rekomandoni:

**I. Rekomandim për zgjidhjen e rastit konkret.**

1. Rekomandim në lidhje me rastin konkret, ndaj Ndërmarrjes së CEZ shpërndarje sh.a. dhe Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime, Tiranë, që të ndalojnë urgjentisht diskriminimin dhe të ofrojnë menjëherë furnizimin me energji elektrike dhe me ujin e pijshëm të banesës, në të cilën Znj. A. C., dhe dy fëmijët banojnë si nëdorës të ligjshëm.

**II. Rekomandim të Përgjithshëm.**

2. Rekomandim të përgjithshëm ndaj Entit Rregullator të Energjisë (ERE) që të ndryshojë dhe reformojë Kontratën Tip, mbi “Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë”, duke parashikuar dispozita të qarta dhe përkufizimin e "Klientit Familjar", me qëllim që të mos mohohet e drejta e furnizimit me energji elektrike të anëtarëve të familjes, të cilët nuk janë pala kontraktuese, por që janë banorë të banesës së kontraktuar.
3. Rekomandim të përgjithshëm ndaj Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me ujë dhe Largimit të Përpunimit të Ujërave të Ndotura, që të parashikojë dispozita të qarta, për të rregulluar furnizimin me energji në mënyrë të barabartë për bashkëshortët dhe anëtarët e tjerë të familjes, sipas nevojave të tyre, për të mos mohuar të drejtën e furnizimit me ujë të pijshëm të anëtarëve të familjes, të cilët nuk janë pala kontraktuese, por që janë banorë të banesës së kontraktuar.
4. Rekomandim i përgjithshëm Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe ndaj Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me ujë dhe Largimit të Përpunimit të Ujërave të Ndotura, që të rishikojnë të gjitha dispozitat e akteve të tyre nënligjore, si dhe praktikën e tyre të deritanishme, me qëllim që ato të përputhen me parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, të sanksionuar në Kushtetutë, në Konventat ndërkombëtare, në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe ligjin nr. 9970 datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

**6****VENDIM I GJYKATËS SË SHKALLËS  
SË I-RË TIRANË, "PËR LËSHIMIN E  
URDHRIT TË MBROJTJES"<sup>4</sup>**

**Kërkuese,** Znj. F. Rr. përfaqësuar me deklaram në seancë gjyqësore nga Av. Iris Aliaj, avokate pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.

**Faktet shkurt.** Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është paraqitur kërkesë-padia me objekt: “Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes”. Gjatë gjykimit, paditësja pretendoi: "me të paditurin jemi ish-bashkëshortë. Që prej 7 vjetësh jemi ndarë ligjërish me vendimin të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Nga martesë kemi dy fëmijë madhorë. I padituri ka ushtruar në mënyrë të vazhdueshme dhunë fizike dhe psikologjike ndaj meje, e cila ka qenë edhe shkaku kryesor i zgjidhjes së martesës. Që në vitin 2004 kam marrë urdhër mbrojtje për 5 vjet kundër të paditurit në shtetin Italian ku jetonim, dhe kam qenë e strehuar në qendrat sociale në Itali, për shkak të frikës nga dhuna e ushtruar prej tij. Unë, që nga viti 2009 jetoj në Shqipëri, duke pasur vendqëndrim edhe në Shqipëri, edhe në Itali dhe, që nga nëntori i vitit 2012, kam ardhur të jetoj në Shqipëri, përgjithmonë. I padituri ka vazhduar të më kërcënojë, pasi nuk pranon faktin që jemi ndarë. Rasti i fundit i dhunës ka qenë në datën 07.01.2013. Rreth orës 10.00, i padituri erdhi në shtëpinë ku jetoj me vajzën time dhe filloi të binte derës me forcë, duke thënë fjalë të rënda dhe ofenduese, duke më kërcënuar për jetën dhe shëndetin, me shprehjet: “Do të vras, do të zhduk, do të heq qafën, do të paguash për këtë”, dhe fjalë ofenduese që nuk duam t'i përmendim. Vajza njoftoi policinë, e cila ka ardhur dhe e ka shoqëruar në Komisaratin përkatës në Tiranë. Kemi dhënë shpjegime të dyja palët dhe kam bërë kërkesën për urdhrin e mbrojtjes.

Paditësja i kërkon gjykatës të marrë masat e mbrojtjes që vijojnë: i padituri të mos kryejë dhe të mos kërcënojë se do të kryejë vepër dhune në familje; të mos cenojë, ngacmojë apo kontaktojë me mua, dhe të mos më afrohet në një distancë prej 500 m; të mos i afrohet banesës në të cilën banoj e ndodhur në Rrugën XXX; i padituri të mos lejohet të hyjë e të qëndrojë në banesën në të cilën banoj. Gjithashtu, paditësja kërkoi që ky urdhër të ketë

4. Përmbledhje e vendimit nr.1171, dt. 11.02.2013, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë, V. Zaimi

efekt deri në një vit.

I padituri në mungesë.

**Arsyetimi i Gjykatës:** Gjykata çmon se për zgjidhjen e çështjes duhet t'i referohemi çështjeve të mëposhtme:

**I) Do të analizojmë nëse palët janë subjektet që mbrohen nga ligji.**

Në nenin 3/2 të Ligjit Nr.9669 Dt.18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" parashikohet se: "*Dhunë në familje*" është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare". Palët ndërgjyqëse përfaqësojnë njëerën prej disa kategorive të subjekteve që merren në mbrojtje nga dispozita e mësipërme e Ligjit, konkretisht pika "a" e tij (ish - bashkëshortë), prandaj legjitimohen në këtë proces.

**II) Do të provojmë nëse ekzistojnë baza për të besuar se i padituri ka kryer apo ka kërcënuar se do të kryejë dhunë në familje, fizike apo psikologjike.**

Në nenin 1 dhe 2 të këtij ligji parashikohet se marrja e një apo më shumë masave kundër dhunës në familje synon t'u vijë në mbrojtje subjekteve të këtij ligji, siguria, shëndeti apo mirëqenia e të cilëve, kërcënohet nga veprimet e dhunshme fizike ose psikologjike të një apo më shumë individëve, njëherësh subjekte të këtij ligji. Neni 3 i ligjit 9669 dt.18.12.2006 përkufizimin e dhunës në familje e ka parashikuar si më poshtë: "Dhunë është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, ekonomik". Në rastin konkret paditësja pretendon se siguria, shëndeti apo mirëqenia e saj rrezikohet seriozisht nga veprimet kërcënuese të të paditurit dhe se për shmangien e këtij rreziku është e nevojshme të merren masat mbrojtëse të kërkuara prej saj.

Gjykata, duke pasur parasysh vështirësitë që mbart procesi i të provuarit në konfliktet brenda familjes, të cilat në pjesën më të madhe të tyre nuk kanë dëshmitarë, si në rastin konkret, si dhe mundësinë e abuzimit me instrumentin ligjor të urdhrit të mbrojtjes nga ana tjetër, në bazë të nenit 15/3 të ligjit nr.9669 dt.18.12.2006, e mbështet vendimin e saj në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje dhe në bindjen e saj të brendshme.

Nga pohimet gjyqësore të palëve në gjykim dhe nga deklaratimet e tyre të dhëna para Komisarariatit të Policisë, të cilat u morën në cilësinë e provave në gjykim, gjykata çmon se provohen pretendimet e palës paditëse.

Edhe fakti që paditësja ka pasur urdhër mbrojtjeje në shtetin Italian, tregon se i padituri në vazhdimësi ka ushtruar dhunë fizike e psikologjike ndaj paditëses.

Duke u bazuar në ligjin Nr. 9669 dt. 18.12.2006, gjykata çmon se duhet të lëshohet urdhri i mbrojtjes për paditësen për arsyet e mëposhtme:

**Së pari:** Gjatë gjykimit u provua se midis paditëses dhe të paditurit ka ndodhur një konflikt, ku është ushtruar dhunë fizike e psikologjike ndaj paditëses.

Pra, ekzistojnë fakte për të besuar që i padituri, ka ushtruar dhunë fizike e psikologjike ndaj paditëses, i cili është ish-bashkëshorti i paditëses.

**Së dyti:** Me veprimet e tij, i padituri paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e paditëses.

**Së treti:** Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes është i nevojshëm pikërisht për shkaqet e parashtruara më sipër për të mbrojtur sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e paditëses, nga dhuna fizike e psikologjike.

**III) Të vlerësohen se cilat do të jenë masat e nevojshme mbrojtëse për sigurinë, shëndetin mirëqenien e viktimës së dhunës në familje.**

Në bazë të nenit 10 dhe 17 të Ligjit Nr. 9669 dt. 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Gjykata çmon se masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, të përshtatshme për të mbrojtur sigurinë e shëndetin e paditëses, janë si më poshtë:

- i padituri Rr.Rr të mos kryejë dhe të mos kërcënojë se do të kryejë vepër dhune në familje ndaj paditëses F.Rr.

- i padituri Rr.Rr të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejtë apo tërthorazi me paditësen F.Rr.

- i padituri Rr.Rr të mos i afrohet paditëses F.Rr, përtej një distance prej 500 m.

- i padituri Rr.Rr të mos i afrohet shtëpisë në të cilën banon paditësja F.Rr, e ndodhur në Rr. XXX.

-i padituri Rr.Rr të mos lejohet të hyjë e të qëndrojë në shtëpinë në të cilën banon aktualisht paditësja

F.Rr, e ndodhur në Rr. XXX.

Gjykata çmon se, ky urdhër mbrojtjeje duhet të ketë efekt për një kohë prej 12 muaj, duke filluar nga data 11.02.2013 deri në 11.02.2014, që është koha maksimale që parashikon ligji për t'i siguruar paditëses një mbrojtje efektive ndaj dhunës dhe është kohë e mjaftueshme për të normalizuar marrëdhëniet midis palëve.

Shkelja e këtij vendimi përbën vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal.

Në këto kushte Gjykata, bazuar në nenin 17 e vijues të ligjit Nr. 9669 dt. 18.12.2006, çmon që duhet lëshuar urdhri i mbrojtjes, duke pranuar kërkesën.

**Vendimi i Gjykatës:** Gjykata, bazuar në nenin 306, 310 të K.Pr.Civile dhe ligjit Nr. 9669 dt. 18.12.2006, vendosi:

- Pranimin e kërkesë-padisë.
- Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për paditësen që konsiston në marrjen e masave si më poshtë:
- Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos kryejë dhe të mos kërcënojë se do të kryejë vepër dhune në familje ndaj paditëses F.Rr.
- Urdhërohet i padituri Rr.Rr që të mos cenojë,

ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi me paditësen F.Rr.

- Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos i afrohet paditëses F.Rr, përtej një distance prej 500 m.
- Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos i afrohet shtëpisë në të cilën banon paditësja F.Rr, e ndodhur në Rr. XXX.
- Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos lejohet të hyjë e të qëndrojë në shtëpinë në të cilën banon aktualisht paditësja F.Rr, e ndodhur në Rr.XXX.
- Ky urdhër i fillon efektet që nga dt. 11.02.2013 deri në dt. 11.02.2014.
- Shkelja e këtij vendimi përbën vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal.
- Një kopje e këtij vendimi dërgohet në Komisarriatin e Policisë Nr. \_\_, Tiranë, për komunikim.
- Një kopje e këtij vendimi dërgohet në Zyrën e Shërbimeve Sociale nr.\_\_ për komunikim.
- Shpenzime gjyqësore nuk ka.
- Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit, Tiranë, brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së tij.
- Për të paditurin Rr.Rr në mungesë, ky afat fillon nga dita e komunikimit të tij.



## II. Jurisprudenca Ndërkombëtare

### Vendime të Komitetit të CEDAW-t

#### 1

#### V.K. KUNDËR BULLGARISË MBROJTJA NGA DHUNA NE FAMILJE

CEDAW/C/49/D/20/2008

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit  
kundër Grave.

Data e adoptimit të vendimit: 25 korrik 2011

#### Komunikimi nr. 20/2008

**I dorëzuar nga:** Zonja V.K. (përfaqësuar nga  
këshilltarja ligjore znj. Milena Kadieva)

**Viktima e pretenduar:** Kërkuesja

**Shteti Anëtar:** Bullgaria

**Data e komunikimit:** 15 tetor 2008 (dorëzimi i  
parë i kërkesës)

#### Pikëpamjet sipas nenit 7, paragrafi 3, i Protokollit Fakultativ

1. Autorja e komunikimit të datës 15 tetor 2008 është një qytetare bullgare. Ajo pretendon të jetë një viktimë e dhunës si pasojë e shkeljes nga pala shtetërore e neneve 1; 2; 5 dhe 16 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. Konventa dhe Protokollit Fakultativ kanë hyrë në fuqi për palën shtetërore respektivisht në 10 mars 1982 dhe në 20 dhjetor 2006.
2. **Faktet siç u paraqitën nga autorja**
  - 2.1. Kërkuesja dhe F.K. janë martuar në 1995. Ata kishin një vajzë, D.K., e lindur në 1997 dhe një djalë, A.K., i lindur në 2001.
  - 2.2. Kërkuesja pretendon se për vite me radhë ka qenë një viktimë e dhunës në familje e ushtruar nga bashkëshorti i saj. Në fillim, ajo ishte viktimë e abuzimit psikologjik, emocional dhe ekonomik, ndërsa në 2006 dhe në 2007 edhe subjekt i dhunës fizike. Abuzimi ka

ndodhur edhe më parë, por sidomos kur familja u zhvendos në Poloni në 2006, për shkak të punës së bashkëshortit ai u shtua. Asaj nuk i lejohej të punonte, pavarësisht shkollimit dhe kualifikimit. Bashkëshorti vendoste i vetëm për shpenzimet mbi të ardhurat e familjes, ndërsa autores i jepte para vetëm për nevojat bazë të familjes. Asaj nuk i ngelej asnjë lek shtesë për veten e saj dhe nuk i lejohej që të shpenzonte për qëllime të tjera, përveçse për ato që i ishin përcaktuar në mënyrë strikte. Po kështu ajo nuk informohej se si shpenzohej pjesa tjetër e të ardhurave të bashkëshortit. Si rezultat, ishte plotësisht e varur ekonomikisht prej bashkëshortit të saj.

- 2.3. Gjatë gjithë martesës së tyre, bashkëshorti i kërkueses e ka trajtuar atë më tepër si një shtëpiake, sesa si një bashkëshorte dhe partnere. Ai nuk diskutonte me të ndonjë çështje që lidhej me familjen dhe kërkonte që të mos shprehte opinionin e saj. Kërkuesja pretendon se asaj nuk i lejohej të komunikonte lirisht me shoqet dhe me familjen e saj. Për vite me radhë ajo është ndier e përbuzur dhe e shtypur. Përpjekjet e saj për të diskutuar marrëdhëniet rezultuan në konflikte të shpeshta, po kështu edhe në abuzime fizike prej bashkëshortit në vitet 2006-2007.
- 2.4. Në vitin 2006, përpara se të largohej për në Bullgari për periudhën e verës, kërkuesja i tha bashkëshortit se ajo do të divorcohej nga ai, sepse ajo nuk mund të jetonte një jetë pa punuar dhe pa marrëdhënie shoqërore. Bashkëshorti iu përgjigj se ajo mund të bënte çfarë të donte, por se ajo nuk do të lejohej që të merrte fëmijët me vete. Si rezultat ajo u detyrua të mbetej e lidhur dhe të kthehej në Poloni me bashkëshortin.
- 2.5. Në 31 dhjetor 2006, gjatë pushimeve të tyre në Sofje, kërkuesja dhe bashkëshorti i saj patën një grindje, sepse ajo vendosi që të mos ndiqte këshillat e tij në lidhje me një shumë të caktuar parash që ai ia kishte dhënë. Kur ajo refuzoi që t'i kthente atij mbrapsht shumën e parave, ai u bë i dhunshëm dhe agresiv duke i bërtitur, duke e sharë, duke e kërcënuar dhe duke e goditur

atë. Në atë kohë prindërit e gruas i telefonuan dhe e kuptuan që ajo ishte abuzuar. Direkt mbas telefonatës, ata i telefonuan policisë dhe shkuan në Sofje në ndihmë të saj dhe të fëmijëve. Policia mbërriti dhe morën në pyetje bashkëshortët mbi atë që kishte ngjarë. Bashkëshorti u largua nga apartamenti gjatë natës. Në 1 janar 2007 autorja shkoi në Spitalin “Aleksandrovska University” në Sofje. Nga spitali u lëshua një raport mjekësor, i cili vërtetonte goditjet dhe plagët në ballin e saj, si dhe në të dyja duart duke theksuar se, “Këto dëmtime kanë ardhur si rezultat i goditjeve me mjete të forta të shkaktuara sipas mënyrës dhe në kohën që raportohen nga personi i ekzaminuar. Këto dëmtime i kanë shkaktuar asaj dhimbje dhe vuajtje”.

- 2.6. Në një datë të papërcaktuar burri i kërkueses supozohet ta ketë shtyrë atë tek muri në mënyrë që t’i mbyllte gojën. Ai i kishte kërkuar vajzës së tyre që t’i sillte atij një litar për ta lidhur gruan duke thënë se ajo është një e çmendur. Më pas kanë ndjekur konflikte të shpeshta. Kështu, duke kuptuar që bashkëshortja e tij donte të kishte një jetë sociale dhe të shkonte në punë, bashkëshorti i ndërpret gruas dhe fëmijëve mbështetjen financiare duke u përpjekur që ta bënte gruan që të “sillej mirë” dhe të “bindej”. Meqë gruaja e kishte të pamundur që të kujdesej për dy fëmijët pa ndonjë të ardhur ajo filloi punë në mars 2007.
- 2.7. Në 12 prill dhe në 22 maj 2007, autorja plotëson një formular drejtuar Gjykatës së rrethit gjyqësor Varshavë për të kërkuar masa mbrojtëse, si dhe një vendim për të detyruar bashkëshortin e saj të paguante për mbështetjen financiare të fëmijëve të tyre. Në 22 maj 2007 ajo i dërgoi Gjykatës së rrethit gjyqësor të Varshavës një kujtesë. Shqyrtimi gjyqësor ishte akoma i pezulluar gjatë kohës së dorëzimit të parë të komunikimit.
- 2.8. Në 30 prill 2007, kur autorja i kërkoi bashkëshortit të saj që të paguante për nevojat jetike të familjes, ai i mbylli fëmijët në një dhomë dhe e paralajmëroi atë se, ajo nuk do të kishte ndonjë mundësi të mbante fëmijët nëse ajo nuk do t’i bindej atij. Ai i bërtiti duke i thënë se ajo nuk duhej më, sepse fëmijët ishin rritur tashmë dhe një dado do ta zëvendësonte fare mirë. Fëmijët u trembën. Në inat e sipër ai filloi që ta godasë gruan, si dhe u përpoq që ta mbyste atë me anë të një jastëku. Gruaja luftoi për jetën

e saj dhe po përpiquej të merrte frymë.

- 2.9. Në 26 qershor 2007, gruaja është rrahur nga bashkëshorti i saj, i cili e ka shkëllmuar atë nga këmbët. Si rezultat i këtyre goditjeve ajo u rrëzua dhe dëmtoi femurin dhe kockat e legenit. Në 2 korrik 2007 ajo u vizitua nga një doktor, i cili konfirmoi se ajo ka 1- “një plagë (dëmtim) në lëkurën e pjesës së ijëve”, 2- “Dy plagë (dëmtime) në lëkurën e eshtrave të legenit”, 3- Një plagë (dëmtim) në fillim të këmbës së djathtë”. Raporti mjekësor konkludoi që “dëmtimet e përmendura më sipër mund të kenë ndodhur në kohën dhe në kushtet e parashtruara nga pacientja”.
- 2.10. Në 7 korrik 2007, bashkëshorti filloi procedurat për divorc në Sofje pa e informuar gruan, duke kërkuar gjithashtu edhe kujdestarinë e fëmijëve.
- 2.11. Kërkuesja vendosi që ta linte bashkëshortin, të merrte fëmijët dhe të kërkonte strehë në një qendër strehimi për gratë e dhunuara me ndihmën dhe me asistencën ligjore të “Qendrës për të Drejtat e Grave” në Varshavë. Në 27 korrik 2007, ajo shkoi tek apartamenti i familjes së bashku me një përfaqësuese të Qendrës për të mbledhur gjërat e saj personale dhe të fëmijëve të saj. Bashkëshorti erdhi në shtëpi më herët dhe filloi të bënte sherr. Ai i mbylli fëmijët në apartament. Kërkuesja dhe përfaqësuesja e Fondacionit (Qendrës) lajmëruan policinë. Kur arriti policia atëherë gruaja mundi të merrte vajzën e saj. Megjithatë, djali i saj mbeti i mbyllur në apartament. Ajo dhe vajza u strehuan në Qendër, në Varshavë deri në 23 shtator 2007. Për dy muaj bashkëshorti i mohoi kërkueses çdo mundësi për të kontaktuar djalin, i cili ishte në një gjendje shoku që mbas ngjarjeve që ndodhën në 27 korrik 2007, duke patur nevojë që të shtrohej në spital. Bashkëshorti nuk i tregoi gruas mbi shtrimin në spital të djalit. Në 31 korrik 2007 i biri i saj u hoq nga kopshti publik dhe u transferua në një kopsht privat. Bashkëshorti e kishte udhëzuar drejtoreshën e kopshtit që të mos lejonte gruan të takonte djalin e saj. Në dy raste bashkëshorti u paraqit tek Qendra dhe kërkoi të dinte se ku ishte e bija. Në 14 gusht 2007 në vizitën e tij të dytë tek Qendra ai ishte i dhunshëm dhe agresiv, kështu që stafi ishte i detyruar të lajmëronte policinë, për ta larguar atë nga banesa.

- 2.12. Në 20 gusht 2007, Fondacioni depozitoi një padi penale në zyrën e prokurorisë së Varshavës në ngarkim të të pandehurit.
- 2.13. Në 21 shtator 2007, autorja (gruaja) arriti që të gjejë se ku ndodhej djali i saj dhe shkoi që ta takonte atë tek kopshti që ndodhej së bashku me përfaqësuesen e Qendrës (Fondacionit). Bashkëshorti i saj, i thirrur me telefon nga drejtoresha, erdhi tek kopshti dhe u soll dhunshëm ndaj gruas dhe ndaj përfaqësueses së Qendrës (Fondacionit) duke i goditur të dyja ato. Policia u detyrua që ta kufizoi atë në një makinë policie.
- 2.14. Mbas kësaj, gruaja e mori djalin dhe së bashku me të dy fëmijët u largua nga Polonia për në Bullgari që të fshihej nga bashkëshorti i saj që të kërkonte mbrojtje dhe mbështetje emocionale nga familja e saj, si dhe asistencë ligjore.
- 2.15. Në 27 shtator 2007, autorja depozitoi një kërkesë pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor të Plovdiv, në Bullgari, bazuar në nenin 18 (1) të ligjit "Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje", e regjistruar si çështje civile Nr. 327312007 duke kërkuar që të nxirrej një Urdhër Mbrojtje i Menjëhershëm ndaj bashkëshortit. Ajo gjithashtu, kërkoi që Gjykata të imponojë masa sipas nenit 5, paragrafi 1, pika 1,3 dhe 4 të Ligjit "Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje" për një periudhë për 1 vit, d.m.th. për të urdhëruar bashkëshortin e saj të mos kryejë dhunë në familje ndaj saj dhe fëmijëve të saj (pika I), si dhe të mos i afrohet shtëpisë ku ata jetojnë, apo vendit ku ata janë duke qëndruar, të paktën me një distancë jo më pak se 500 metra, duke përfshirë shtëpinë e prindërve të saj, shkollën dhe kopshtin e fëmijëve, vendin e saj të ardhshëm të punës, si dhe çdo vend ku ajo do të përfshihet në aktivitete sociale (pika 3). Sipas nenit 5, pika 4, e ligjit ajo gjithashtu kërkoi kujdestarinë e përkohshme të fëmijëve.
- 2.15. Në 27 shtator 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Plovdiv lëshoi një Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje, bazuar mbi nenin 18, të ligjit, "Për mbrojtjen ndaj dhunës në familje". Gjykata gjithashtu vendosi që qëndrimi i përkohshëm i fëmijëve do të ishte me të ëmën.
- 2.16. Me anë të vendimit të saj të datës 18 dhjetor 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Plovdiv hodhi poshtë kërkesën e gruas për një Urdhër Mbrojtje në bazë të Ligjit "Për Mbrojtjen ndaj

Dhunës në Familje". Gjykata aplikoi nenin 10, paragrafi 1 të këtij ligji, i cili thotë se kërkesa për një Urdhër Mbrojtje duhet të dorëzohet brenda një muaji nga data në të cilën është kryer akti i dhunës në familje, gjatë asaj periudhe një mujore që i paraprinte kërkesës së autores për Urdhër Mbrojtje (nga data 27 gusht deri në 27 shtator 2007). Gjithashtu Gjykata konkludoi se nuk u konstatua ndonjë rrezik ndaj jetës e shëndetit të autores, si dhe të fëmijëve të saj.

- 2.17. Në 7 prill 2008, Gjykata Rajonale e Apelit të Plovdiv e hodhi poshtë apelimin e çështjes nga autorja, duke mbështetur vendimin me anë të të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor kishte refuzuar të nxirrte një Urdhër Mbrojtje të Përherëshëm.
- 2.18. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, autorja dhe fëmijët e saj mbetën pa ndonjë mbështetje apo mbrojtje nga ana e palës shtetërore, ndërsa procedura për divorc e nisur nga bashkëshorti i autores u la pezull në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Plovdiv. Bashkëshorti i saj vazhdonte të vizitonte fëmijët. Në verën e vitit 2008 ai depozitoi një ankesë në Zyrën e Prokurorisë së Sofjes me objekt moslejimin e hyrjes së tij në apartamentin e kërkueses, i cili në fakt ishte i vetmi vend i sigurt ku ajo dhe fëmijët e saj mund të kishin një jetë normale. Ai gjithashtu, depozitoi edhe një padi civile për ndarjen e pronës familjare përpara se të përfundonte procedura e divorcit. Ai u ankua se asnjë Gjykatë bullgare nuk mund t'ia linte kujdestarinë e fëmijëve gruas, për shkak të të ardhurave të ulta të saj, duke e paralajmëruar atë se ajo nuk mund t'i përbalonte gjatë procedurat gjyqësore.
- 2.19. Në 8 maj 2009, pak më shumë se 1 vit nga hedhja poshtë e apelimit të çështjes së saj nga Gjykata Rajonale e Apelit të Plovdiv, po kjo gjykatë e zgjidhi martesën.

### 3. Ankesa

- 3.1. Kërkuesja pretendon përpara Komitetit të CEDAW-t se është viktimë e shkeljes së neneve 1, 2 pikat (a) – (c) dhe (e) – (g), të nenit 5 pika (a) dhe të nenit 16 paragrafi (1) pika (c), (g) dhe (h) të Konventës, e lexuar nën dritën e rekomandimit të përgjithshëm nr.19, të vitit 1992, të Komitetit "Mbi Dhunën kundër Grave" për shkak të dështimit të palës shtetërore për t'i dhënë asaj një mbrojtje efektive kundër dhunës në familje.

3.2. Kërkuesja pretendon se pala shtetërore neglizhoi detyrimet e saj “pozitive” që rrjedhin nga Konventa dhe kjo palë mbështeti vazhdimin e një situatë të dhunës familjare kundër autores (gruas) në kundërshtim me detyrimet e kësaj pale ndaj Konventës.

3.3. Ajo argumentoi se gratë në Bullgari janë shumë herë më të prekura se meshkujt nga dështimi i Gjykatave për ta konsideruar dhunën në familje si një kërcënim serioz për jetën dhe shëndetin e tyre. Duke iu referuar raporteve të shumta të Organizatave Jo-qeveritare, ajo argumentoi se dhuna ndaj grave pengon zbatimin e të drejtave të njeriut për gratë në Bullgari dhe se deri kohët e fundit, dhuna në familje nuk është perceptuar si një problem serioz publik, i cili meriton një rregullim specifik ligjor. Ajo dorëzon fakte se pavarësisht adoptimit të ligjit “Për mbrojtjen ndaj dhunës në familje” (nga Bullgaria) në vitin 2005, gjykatat vazhdojnë që të neglizhojnë detyrimet e tyre për të ndëshkuar ata që kryejnë dhunë në familje. Gjatë zhvillimit të një procedure veçanërisht urgjente gjyqësore civile në rastet e dhunës në familje, ligji dështon në njohjen e dhunës në familje si një vepër penale, apo që të shpallë fajtor për mos-respektim të zbatimit të Urdhrave të Mbrojtjes. Dhuna në familje procedohet vetëm nën dispozitat e përgjithshme mbi rrahjen dhe plagosjen (neni 161 i Kodit Penal). Përveç kësaj disa forma sulmi janë hequr nga procedimi ex-officio nëse kryhen nga një pjesëtar i familjes, megjithatë pala shtetërore i procedon akte të tilla kur ato kryhen nga ndonjë person që nuk është pjesëtar i familjes. Në praktikë, dhuna në familje dënohet vetëm nëse viktimja është vrarë, ose të paktën është plagosur rëndë, ose është dëmtuar në mënyrë të përhershme, por edhe atëherë kemi raste që kjo dhunë kalon pa u ndëshkuar. Ishte pikërisht për këto arsye që kërkuesja nuk e dorëzoi tek autoritetet shtetërore një padi për vepër penale të kryer ndaj saj në lidhje me rastin kur bashkëshorti u përpoq ta mbyste. Ajo pretendon se në rastin konkret Gjykatat e Plovdiv e neglizhuan dhunën e gjatë emocionale, psikologjike, ekonomike dhe fizike të vuajtur prej saj dhe në mënyrë të gabuar vendosën që të dyja palët ishin njësoj përgjegjës për konfliktet e tyre. Gjykatat gjithashtu, nënvlerësuan ndikimin e efekteve negative të dhunës së kryer nga bashkëshorti i

saj mbi rritjen e fëmijëve, si dhe tek drama e tyre emocionale.

3.4. Kërkuesja pretendon se pala shtetërore ka shkelur gjithashtu, të drejtat e saj sipas nenit 2 (a) dhe (b) të Konventës. Ajo thotë se mungesa e një ligji të veçantë mbi barazinë ndërmjet burrave dhe grave, mungesa e njohjes së dhunës të ushtruar ndaj grave si një formë e diskriminimit të tyre, si dhe mungesa e masave pozitive në favor të grave viktimja të dhunës në familje, sjellin një pabarazi në praktikë dhe një mohim të zbatimit në praktikë të të drejtave të njeriut për to. Ajo sjell në vëmendje se në konkluzionet e vëzhgimeve të tij në vitin 1998 mbi Bullgarinë (A/53/38, paragrafët 208-261), Komiteti identifikoi problemet e dhunës ndaj grave, duke përfshirë këtu edhe dhunën në familje dhe e nxiti qeverinë “që të zhvillonte një sërë masash mjekësore, psikologjike e të tjera për të asistuar viktimat gra të dhunës dhe të ndryshonte qëndrimet që dominonin deri atëherë mbi dhunën në familje, të cilin pala shtetërore e kishte konsideruar si një problem privat...”. Kërkuesja gjithashtu, sjell në vëmendje rekomandimin e përgjithshëm nr.19 (të vitit 1992) mbi dhunën ndaj grave, në të cilin Komiteti ka vendosur se dhuna me bazë gjinore, mohon zbatimin e të drejtave të njeriut për gratë, duke përbërë kështu diskriminim ndaj grave sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës. Komiteti vërejtë se palët shtetërore janë përgjegjëse për veprimet private nëse ato dështojnë të veprojnë me kujdes për të mbrojtur dhunimin e të drejtave të grave, apo në hetimin dhe më tej në ndëshkimin e akteve të dhunës të ushtruara ndaj grave. Në rekomandimin e përgjithshëm nr. 21 (të vitit 1994) mbi barazinë e martesës dhe mbi marrëdhëniet në familje, Komiteti ka vërejtur se traditat, zakonet dhe dështimi për të zbatuar ligjet që sigurojnë barazinë dhe mbrojtjen nga dhuna, vijnë në kundërshtim me Konventën. Ajo argumentoi gjithashtu se nëse një grua, si individ, viktimë e dhunës në familje, do të gëzonte zbatimin në praktikë të parimit të barazisë midis burrit dhe gruas, që është vullneti politik i shprehur nga palët shtetërore në sistemet e organeve të drejtësisë, ajo duhet të mbështetet nga këto të fundit duke respektuar detyrimet që kanë këto organe për zbatimin e këtyre parimeve.

3.7. Kërkuesja vëren me shqetësim se Gjykatat

e Plovdiv-it morën parasysh vetëm ngjarjet e datës 21 shtator 2007, pa e parë gjithë historinë e gjatë të abuzimit psikologjik dhe fizik të vuajtur prej saj. Duke vënë në dukje se të dyja palët janë njësoj të përgjegjshme në rastet e konflikteve familjare, Gjyqi e injoroi faktin se i shoqi i saj ishte shumë më i fortë fizikisht se ajo dhe se ai kishte një pozicion kontrollues në martesën e tyre. Vërejtja e gjyqit se ajo nuk ishte ankuar asnjëherë se kishte qenë një viktimë e dhunës në familje në 21 shtator të vitit 2007, i injoronte pretendimet e saj se bashkëshorti e kishte sulmuar atë dhe përfaqësuesen e Fondacionit, e cila e shoqëronte në kopshtin e djalit në datë 21 shtator 2007. Edhe në praninë e policisë sjellja e bashkëshortit të saj ishte e tillë sa që, ai u kufizua nga ana e policisë në një makinë policie. Gjithashtu, gjyqi i injoroi edhe elemente të tjera të sjella nga autorja duke përfshirë faktin se i shoqi i saj i kishte mohuar të drejtën e çdo kontakti me djalin e saj për një periudhë për më shumë se dy muaj. Për më tepër, vendimi i gjykatës ishte shumë i shkurtër dhe i mungonin motivet dhe analizat e situatave të përbaluara prej saj.

3.8. Ankuesja argumenton se mungesa e qartësisë së ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” në lidhje me barrën e provës në procedimin e dhunës në familje është i papërshtatshëm me detyrën e organeve shtetërore për të siguruar mbrojtje ndaj dhunës në familje, si dhe është diskriminues, sepse kufizimet e ligjit sjellin ndikim jo-proporcional mbi gratë që janë viktimat tipike të dhunës në familje. Megjithëse ligji siguron për një kalim të barrës së provës në rastet e dhunës në familje, ai nuk është mjaftueshëm i qartë në këtë pikë. Në vend të kësaj qartësie, barra e provës ndryshon sipas rregullave mbi provat të Kodit të Procedurave Civile. Si rezultat i një trajnimi jo të mjaftueshëm, shumë gjyqtarë vazhdojnë të zbatojnë standardin e “përtej dyshimeve të arsyeshme” në rastet që përfshijnë kërkesat për Urdhër Mbrojtje. Ankuesja pretendon se sipas këtij standardi gjykatat i kërkuan asaj të provonte “përtej dyshimeve të arsyeshme” që ajo ishte sulmuar dhe dëmtuar fizikisht në 21 shtator 2007, si dhe i kërkonin që të sillte prova shkresore për këtë qëllim. Gjyqet dështuan të kthenin barrën e provës në favor të saj, kështu që i privuan asaj një mbrojtje efektive juridike.

Autorja shpjegon se qëllimi i ligjit është të sigurojë një mbrojtje efektive të viktimave të dhunës në familje duke marrë parasysh të gjithë historinë e dhunës së pësuar, ndërsa limiti i kohës prej 30 ditëve në nenin 10 të ligjit, është thjesht një periudhë kohë procedurale për të depozituar ankesat.

3.9. Ankuesja pretendon më tej se organet shtetërore kanë shkelur nenin 2 pika (f) dhe (g) të Konventës, sepse neni 161 i Kodit Penal akoma i përjashton disa forma të caktuara të sulmit prej procedimit ex-officio nëse ato kryhen nga një pjesëtar i familjes. Ajo deklaroi gjithashtu se, edhe nëse një grua është dëmtuar në mënyrë të përhershme, dhuna në familje nuk procedohet gjithmonë. Në lidhje me mungesën e një ligji specifik mbi barazinë gjinore ankuesja shpjegon se draft ligji mbi shanset e barabarta u hodh poshtë nga Parlamenti (bullgar) në 2002 dhe se një ligj “Mbi Mbrojtjen kundër Diskriminimit” u aprovua në 2003 i cili gjithashtu e ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë. Për më tepër, mungesa e studimeve të financuara nga shteti mbi dominimin, mbi shkaqet dhe pasojat të dhunës në familje në mënyrë indirekte e zgjat fenomenin negativ në lidhje me një dhunë të tillë për shkak të mungesës së informacionit mbi numrin e çështjeve të tilla, mbi zgjatjen dhe përhapjen e tyre. Si rezultat as organet publike dhe as shoqëria nuk e kupton atë si një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut që ndikon një grup të gjerë njerëzish, kryesisht të grave dhe të fëmijëve, në rastin konkret të autores dhe të fëmijëve të saj.

3.11. Kërkuesja pretendon se pala shtetërore ka shkelur nenin 1, nenin 5 (a) dhe nenin 16 (1) (c), (g) dhe (h) të Konventës. Ajo deklaroi se dështimi i organeve shtetërore për të adoptuar një qasje gjithëpërfshirëse për të kapërcyer stereotipat tradicionale në lidhje me rolin e gruas në familje dhe në shoqëri, përfshirë këtu edhe masa politike, ligjore dhe ndërgjegjësuese që integrojnë organet shtetërore, shoqërinë civile dhe median, kanë kontribuar në rolin e saj të varur (nga bashkëshorti) gjatë martesës, ku ajo është trajtuar si një shërbyese, pa patur të drejtë të vendosë për asnjë çështje që lidhej me familjen, madje as dhunën në familje që është ushtruar ndaj saj.

3.12. Kërkuesja i kërkon palës shtetërore që: (a) të marrë masa efektive dhe të menjëhershme për

të mbrojtur integritetin e saj fizik dhe mendor dhe atë të fëmijëve të saj; (b) t'i garantojë sigurinë e shtëpisë së tyre dhe të sigurojë që ajo të marrë një mbështetje të duhur për fëmijët, si dhe asistencë ligjore; (c) t'i sigurojë asaj një kompensim të përshtatshëm për dëmtimet fizike dhe mendore që ajo ka vuajtur, në proporcion me shkallën e dhunimit të të drejtave të saj sipas Konventës.

3.13. Kërkuesja pretendon se pala shtetërore duhet të adoptojë masa të përgjithshme në favor të grave viktime të dhunës në familje duke përfshirë në këto masa amendimin e Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje”, në mënyrë që të penalizohen aktet e dhunës në familje dhe të thyerjes së Urdhrit Mbrojtjes, si dhe të sigurojë lëshimin e Urdhrave të Mbrojtjes për aktet e dhunës të kryera edhe përpara periudhës së cilës i referohet neni 10 i këtij ligji; të ndalojë keqbehësit bazuar në shkallën e agresivitetit të veprës penale të kryer; të amendojë ligjet penale për të lejuar një procedim ex-officio në rastet e rrahjeve e plagosjeve të gradës së ulët dhe të mesme kur viktime dhe keqbehësi kanë lidhje me bazë familjare; të sqarojë barrën e provës në procedimet që lidhen me dhunën në familje duke e shprehur qartë që Ligji “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” kërkon kalimin e barrës së provës në favor të viktimës; trajnimin e vazhdueshëm të zyrtarëve publik që janë përgjegjës për zbatimin e ligjit; sigurimi i mbështetjes së duhur për OJQ-të që punojnë për të luftuar dhunën në familje; rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi ndikimin negativ të dhunës në familje mbi gratë dhe fëmijët, si dhe mbi pasojat negative që kjo dhunë ka mbi shoqërinë.

3.14. Kërkuesja deklaron se ajo i ka konsumuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion brenda vendit të saj dhe se kjo çështje nuk është shqyrtuar nën ndonjë tjetër procedurë të hetimit apo vendim-marrjes ndërkombëtare.

#### 4. Vërejtjet e palës shtetërore mbi pranueshmërinë dhe vlefshmërinë

4.1. Në 12 qershor 2009, Pala Shtetërore deklaroi vërejtjet e saj mbi pranueshmërinë dhe vlerat e komunikimit. Duke pranuar në mënyrë të qartë se autorja i kishte konsumuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion brenda

vendit, pala shtetërore hodhi poshtë akuzat e autores si të paarsyetuara në mënyrë të mjaftueshme. Në lidhje me vlefshmërinë, pala shtetërore argumenton se autorja bën akuza gjithëpërfshirëse të një natyre të përgjithshme pa një lidhje të drejtpërdrejtë me rastin e saj. Pala shtetërore jep një pamje të përgjithshme të kornizës së saj legjislative dhe institucionale për të mbrojtur dhe për të mbështetur viktimat nga dhuna në familje, si dhe bën vërejtje të përgjithshme mbi vlefshmërinë e rastit.

4.2. Pala shtetërore nuk hedh poshtë faktet e rastit siç janë prezantuar nga autorja. Megjithatë kjo palë thekson se pjesa më e madhe e ngjarjeve të përfshira në akuzë dhe të referuara prej autores kanë ndodhur në Varshavë dhe kështu ato kanë ndodhur jashtë juridiksionit të palës shtetërore bullgare.

4.3. Në vërejtjet e saj mbi vlerën e rastit pala shtetërore deklaron se janë marrë masat e duhura, bazuar në Konventë për të siguruar një mbrojtje të përshtatshme ndaj dhunës në familje, duke përfshirë këtu edhe adoptimin e legjislacionit specifik. Kështu procedura e shpejtë suigeneris e ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” i vitit 2005, u mundëson gjykatave që të lëshojnë Urdhra Mbrojtjeje të Menjëhershme dhe kalimi i barrës së provës në favor të viktimës ka qenë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare të të drejtave të grave. Në raste të caktuara, kjo procedurë siguron mundësitë për lëshimin e Urdhrave të Mbrojtjes vetëm mbi bazën e deklarimeve të viktimës dhe të adoptojë Urdhra të Menjëhershëm brenda 24 orësh. Në shqyrtimin gjyqësor dokumentet e lëshuara prej organizatave, të cilat mbështesin viktimat e dhunës në familje mund të pranohen si prova.

4.4. Pala shtetërore deklaron se ankuesja nuk e ka kontestuar faktin që procedura e mësipërme ka qenë aplikuar me efektivitet edhe në këtë rast. Kështu, në 27 shtator 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Plovdiv i kreu procedurat sipas nenit 18 të ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” dhe lëshoi një Urdhër për Mbrojtje të Menjëhershme, duke imponuar masa nën pikat 1, 3 dhe 4 të nenit 5 (1), si dhe sipas nenit 5, paragrafi 3 të Ligjit që lidhet me qëndrimin e Përkohshëm të Fëmijëve. Pala shtetërore konkludon se ajo nuk mund të jetë përgjegjëse në lidhje me vazhdimin e situatës së dhunës

në familje. Sipas saj, ankuesja ka dështuar të provojë akuzën e saj se ajo dhe fëmijët u lanë pa mbrojtje nga pala shtetërore mbas vendimit të 18 dhjetorit 2007 me anë të të cilit Gjykata e Rrethit nuk pranoi që të lëshonte një Urdhër të Përhershëm Mbrojtjeje, si dhe gjatë periudhës së procedurave të apelit tek Gjykata Rajonale e Apelit të Plovdiv.

- 4.5. Në lidhje me akuzën e autores që gjykatat e Plovdiv neglizhuan historinë e dhunës në familje të vuajtur prej saj dhe të efekteve negative mbi fëmijët, duke e vendosur barrën e provës krejtësisht mbi të, pala shtetërore deklaroi se në Apel, Gjykata Rajonale e Apelit Plovdiv, vërejti se qëllimi i ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” nuk është që të policohet jeta familjare e bashkëshortëve, por të sigurohet një ndërhyrje urgjente e gjykatës në rastet kur dhuna në familje mund të jetë e pashmangshme; kështu pra kemi periudhën 1-mujore që përcaktohet sipas nenit 10 (1). Kjo periudhë në mënyrë të qartë tregoi për ngjarjet që rrethonin jetën familjare të autores (gruas) dhe bashkëshortit të saj, origjinën e konflikteve të tyre dhe mundësinë e ekzistencës së një mënyre sjelljeje të dhunshme, e cila do të ishte e lidhur me përcaktimin e ashpërsisë së masave të përhershme që do të lëshoheshin ndaj bashkëshortit të saj. Megjithatë, masa të tilla mund të imponoheshin vetëm nëse do të provohej se një akt i dhunës në familje kishte ndodhur gjatë periudhës 1-mujore, sidomos në datën 21 shtator 2007. Në mungesë të kësaj prove kjo çështje nuk u ngrit. Gjyqi vërejti se ndërsa deklarata e autores sipas nenit 9, paragrafi 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” ishte e mjaftueshme për të lëshuar një Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershëm, ndërsa lëshimi i një Urdhri Mbrojtjeje të përhershëm kërkonte një standard më të lartë të provës. U pa se autorja dështoi të provojë që bashkëshorti i saj ka dhunuar integritetin e saj fizik në 21 shtator 2007. Gjykata Rajonale e quajti certifikatën e lëshuar nga Drejtoresha e Qendrës për të Drejtat e Grave si dokument me vlera të kufizuara prove dhe se nuk përmbante ndonjë informacion mbi dhunën e ushtruar nga bashkëshorti. Por, kjo certifikatë thoshte se në 21 shtator 2007, bashkëshorti i autores ka treguar një sjellje agresive dhe se u paralajmërua nga policia që të mos dhunonte integritetin fizik të autores dhe të përfaqësuese së Qendrës për të Drejtat e Grave.

Tek barra e provës, Gjykata Rajonale e quajti raportin mjekësor dhe prova të tjera të treguara “një proces bilateral i mungesës së tolerancës, ndërmjet dy bashkëshortëve, brenda së cilës ndryshimet ndërmjet autorit dhe viktimës së dhunës janë të paqarta”.

- 4.6. Pala shtetërore deklaroi se mungesa e ndonjë ndërhyrjeje të policisë mbas lëshimit të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, i datës 27 shtator 2007 tregon se nuk ka pasur thyerje të urdhrit dhe se është ofruar mbrojtja e nevojshme për autoren dhe për fëmijët e saj.
- 4.7. Pala shtetërore gjithashtu, paraqet që dëshmia e dhënë nga babai i ankueses nuk konfirmoi se kontaktet e saj me familjen ishin kufizuar nga bashkëshorti, ndërsa dëshmia e fëmijëve të saj tregoi se ata nuk ishin të frikësuar nga babai i tyre, duke treguar kështu se ata nuk ishin dhunuar nga babai i tyre.
- 4.8. Në lidhje me ngjarjet e 21 shtatorit 2007 pala shtetërore paraqet që të dyja gjykatat e Plovdiv, Gjykata e rrethit dhe më pas ajo rajonale e apelit, kanë vendosur përtej dyshimit të arsyeshëm që, asnjë akt i dhunës në familje nuk është kryer në atë ditë. Prandaj, as kërkuesja dhe as fëmijët e saj nuk kanë qenë subjekt i dhunës gjatë periudhës 1-mujore së cilës i referohet neni 10 (1) Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje”.
- 4.9. Pala shtetërore konkludon se kërkuesja ka dështuar të provojë akuzën e shkeljes së të drejtave të saj sipas Konventës.
- 5. Masat e përkohshme të mbrojtjes**
- 5.1. Në 12 shkurt 2009, Komiteti, sipas nenit 5, paragrafi 1, të Protokollit Fakultativ dhe sipas rregullit 63 të Rregullores së tij të Procedurave i kërkoi Palës Shtetërore që të merrte masat e duhura të mbrojtjes së përkohshme në favor të gruas dhe të fëmijëve, sepse këto masa do të duheshin për të evituar dëme të pariparueshme për ta, ndërsa komunikimi i tyre ishte nën shqyrtim nga Komiteti. Komiteti gjithashtu i kërkoi Palës Shtetërore që të siguronte mbrojtje dhe integritetin fizik të autores dhe të fëmijëve gjatë gjithë kohës, duke përfshirë edhe rastet kur bashkëshorti i gruas ushtron të drejtat e tij të vizitës në rezidencën e autores. Po kështu, Komiteti e ftoi Palën Shtetërore që të jepte edhe informacion mbi masat e marra për të qenë efektive ndaj kërkesave të Komitetit deri në 13

prill 2009, si afat i fundit.

- 5.2. Pala Shtetërore nuk ju përgjigj kërkesës për masa të përkohshme të mbrojtjes në deklaratën e saj të pranueshmërisë dhe vlefshmërisë të datës 12 qershor 2009. Në 16 qershor 2009, Komiteti e përsëriti kërkesën e tij.
- 5.3. Në 1 korrik 2009, Pala Shtetërore u përgjigj kërkesës së Komitetit duke na thënë se Gjykata e rrethit Plovdiv kishte lëshuar një Urdhër Mbrojtje të Menjëhershëm në 27 shtator 2007 duke urdhëruar bashkëshortin e autores të mos kryente dhunë në familje kundër autores dhe fëmijëve, po kështu të mos i afrohej shtëpisë së autores dhe se vendbanimi i përkohshëm i fëmijëve duhet të ishte me të ëmën deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.
- 5.4. Në 21 korrik 2009, Komiteti informoi Palën Shtetërore se “është kuptimi i Komitetit se Pala Shtetërore po i merr të gjitha masat e nevojshme të mbrojtjes për të evituar dëme të riparueshme ndaj autores dhe fëmijëve të saj, si dhe ka vazhduar me sigurimin e integritetit të tyre mendor dhe fizik”.

## **6. Komentet e Kërkuases mbi vërejtjet e Palës Shtetërore në lidhje me pranueshmërinë dhe vlefshmërinë, si dhe mbi masat e përkohshme të mbrojtjes.**

- 6.1. Në 8 gusht 2009, kërkuësja komentoi mbi deklaratimet e Palës Shtetërore të cilat nga pikëpamjen e saj thjesht janë përsëritur konkluzionet e vendimeve të dhëna nga gjykatat e Plovdiv, por pa hedhur poshtë akuzat e saj. Ajo deklaroi se raporti i OJQ-së dhe të dhënat statistikore të referuara në komunikimin e saj i mbështesin faktet dhe akuzat që janë në të. Ajo nuk e pranoi efektivitetin e institucioneve të Palës Shtetërore për të luftuar dhunën në familje....
- 6.2. Kërkuësja deklaroi se pretendimi i Palës Shtetërore që autorja nuk kishte ngritur akuzë për trajtim të dhunshëm nga ana e bashkëshortit të saj në datë 21 shtator 2007 është i pasaktë, sepse nuk merr parasysh aplikimin e saj për një Urdhër Mbrojtje të Menjëhershëm
- 6.3. Në lidhje me barrën e provës Kërkuësja theksoi se... në rastin konkret, gjykatat e kanë kaluar barrën e provës mbi të, që të provonte përtej dyshimit të arsyeshëm që bashkëshorti

i saj ka dhunuar integritetin fizik në 21 shtator 2007, si dhe të mund të sillte prova shkresore për këtë qëllim.

- 6.4. Për kërkuësen, dallimi që ka bërë Pala Shtetërore ndërmjet grindjes si një akt i të dyja palëve dhe dhunës, është e një natyre të njëanshme. Po kështu edhe përkufizimi i palës shtetërore për dhunën si akt fizik e bën këtë palë të mos kuptojë natyrën komplekse të dhunës në familje, veçanërisht dhunës emocionale dhe psikologjike.
- 6.5. Në lidhje me masat e përkohshme ankuesja shprehu shqetësimin e saj se mbas kërkesës së Komitetit sipas nenit 5 paragrafi 1 i Protokollit Fakultativ, Pala Shtetërore nuk u përgjigj fillimisht (kësaj kërkesë) si dhe nuk e kontaktoi viktimën në mënyrë që të bënte përpjekjet e duhura për të aplikuar këto masa (të kërkuara nga Komiteti).
- 6.6. Ajo deklaroi se direkt mbas mbarimit të Urdhrit të Mbrojtjes së Menjëhershme, bashkëshorti i saj përsëri filloi ta ngacmonte atë dhe fëmijët, me anë të telefonatave të përsëritura duke u përpjekur t'i manipulonte ata të binin dakord me pozicionin e tij, si dhe me akuzat ndaj nënës së tyre.
- 6.7. Kërkuësja argumenton se përmes vendimit të gjykatave për të mos lëshuar një Urdhër Mbrojtje të përhershëm, Pala Shtetërore ka dështuar në sigurimin e mbrojtjes ndaj saj dhe fëmijëve të saj. Zgjidhje të tjera të vlefshme për të nën Ligjin “Për Ministrinë e Brendshme” do të kishin qenë jo-efektive, sepse këto zgjidhje do të mund të rezultonin vetëm me një paralajmërim me shkrim ndaj bashkëshortit të saj për të mos e ngacmuar atë. Dhuna në familje nuk penalizohet në mënyrë specifike dhe lloje të caktuar sulmesh janë të përjashtuara nga procedimi ex-officio nëse ato kryhen nga anëtarët e familjes.
- 6.8. Autorja deklaroi se argumentet e Palës Shtetërore se autorja duhet të paraqesë fakte të reja për të marrë masa mbrojtëse shtesë të menjëhershme janë të gabuara, sepse organet shtetërore e kanë patur si detyrë të vazhdueshme të pajtoheshin me masat e përkohshme të kërkuara nga Komiteti sipas Protokollit Fakultativ. Ajo gjithashtu deklaroi se pala shtetërore vetëm sa i bën lajka detyrimeve që rrjedhin sipas Konventës dhe nuk i zbaton ato në



praktikë. Pala shtetërore nuk i kishte raportuar Komitetit që nga viti 1994.

## 7. Vërejtje shtesë nga Pala Shtetërore

7.1. Në 7 dhjetor 2009, Pala Shtetërore deklaroi vërejtjet e saj ndaj komenteve të autores së kërkesës, duke deklaruar se Ligji “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” i ka siguruar asaj një mjet juridik efektiv. Në mungesë të kërkesave të tjera nga ana e autores për të kërkuar mbrojtje ndaj dhunës në familje, atëherë duhet marrë me mend se incidenti (ngjarja) e ndodhur në 21 shtator 2007 ishte në konflikt i izoluar ndërmjet autores dhe bashkëshortit të saj. Pala shtetërore e përsërit se fakti se autorja nuk ka raportuar ndonjë incident të ri (të dhunës në familje) ndërmjet saj dhe bashkëshortit të saj që nga lëshimi i Urdhrit të Mbrojtjes së Menjëhershme në 27 shtator 2007, tregon kështu se masat e mbrojtjes të marra nga organet shtetërore kanë qenë efektive dhe të përshtatshme. Në çdo rast tjetër autorja ka dështuar të përdorë mjetet juridike në dispozicion në lidhje me çdo ngjarje tjetër të mundshme të cilën ajo nuk e ka njoftuar tek autoritetet e organeve shtetërore.

7.2. Pala shtetërore argumenton se rasti prezent nuk është i njëjtë me rastin e A.T. kundër Hungarisë (Komunikimi nr. 2/2003) ku Komiteti gjeti një shkelje nga pala shtetërore hungareze të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa për ti siguruar autores një mbrojtje efektive nga kërcënimet kundër jetës së saj, kundër integritetit fizik, si dhe kundër shëndetit të saj fizik e mendor. Ndërsa në Hungari në atë kohë, nuk kishte ndonjë ligj specifik kundër dhunës në familje, si dhe nuk kishte urdhra mbrojtje apo urdhra kufizimi në dispozicion të viktimave të dhunës në familje, në rastin konkret autores ju dha një mbrojtje e menjëhershme dhe e përshtatshme sipas ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje”. Autorja pretendon se organet shtetërore kanë dështuar për ti dhënë asaj një mbrojtje të menjëhershme nga bashkëshorti i saj dhe se kuadri ligjor dhe institucional i kësaj mbrojtje ngelet përsëri jo i përshtatshëm për të dhënë një mbrojtje të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe efektive si dhe një mbështetje për viktimat e dhunës në familje duke qenë kështu haptazi i pabazuar.

## ÇËSHTJET DHE PROCEDURAT PËRPARA KOMITETIT

### 8. Shqyrtimi i pranueshmërisë.

- 8.1. Sipas nenit 72, paragrafi 4, të rregullores së procedurave (të Komitetit), Komiteti do të marrë në shqyrtim zbatimin e arsyeve të pranueshmërisë referuar tek nenet 2,3 dhe 4 të Protokollit (Fakultativ) përpara se të marrë në shqyrtim vlerën e komunikimit.
- 8.2. Duke iu referuar nenit 4, paragrafi 1, të Protokollit (Fakultativ), Komiteti njofton se autorja ka deklaruar që Pala Shtetërore ka pranuar në mënyrë të qartë se autorja i ka konsumuar të gjitha mjetet juridike të vendit të saj.
- 8.3. Duke iu referuar nenit 4, paragrafi 2 (a), të Protokollit (Fakultativ), Komiteti është njoftuar se e njëjta çështje nuk ka qenë si dhe nuk është nën shqyrtimin e ndonjë procedure tjetër të hetimit apo të vendim-marrjes ndërkombëtare.
- 8.4. Duke iu referuar argumentit të Palës Shtetërore që autorja ka dështuar të mbështesë pretendimin e saj se ajo është viktimë e shkeljes së neneve 1, 2 (a) – (c) dhe (e) – (g), 5 (a) dhe 16, paragrafi 1 (c), (g) dhe (h), të Konventës, Komiteti e konsideron që ajo ka dhënë elemente të mjaftueshëm për të mbështetur pretendimet e saj për qëllimet e pranueshmërisë.
- 8.5. Komiteti nuk ka shkaqe që ta konsiderojë komunikimin të papranueshëm bazuar në ndonjë shkak, kështu që e konsideron këtë komunikim të pranueshëm.

### 9. Shqyrtimi i vlefshmërisë

- 9.1. Komiteti e shqyrton këtë komunikim nën dritën e të gjithë informacionit që i është vënë atij në dispozicion nga autorja dhe nga pala shtetërore, ashtu siç edhe parashikohet në nenin 7, paragrafi 1, të Protokollit (Fakultativ).
- 9.2. Komiteti e konsideron se në qendër të komunikimit aktual qëndron akuza e kërkueses se, Pala Shtetërore ka dështuar që t'i siguronte asaj një mbrojtje efektive kundër dhunës në familje, duke shkelur kështu nenin 2 (c) dhe (e) – (g), i lexuar në lidhje me nenin 1 dhe me nenet 5 (a) dhe 16 të Konventës.
- 9.3. Komiteti kujton se në përputhje me

rekomandimin e tij të përgjithshëm Nr. 19, diskriminimi sipas kuptimit të nenit 1, përfshin dhunën me bazë gjinore kundër grave. Një diskriminim i tillë nuk kufizohet vetëm tek veprimet nga apo në emër të Qeverive. Palët Shtetërore (neni 2 (e) i Konventës), mund të jenë përgjegjës për veprime private nëse organet shtetërore dështojnë të veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar dhunimin e të drejtave, apo nëse dështojnë të hetojnë dhe të ndëshkojnë akte të dhunës, apo të sigurojnë kompensimin e duhur.

9.4. Komiteti vë re se Pala Shtetërore i ka marrë masat në sigurimin e mbrojtjes kundër dhunës në familje duke adoptuar Ligjin “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje”, ligj i cili përfshin një procedurë të shpejtë për të lëshuar Urdhra Mbrojtjeje. Megjithatë, në mënyrë që kërkuesja të gëzojë zbatimin në praktikë të parimit të barazisë ndërmjet burrit dhe gruas dhe të të drejtave dhe lirive themelore, vullneti politik i cili është shprehur në një legjislacion të tillë specifik duhet të mbështetet nga të gjithë aktorët shtetërorë, duke përfshirë këtu edhe gjykatat. Kështu, çështja përpara Komitetit është nëse refuzimi i Gjykatave të Plovdiv për të dhënë Urdhër Mbrojtje të Përhershëm kundër burrit të ankueses, si dhe mungesa e vendeve/qendrave të strehimit në dispozicion, e kanë shkelur detyrimin e Palës Shtetërore për të mbrojtur në mënyrë efektive kërkuesen kundër dhunës në familje.

9.5. Kjo do të kërkonte pikë së pari që kërkuesja të ketë bërë kërkesë për një Urdhër Mbrojtjeje. Në padinë e saj të datës 27 shtator 2007 drejtuar Gjykatës Rajonale (të Apelit) të Plovdiv, ajo kërkonte që “të lëshohej një Urdhër Mbrojtjeje i Menjëhershëm sipas kushteve të paraqitura në nenin 18, paragrafi 1, i Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” dhe i kërkoi Gjykatës që të impononte masa sipas nenit 5, paragrafi 1 (pika 3 dhe 4) të këtij ligji që përcakton masat e mbrojtjes që mund të vendoseshin nga Gjykatat si në rastin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, ashtu edhe në rastin e Urdhrit të Mbrojtjes së Përhershme për një periudhë 3 deri në 18 muaj. Komiteti vuri në dukje se fakti që ankuesja ka kërkuar që masa të tilla të vendoseshin për një periudhë prej 1 viti, tregon që ajo ka bërë kërkesë për një Urdhër Mbrojtjeje, bazuar kjo tek neni 5, paragrafi 2, i Ligjit.

9.6. Komiteti thekson se, pyetja decizive është nëse refuzimi i Gjykatave të Plovdiv për të lëshuar një Urdhër Mbrojtjeje kundër bashkëshortit të autores, është apo nuk është vendim arbitrar e diskriminues.

9.7. Komiteti kujton se dhuna me bazë gjinore përbën diskriminim sipas kuptimit të nenit 2, i cili, i lexuar në lidhje me nenin 1 të Konventës dhe me Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19 nuk kërkon një kërcënim direkt dhe të menjëhershëm për jetën dhe shëndetin e viktimës. Një dhunë e tillë nuk është e limituar tek veprimet që shkaktojnë dëmtime fizike, por gjithashtu, mbulojnë edhe veprime të cilat shkaktojnë dëmtime fizike dhe seksuale, ose vuajtje, kërcënime prej çdo akti të tillë, shtrëngim dhe kufizime të tjera të lirisë. Në mënyrë të ngjashme neni 2, paragrafi 1, i Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” e përcakton dhunën në familje si “si çdo akt të dhunës psikologjike, seksuale, fizike, emocionale apo ekonomike, si dhe çdo përpjekje për një dhunë të tillë, çdo kufizim me forcë i jetës personale, i lirisë personale, i të drejtave personale, kundër personave të afërm, apo personave që kanë apo që kanë patur lidhje familjare apo bashkëjetese”.

Komiteti vë re se ndërsa një Urdhër Mbrojtjeje i Menjëhershëm në përputhje me nenin 18, paragrafi 1, i Ligjit, kërkon që kërkesëpadia e viktimës “të përmbajë të dhëna në lidhje me kërcënimin direkt, të menjëhershëm apo të vazhdueshëm për jetën apo për shëndetin e personit të dëmtuar”, por nuk kërkohet një kërcënim i tillë për lëshimin e një Urdhri Mbrojtjeje të përhershëm, për më tepër neni 4 paragrafi 1 i Ligjit thjesht kërkon që “në rastet e dhunës në familje personi i dëmtuar duhet të ketë të drejtën të shkojë në Gjykatë për mbrojtjeje.

9.9. Komiteti konkludon se Gjykata e Rrethit Plovdiv kur vendosi mbi Urdhrit e Mbrojtjes së përhershme sipas nenit 5, paragrafi 1, pika 1,3 dhe 4 të Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” në datën 18 dhjetor 2007, si dhe Gjykata Rajonale e Plovdiv në vendimin e saj të Apelit të datës 7 prill 2008, kanë aplikuar një përkufizim shumë të kufizuar të dhunës në familje, e cila nuk është e garantuar me ligj dhe është e papajtueshme me detyrimet e palës shtetërore sipas nenit 2 (c) dhe (d) të Konventës e cila aplikohet direkt nga organet shtetërore. Të

dyja Gjykatat fokusohen në mënyrë ekskluzive mbi çështjen e kërcënimit direkt dhe imediat ndaj jetës dhe shëndetit të autores dhe mbi integritetin e saj fizik, duke neglizhuar vuajtjet e saj psikologjike dhe emocionale. Për më tepër të dyja Gjykatat në mënyrë të panevojshme e privuan veten nga mundësitë për të marrë kompetencën gjyqësore mbi historinë e kaluar të dhunës në familje të përshkruar nga autorja duke interpretuar thjesht kërkesat procedurale të nenit 10 të Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje” d.m.th. që kërkesa për Urdhrin e Mbrojtjes duhet të ishte dorëzuar brenda 1 muaji nga data kur ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke penguar marrjen në shqyrtim të ngjarjeve të kaluara, të cilat kanë ndodhur më parë periudhës 1-mujore për të cilën bëhet fjalë. Gjykata gjithashtu, ka aplikuar një standard shumë të lartë të provës duke kërkuar që akti i dhunës në familje të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm, duke e vendosur barrën e provës tek viktima. Ajo konkludoi se nuk është kryer ndonjë akt specifik i dhunës në familje i dalluar mbi bazën e provave të mbledhura. Komiteti vëren se një standard i tillë prove është jashtëzakonisht i lartë dhe nuk shkon në një linjë me Konventën, dhe as me standardet aktuale të mos-diskriminimit, të cilat e lehtësojnë barrën e provës për viktimën në procedimet civile që lidhen me kërkesëpaditë për dhunën në familje.

9.10. Komiteti e ka deklaruar në shumë raste se, qëndrimet tradicionale sipas të cilave gratë janë të varura nga burrat kontribuojnë në favor të dhunës ndaj grave. Në lidhje me rastin që është tani para Komitetit për çështjen se vendimet e Gjykatave të Plovdiv janë të bazuara në stereotipat gjinore, duke shkelur nenet 5 dhe 16, paragrafi 1 të Konventës, Komiteti riafirmon se Konventa vendos detyrime mbi të gjitha organet shtetërore dhe se pala shtetërore duhet të jetë përgjegjëse mbi vendimet gjyqësore të cilat i shkelin dispozitat e Konventës. Komiteti gjithashtu shton se, sipas nenit 2 (f) dhe neni 5 (a), pala Shtetërore ka detyrimin që të marrë masat e duhura për të ndryshuar ose anuluar jo vetëm ligjet dhe rregullat që ekzistojnë, por edhe traditat dhe praktikat që përmbajnë diskriminim kundër grave, ndërsa sipas nenit 16 paragraf 1, pala shtetërore duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e grave mbi çdo çështje që lidhet me martesën dhe marrëdhëniet familjare. Në lidhje me këtë,

Komiteti thekson se stereotipat prekin të drejtat e grave për një proces gjyqësor të drejtë dhe se sistemi gjyqësor duhet të jetë i kujdesshëm që të mos krijojë standard jo-fleksibël, bazuar tek nocione të paramenduara të cilat përbëjnë dhunë në familje ose me bazë gjinore. Në rastin konkret përputhshmëria e palës shtetërore me detyrimet e saj sipas nenit 2 (d) dhe (f) dhe neni 5 (a) për të zhdukur stereotipat gjinore, të cilat kanë nevojë që të vlerësohen në dritën e nivelit të ndjeshmërisë ndaj barazisë gjinore të aplikuara në proceset gjyqësore që trajtohen në rastin e autores.

9.11. Komiteti e konsideron se interpretimi i Gjykatave të rrethit dhe të rajonit të Plovdiv se, periudha 1-mujore brenda së cilës një viktimë duhet të aplikojë për të marrë një Udhër Mbrojtjeje (neni 10, paragrafi 1 i Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje”), më tepër është për të siguruar një ndërhyrje urgjente të gjykatës, sesa për të policuar bashkëjetesën e partnerëve. Në mënyrë të njëjtë siç u shpjegua më sipër, fokusi ekskluziv i Gjykatave të Plovdiv tek dhuna fizike dhe tek kërcënimi imediat për jetën apo shëndetin e viktimës reflekton një koncept stereotip dhe shumë të ngushtë të asaj që përmban dhuna në familje. Një interpretim i tillë i dhunës në familje, për shembull, është reflektuar në arsyetimin e Gjykatës Rajonale të Plovdiv sipas të cilit, “Duke goditur dikë ju mund të ushtroni dhunë, por vetëm pasi të keni kaluar disa limite të caktuara të abuzimit dhe ashtu siç është ky rast, deklarata e V.K. nuk e bën të qartë se si ajo ishte goditur ekzaktësisht, kryesisht në datën e kryerjes së veprimit dhe as se si u cenua paprekshmëria e saj”. Edhe në gjykimin e divorcit në datën 8 maj 2009, nga Gjykata e rrethit të Plovdiv, mund të gjenden stereotipat tradicionale mbi rolin e grave në martesë, gjykim i cili i referohet përdorimit nga ankuesja të “një gjuhe fyese” ndaj bashkëshortit e saj dhe e urdhëron atë që të rimarrë mbiemrin e vajzërisë mbas zgjidhjes së martesës. Komiteti konkludon se refuzimi i gjykatave të Plovdiv për të lëshuar një Urdhër Mbrojtjeje të përhershëm kundër bashkëshortit të autores është i bazuar mbi nocione stereotip, të para-konceptuara dhe për rrjedhim, diskriminuese ndaj asaj që përbën dhunën në familje.

9.12. Komiteti gjithashtu, konsideron se mungesa e mundësive të strehimit nga Qendrat e

specializuara për raste të tilla siç pretendohet nga autorja dhe që nuk është kontestuar nga Pala Shtetërore, ku autorja dhe fëmijët e saj mund të kishin qëndruar kur ata u kthyen në Bullgari në shtator 2007, përbën një shkelje të detyrimeve të Palës Shtetërore bazuar në nenin 2 (c) dhe (e) të Konventës për të siguruar një mbrojtje të menjëhershme të grave nga dhuna, duke përfshirë edhe dhunën në familje. Në lidhje me këtë, Konventa vë në dukje rekomandimin e përgjithshëm nr. 19 (1992) të saj mbi dhunën kundër grave.

9.13. Së fundi, Komiteti dëshiron të njohë faktin që autorja e komunikimit ka vuajtur dëmtime dhe paragjykime morale dhe financiare. Edhe duke marrë me mend se ajo nuk ka qenë subjekt direkt i dhunës fizike në familje mbas hedhjes poshtë në mënyrë përfundimtare të kërkesës për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes, në 7 prill 2008, ajo vuajti prej frikës dhe ankthit, sepse ajo dhe fëmijët e saj u lanë pa mbrojtjen e shtetit, si dhe nga ri-viktimizimi që iu bë asaj përmes stereotipave me bazë gjinore mbi të cilat u mbështetën për vendimet gjyqësore.

#### CEDAW/C/49/D/20/2008

9.15. Duke vepruar sipas nenit 7, paragrafi 3, i Protokollit Fakultativ të Konventës “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave”, si dhe nën dritën e të gjitha konsiderimeve të shprehura më sipër, Komiteti është i pikëpamjes se Pala Shtetërore ka dështuar në plotësimin e detyrimeve të saj dhe kështu ka shkelur të drejtat e autores bazuar në nenin 2 (c), (d) dhe (f), në lidhje me nenin 1 dhe nenin 5 (a), në lidhje me nenin 16, paragrafi 1 të Konventës, si dhe sipas rekomandimit të përgjithshëm nr. 19 të Komitetit.

9.16. Komiteti i jep Palës Shtetërore rekomandimet e mëposhtme:

**(a) Në lidhje me autoren e komunikimit:**

T'i jepet autores (së komunikimit) një kompensim financiar i përshtatshëm në proporcion meshkallën e seriozitetit të shkeljes së të drejtave të saj.

**(b) Rekomandim i përgjithshëm**

(i) Të amendohet neni 10 (1) i Ligjit “Për mbrojtjen ndaj dhunës në familje” duke hequr kështu periudhën limit prej 1-muaji dhe të sigurohet që Urdhrat e Mbrojtjes të bëhen të mundur pa vendosur barra të padrejta ligjore e administrative mbi aplikantet;

(ii) Të sigurojë që dispozitat në Ligjin “Për mbrojtjen ndaj dhunës në familje” të lehtësojnë barrën e provës në favor të viktimës duke amenduar Ligjin në përputhje me rrethanat;

(iii) Të sigurojë që një numër i mjaftueshëm i qendrave të pritjes të financuara nga Shteti, të vihen në dispozicion të viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre, si dhe të japë mbështetje për OJQ-të që ofrojnë strehë dhe forma të tjera mbështetjeje ndaj viktimave të dhunës në familje;

(iv) Të sigurojë trajnim të detyrueshëm për gjyqtarët, për avokatët dhe për personelin e agjencive ligjzbatuese mbi zbatimin e Ligjit “Për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje”, duke përfshirë këtu edhe përkufizimin e dhunës në familje si dhe mbi stereotipat e rolit gjinor, si dhe të sigurohet një trajnim i përshtatshëm mbi Konventën, mbi Protokollin Fakultativ të saj dhe mbi rekomandimet e përgjithshme të Komitetit, veçanërisht në lidhje me rekomandimin e përgjithshëm nr. 19.

9.17. Në përputhje me nenin 7, paragrafi 4, të Protokollit Fakultativ të Konventës, Pala Shtetërore duhet t'i shqyrtojë në mënyrën e duhur pikëpamjet e Komitetit, së bashku me rekomandimet e dhëna dhe duhet të dorëzojë pranë Komitetit brenda 6 muajve një përgjigje me shkrim, ku të përfshijë çdo informacion mbi çdo veprim të ndërmarrë nën dritën e rekomandimeve të Komitetit. Palës Shtetërore gjithashtu, i kërkohet që të publikojë pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit dhe t'i përkthejë ato në gjuhën Bullgare, si dhe t'i shpërndajë ato gjerësisht, në mënyrë që këto publikime të mbërrijnë në të gjithë sektorët përkatës të shoqërisë.

## 2

### A.S. KUNDËR HUNGARISË

#### Mbrojtja e shëndetit riprodhues të grave

CEDAW/C/36/D/4/2004

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave.

Sesioni 36, 7-25 Gusht 2006

Komunikimi nr. 4/2004

I dorëzuar nga: Zonja A.S, përfaqësuar nga Qendra Evropiane për të drejtat Rome dhe Zyra e Mbrojtjes Ligjore për Minoritetet Kombëtare dhe Etnike.

**Viktima e pretenduar:** Kërkuesja

**Shteti Anëtar:** Hungaria

**Data e komunikimit:** 12 Shkurt 2004

Autorja e komunikimit, paraqitur në datën 12 Shkurt 2004 është Znj. A.S., një grua rome hungareze, e lindur në 5 Shtator 1973. Ajo pretendon se është përballur me sterilizimin e detyruar nga stafi mjekësor, në një spital në Hungari. Autorja është përfaqësuar nga Qendra Evropiane për të drejtat Rome, një organizatë me status të veçantë konsultativ në Këshillin Ekonomik dhe Social dhe Zyra e Mbrojtjes Ligjore për Minoritetet Kombëtare dhe Etnike, një organizatë në Hungari. Konventa CEDAW dhe Protokollin e saj Fakultativ kanë hyrë në fuqi për shtetin pale, në 3 shtator 1981 dhe 22 Mars 2001, respektivisht.

#### *Faktet e prezantuara nga autorja e komunikimit*

Kërkuesja është nëna e tre fëmijëve. Në 30 Maj 2000, ajo u ekzaminua nga një mjek, i cili përcaktoi në lidhje me shtatzëninë e saj, se data e lindjes do të ishte data 20 dhjetor 2000. Në 20 dhjetor 2000, ajo u vizitua në maternitetin e Spitalit të Fehergyarmat dhe asaj iu tha se ishte në javën e 36-37 të shtatzënisë. Në 2 janar 2001, autorja pati dhimbje dhe hemorragji të rëndë. Ajo u dërgua në spitalin e Fehergyarmat, me ambulancë duke udhëtuar për një orë. Kur e ekzaminoi, mjeku konstatoi se fetusi kishte vdekur në mitrën e saj.

Mjeku e informoi se duhet të kryhej menjëherë një ndërhyrje cezariene, me qëllim që të hiqej

fetusi i vdekur. Autorës iu kërkua të nënshkruante një formë, nëpërmjet së cilës të jepte pëlqimin e saj për kryerjen e ndërhyrjes. Ajo e firmosi këtë si dhe një shënim që mezi lexohej, i shkruar me dorë nga mjeku në fund të formës: “Pasi mora dijëni për vdekjen e fetusit, unë kërkoj sterilizimin. (një term latin i panjohur për autorën) Unë nuk synoj të lind përsëri, dhe nuk dëshiroj të mbetem shtatzënë”. Të dhëna nga spitali tregojnë se brenda 17 minutash nga mbërritja e ambulancës në spital, u krye ndërhyrja, fetusi i vdekur u hoq dhe tubat u mbyllën. Para se të largohej nga spitali, autorja e pyeti mjekun mbi gjendjen e shëndetit të saj dhe se kur ajo mund të provonte të kishte një tjetër fëmijë. Vetëm në këtë moment, ajo kuptoi se çfarë do të thoshte fjala “sterilizim”. Nga të dhënat mjekësore, rezultoi se autorja arriti në spital në gjendje të rënduar shëndetësore. Asaj i merreshin mendtë kur arriti në spital, kishte hemorragji dhe ishte në gjendje shoku.

Autorja shpjegoi se sterilizimi kishte pasur efekt në jetën e saj, për shkak të të cilit ajo dhe partneri i saj ishin trajtuar me medikamente për depresion. Ajo shpjegoi se kurrë nuk do të kishte pranuar me dëshirë sterilizimin, sepse ajo i përkiste besimit katolik i cili ndalonte kontracëpsionin e çdo lloji, duke përfshirë edhe sterilizimin.

Për më tepër, A.S dhe partneri i saj jetonin në përputhje me zakonet tradicionale Rome, sipas të cilave fëmijët janë element qendror i sistemit të vlerave të familjeve Rome.

#### *Objekti i Ankimit*

Autorja A.S. ngriti pretendimin se Hungaria ka dhunuar nenet 10 (h), 12 dhe 16 paragrafi 1 (e) të Konventës CEDAW. Ajo theksoi se sterilizimi nuk është një ndërhyrje për të shpëtuar jetën, që ka nevojë të kryhet urgjent pa pëlqimin e plotë të pacientes dhe pa pëlqimin e bazuar në informacion. Autorja pohoi se organizatat ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut kanë theksuar në mënyrë të përsëritur se, praktika e sterilizimit të detyruar përbën një dhunim serioz të një numri të drejtash të njeriut dhe iu referua Komitetit të Përgjithshëm nr. 28 të Komitetit të të Drejtave të Njeriut mbi barazinë e të drejtave midis burrave dhe grave. Ajo, gjithashtu pohoi se detyrimi prezantohet në formë të ndryshme nga forca fizike tek shtrëngimi ose neglizhenca nga ana e personelit mjekësor.

Në lidhje me cenimin e pretenduar të nenit 10

(h) të Konventës, autorja argumentoi se ajo nuk mori informacion specifik në lidhje me sterilizimin, efektet e operacionit mbi aftësinë e saj për riprodhim, ose këshillim mbi planifikimin familjar si dhe masat kontraceptive. Autorja pohoi se asaj nuk i ishte dhënë informacion rreth natyrës së operacionit, rreziqeve dhe pasojave, në një mënyrë të kuptueshme për të, para se t'i kërkohej të firmoste formën e pëlqimit.

Ajo argumentoi se, paaftësia e saj për të dhënë pëlqimin bazuar në informacion për shkak të informacionit jo të plotë përbënte një dhunim të së drejtës për shërbime të përshtatshme të kujdesit shëndetësor. Ajo, gjithashtu argumentoi se ka një lidhje shkakësore të qartë midis dështimit të mjekëve për ta informuar në mënyrë të plotë atë në lidhje me sterilizimin dhe dëmtimeve të shkaktuara fizike dhe emocionale.

Autorja pretendoi se neni 16, paragrafi 1 (e) i Konventës së CEDAW-t, ishte dhunuar nga shteti palë duke e kufizuar aftësinë e saj për të riprodhuar. Ajo shtoi se, faktet e çështjes tregojnë se asaj ju mohua akses në informacion, edukim dhe mjetet për të ushtruar të drejtën e saj për të vendosur lirisht për numrin dhe shkallëzimin e lindjeve.

Autorja i kërkoi Komitetit CEDAW të gjente shtetin e Hungarisë fajtor për shkelje të nenit 10, 12 dhe 16 dhe t'i kërkonte shtetit palë të ofronte kompensim për të.

### **Çështje dhe procedura para Komitetit CEDAW**

#### *Në lidhje me pranueshmërinë*

Në përputhje me rregullin 64 të rregullave të tij të procedurës, Komiteti vendosi në lidhje me pranueshmërinë e komunikimit bazuar në Protokollin Fakultativ të Konventës, në pajtim me rregullin 72, paragrafi 4 të rregullave të tij të procedurës para se të merrte në konsideratë meritat e komunikimit.

Komiteti konstatoi se çështja nuk ishte duke u shqyrtuar sipas ndonjë procedure tjetër ndërkombëtare hetimore ose gjyqësore.

Në lidhje me kushtin e ezaurimit nga autorja të mjeteve të brendshme, Komiteti duhet të vendoste nëse mjeti i veçantë i rishikimit gjyqësor ishte i vlefshëm për autoren dhe nëse po, a duhet ta përdorte ajo këtë mjet. Në këtë kontekst, Komiteti theksoi se sipas autores, kriteret që aplikoheshin për mjetin e

rishikimit gjyqësor në kohën kur gjykata e Apelit lëshoi vendimin u deklaruan antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Hungarisë. Shteti Palë nuk e kundërshtoi këtë informacion. Autorja shpjegoi se çështja e saj nuk i përmbushte kriteret e këtij mjeti. Kriteret e rishikimit të vendimit në legjislacionin e shtetit të Hungarisë ishin: vendimi ndryshonte nga një vendim detyrues i Gjykatës së Lartë mbi zbatimin e unifikuar të ligjit; rishikimi i vendimit nga gjykata e lartë do të ishte i nevojshëm për të zhvilluar një çështje të një rëndësie konceptuale.

Autorja gjithashtu shpjegoi se vendimi i shkallës së dytë pohonte në mënyrë specifike që nuk lejohej ankimi i tij. Shteti Palë ka njohur natyrën e veçantë të mjetit. Në këto kushte, Komiteti nuk mendon se autores së komunikimit do t'i shërbente ky mjet.

Sipas nenit 4, paragrafi 2(e) i Protokollit Fakultativ, Komiteti deklaroi një komunikim të papranueshëm kur faktet që janë subjekt i komunikimit kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Protokollit Fakultativ për shtetin palë, përveçse kur këto fakte vazhdojnë edhe pas kësaj date të hyrjes në fuqi. Duke e marrë në konsideratë këtë dispozitë, Komiteti vuri re se incidenti kishte ndodhur në 2 janar 2001. Kjo datë është përpara hyrjes në fuqi të Protokollit Fakultativ për Hungarinë, 22 mars 2001. Megjithatë, autorja i ka kërkuar Komitetit të vendosë nëse një numër i të drejtave të saj të parashikuara në Konventën CEDAW, janë dhunuar dhe vazhdojnë të dhunohen si rezultat i ndërhyrjes së sterilizimit. Komiteti konsideroi se faktet që janë subjekt i komunikimit janë të një natyre të vazhdueshme dhe pranueshmëria *ratione temporis* është e justifikueshme.

Komiteti nuk gjeti asnjë shkak për ta shpallur komunikimin të papranueshëm dhe e konsideroi atë të pranueshëm.

#### *Në lidhje me meritat e çështjes*

**Në lidhje me nenin 10 (h) të Konventës,** Komiteti gjeti një dështim të Shtetit Palë, përmes personelit të spitalit për të siguruar informacionin e duhur dhe këshillim mbi planifikimin familjar, i cili përbën një dhunim të së drejtës së autores sipas nenit 10 (h) të Konventës.

**Në lidhje me nenin 12 të Konventës,** Komiteti konsideroi se Shteti Palë nuk siguroi që autorja të jepte pëlqimin e saj për sterilizim, të bazuar në informacion të plotë dhe për pasojë të drejtat e

autores të parashikuara në nenin 12 të Konventës janë dhunuar.

*Në lidhje me nenin 16, paragrafi 1 (e) të Konventës,* Komiteti konsideroi se të drejtat e autores të parashikuara në këtë nen janë dhunuar.

Në përfundim, Komiteti ishte i pikëpamjes se janë dhunuar nenet 10 (h), 12 dhe 16, paragrafi 1 (e) i Konventës dhe dha rekomandimet e mëposhtme për Shtetin Palë:

**I.** Në lidhje me autoren e komunikimit: të sigurojë kompensimin e duhur për A.S. në përputhje me shkallën e dhunimit të të drejtave të saj.

## **II. Rekomandime të përgjithshme**

- Të marrë masa të mëtijshme për të siguruar që dispozitat përkatëse të Konventës dhe rekomandimet e përgjithshme të Komitetit nr.19, 21 dhe 24, në lidhje me të drejtat dhe shëndetin riprodhues të grave, të njihen dhe zbatohen nga i gjithë personeli përkatës në qendrat e shëndetit publik dhe privat, duke përfshirë spitalet dhe klinikat.
- Të rishikojë legjislacionin e brendshëm në lidhje me parimin e pëlqimit të bazuar në informacion në rastet e sterilizimit dhe

të sigurojë pajtimin e tij me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ato mjekësore, duke përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës mbi të drejtat e njeriut dhe Biomjeksinë (Konventa Oviedo) dhe udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

- Të monitorojë qendrat shëndetësore publike dhe private, duke përfshirë spitalet dhe klinikat, të cilat kryejnë procedurat e sterilizimit, me qëllim që ato të sigurojnë dhënien e pëlqimit nga pacientja, bazuar në një informacion të plotë, përpara se të kryhet sterilizimi, si dhe që sanksionet e duhura të zbatohen në rast shkelje.

Në përputhje me nenin 7, paragrafi 4, Shtetet Palë u kushtojnë vëmendjen e duhur pikëpamjeve të Komitetit, së bashku me rekomandimet. Ato duhet t'i paraqesin Komitetit, brenda 6 muajve, një përgjigje me shkrim në të cilën të përfshihet informacion mbi çdo veprim të ndërmarrë në përgjigje të pikëpamjeve dhe rekomandimeve të Komitetit. Shtetit Palë, gjithashtu iu kërkua të botojë pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit dhe t'i përkthejë ato në gjuhën Hungareze, si edhe t'i shpërndajë gjerësisht tek të gjithë sektorët përkatës të shoqërisë.

## Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

### 1 GRATË, SHTATËZANIA, NDËRPRERJA E SHATËZANISË; SHËNDETI;

#### JETA PRIVATE

#### A-ja, B-ja dhe C-ja kundër Irlandës

Vendimi i GJEDNJ-së ( Dhomës së Lartë ), 16 dhjetor 2010

**Shkelje e nenit 8- mbi të drejtën për të respektuar jetën private dhe familjare- e KEDNJ-së, për sa i përket C-së**

Asnjë shkelje e nenit 8 – të së drejtës për të respektuar jetën private dhe familjare apo e nenit 13 – të së drejtës për një mjet juridik efektiv të marrë në lidhje me nenin 8 – të KEDNJ-së përsa u përket A-së dhe B-së.

Tri rezidente në Irlandë, A-ja dhe B-ja me kombësi irlandeze dhe C-ja me kombësi lituaneze udhëtuan për në Angli për të kryer ndërprerje të shtatzënisë, çka ato mendonin se nuk kishin të drejtë ta bënin në Irlandë. Ligji irlandez i ndalon gratë të kryejnë ndërprerje të shtatzënisë me përjashtim të rasteve kur shtatzënia paraqet “një rrezik real dhe substancial për jetën“ e nënës dhe nuk lejon abortin për arsye të tjera shëndetësore apo që lidhen më standardin e jetesës. Ligji irlandez i lejon gratë të udhëtojnë në shtete të tjera për të kryer një abort dhe lejon propagandimin e informacionit mbi shërbimet e abortit, që janë ligjërish të mundshme në shtete të tjera.

A-ja ngeli shtatzënë padashur dhe e vetme udhëtoi drejt Anglisë për të kryer abort . A-ja kishte tashmë katër fëmijë të vegjël, të gjithë në kujdestari pasi kishte qenë e alkolizuar. A- ja mendoi se një fëmijë tjetër (duke patur parasysh rrezikun e një depresioni pas lindjes) do të vinte në rrezik shëndetin e saj si dhe ribashkimin e suksesshëm të familjes së saj.

B-ja ngeli shtatzënë padashur dhe udhëtoi e vetme drejt Anglisë për të abortuar. B-ja kishte marrë në mëngjes një tabletë kontrceptive për prishje barre, dhe pas një këshillimi që kishte pasur, i kishin thënë se tableta që kishte marrë do të rriste rrezikun për të patur një shtatzëni ektopike (jashtë-

mitre). Megjithatë, para se të nisej për në Londër asaj i kishin konfirmuar se nuk kishte shtatzëni jashtë- mitre.

C-ja e kishte kryer abortin në Angli, pasi mendonte se në Irlandë nuk do t'i jepej e drejta për të abortuar. Për një periudhë tri vjeçare C-ja ishte kuruar me kimio-terapi kundër kancerit dhe mjekët e kishin këshilluar se do të kishte qenë shumë e rrezikshme për fetusin nëse ajo do të kryente kimio-terapi në tremujorin e parë të shtatzënisë. Kanceri ishte shëruar dhe C-ja pa dashje kishte ngelur shtatzënë. C-ja kreu një numër analizash për kancerin gjatë periudhës së shtatzënisë. C-ja kërkoi të ndërpriste barrën por nuk mundi të gjente ndonjë klinikë ku mund ta bënte këtë, pasi C-ja nuk ishte rezidente në Irlandë.

A-ja dhe B-ja iu drejtuan GJEDNJ-së me një padi, ku pretendonin se ligji irlandez që pengonte abortin për arsye shëndetësore apo për shkak të standardit të jetesës, shkelte nenet 3, 8, 13 dhe 14 të KEDNJ-së. A-ja dhe B-ja parashtuan se të drejtat kombëtare për abortim ishin tepër të përgjithshme dhe se nëse gjykatat e vendit do të shpreheshin në favor të tyre, ato me sa duket nuk do të mund të urdhëronin qeverinë dhe / ose një mjek për t'u krijuar atyre lehtësi për të kryer një abort në Irlandë, në kohën e duhur.

Padia që C-ja i drejtoi GJEDNJ-së lidhej me nenet 2, 3, 8, 13 dhe 14 të KEDNJ-së, sipas të cilave ligji irlandez nuk e pajiste atë me mjetet për të ushtruar të drejtën e saj për një abort të ligjshëm pasi rrezikonte jetën. C-ja deklaroi se nuk ekzistonte asnjë procedurë që mund të ndiqej nga një grua apo nga një mjek për të vendosur se kur duhet të kryhej një abort për të shpëtuar jetën e nënës. C-ja pretendonte se mungesa e procedurave të tilla përbënte “rrethana të veçanta” për ta shfajësuar C-në nga ndonjë detyrim ndaj mungesës së mjeteve juridike në vend. Me marrjen e padive, dhoma e GJEDNJ-së hoqi dorë nga kompetencat dhe u shpreh në favor të Dhomës së Lartë.

Qeveria u përgjigj se parashtesat faktike të A-së, B-së dhe C-së ishin të përgjithshme, të pabazuara dhe të paprovuara as nga gjykata e vendit, as përmes ndonjë forme tjetër të ndërveprimit me shtetin. Qeveria nënvizoi se palët paditëse nuk kishin paraqitur ndonjë provë, me anë të së cilës të



vërtetonin se kishin kërkuar ndonjë këshillë ligjore në kohën me të cilën lidhet çështja në fjalë. Qeveria e pranoi se në Irlandë një abort “për shkaqe sociale” sikurse parashtrohej nga A-ja do të përbënte një shkelje të legjisllacionit vendas dhe se do të kishte qenë e vështirë të mendohej se ajo do të kishte pasur ndonjë mundësi reale për të siguruar të drejtën për një ndërprerje shtatzënie, nisur nga anët pozitive dhe negative të një ndërhyrjeje të tillë.

Qeveria argumentoi se nëse B-ja do të kishte qenë diagnostikuar se vuante nga një shtatzëni jashtë-mitre, asaj do t’i ishte dhënë e drejta të kryente një abort terapeutik në Irlandë.

Qeveria deklaroi se faktet e pohuara nga C-ja (për kancerin e saj) nuk të lejonin të vendosje nëse shtatzënia e saj përbënte ndonjë rrezik për jetën e saj, apo nëse ajo nuk kishte qenë në gjendje të siguronte këshillat e duhura për këtë qëllim. Qeveria iu përmbajt idesë se në Irlandë, ekzistonin procedurat efektive sipas të cilave një grua lejohej të ushtronte të drejtën e saj për të abortuar. Qeveria argumentoi se interesat e C-së mbroheshin nga disponueshmëria e procedurave juridike, dhe parashtrroi se C-ja kishte dështuar në ushtrimin e të drejtës së saj për të shfrytëzuar mjetet juridike të vendit.

Mjekët për Zgjedhje dhe Shërbimi Britanik për Konsultime shtatzënie ndërhynë në mbështetje të paditëseve, duke vënë në dukje se nuk kishte prova që tregonin se ndalimi i abortit në një vend e reduktonte shkallën e abortit, për sa kohë që ishte e mundur të përdorje të tjera mjete si p.sh., të udhëtoje në një shtet tjetër për të abortuar. Ata pretendonin se kurrë nuk kishin dëgjuar ndonjë rast tjetër të lejimit të abortit në Irlandë me qëllim për të shpëtuar jetën e nënës. Qendra e të Drejtave për Riprodhim dhe Programet e Ligjit Ndërkombëtar për Shëndetin Riprodhues dhe Seksual gjithashtu, ndërhynë në mbështetje të palëve paditëse dhe argumentuan se ligjet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe standardet krahasuese duhet të japin të dhëna mbi mendimin e GJEDNJ-së dhe se, kufizimet e ligjit irlandez për abortet nuk përputheshin me ligje e standarde të tilla.

Fushata Pro-Jetës ndërhyri në mbështetje të Irlandës dhe vuri në dukje se mbrojtja e jetës së një foshnjeje të palindur ishte thelbësore për skemën konstitucionale të të drejtave themelore të Irlandës, duke argumentuar se çdo vendim që lidhet me të drejtat ekzistuese të KEDNJ-së, duhet të adresohet fillimisht në gjykatat e vendit, para se të paraqitet në GJEDNJ. Qendra Evropiane për Ligj dhe

Drejtësi në bashkëpunim me Kethi Sinnott (anëtare e Parlamentit Evropian), Këshilli për Kërkime Familjare dhe Shoqëria në Mbrojtje të Fëmijëve të Palindur gjithashtu, ndërhynë në mbështetje të Irlandës dhe argumentuan se Irlanda gëzon të drejtën sovraane për të vendosur se kur fillon jeta, si dhe për të vendosur mbi procedurat e përshtatshme në mbrojtje të së drejtës për jetën, që për nga rëndësia ia kalon të drejtave të tjera.

### Gjykata u shpreh se:

- (1) Neni 8 mbron jetën private, përfshi këtu autonominë dhe zhvillimin personal, jetën seksuale, integritetin fizik dhe psikik të individit, si dhe zgjedhjet riprodhuese;
- (2) megjithëse neni 8 nuk mund të interpretohet si konfirmim i të drejtës për abort, ndalimi i abortit i kërkuar për arsye të gjendjes shëndetësore apo të mirëqenies, bën pjesë në hapësirën e së drejtës për të respektuar jetën private sikurse sanksionohet në nenin 8;
- (3) ndalimi nga qeveria i abortit për arsye shëndetësore apo arsye të mirëqenies nuk është një ndërhyrje e pajustificuar në të drejtat e A-së dhe B-së, referuar nenit 8 ose nenit 13 të marrë së bashku me nenin 8, pasi ligji irlandez megjithatë, i lejon gratë të informohen mbi mundësitë e kryerjes së një aborti jashtë vendit, si dhe të udhëtojnë jashtë vendit për të kryer një abort duke vendosur kështu një ekuilibër të drejtë mes të drejtave të grave për të respektuar jetën e tyre private dhe të drejtave të kërkuara në emër të të palindurve;
- (4) nuk kishte as kritere e as procedura në ligjin irlandez, as në legjisllacion, në jurisprudencë apo diku tjetër, ku mund të matej apo përcaktohej rreziku që kërcënonte jetën apo shtatzëninë e C-së, duke vënë në dyshim padinë e saj;
- (5) dështimi i qeverisë në zbatimin e një regjimi legjislativ apo rregullator që siguron një procedurë efektive me anë të së cilës C-ja mund të ishte klasifikuar si person që mund të kryente një abort të ligjshëm në Irlandë, shkel nenin 8;
- (6) asnjë çështje e veçantë nuk është ngritur sipas nenit 13, i marrë në lidhje me nenin 8 përsa i përket C-së ose sipas nenit 14 në lidhje me nenin 8, përsa u përket të gjitha palëve paditëse;
- (7) meqenëse një shkelje e thjeshtë e KEDNJ-së nuk mund të zhdëmtonte ankthin dhe vuajtjen që përjetoi C-ja pasi nuk ishte në gjendje të

vendoste në mënyrë efektive mbi të drejtën e saj për një abort të ligjshëm në Irlandë, gjykata e dëmshpërbleu C-në me 15 .000 Euro për dëm jo-pasuror;

- (8) C-ja nuk gëzoi të drejtën për ndonjë dëm në para dhe asnjë nga paditëset nuk gëzoi të drejtën e ndonjë tarife ligjore.

## 2

### GRATË, DHUNA; JETA PRIVATE

#### A kundër Kroacisë

**Vendimi i GJEDNJ-së , 14 tetor 2010**

**Shkelje e nenit 8-mbi të drejtën për të respektuar jetën private dhe familjare-të KEDNJ-së.**

A-ja, paditësi, u martua me B-në në prill 2001. Më vonë A-ja kërkoi divorc dhe në 2006 iu dha divorci nga B-ja. Gjatë dhe pas martesës A-ja kishte paraqitur një numër të madh kallëzimesh penale e civile kundër B-së, për sjelljen e tij vazhdimisht të dhunshme dhe kërcënimeve të dhunshme ndaj A-së dhe vajzës së tyre. B-ja kishte kërcënuar me vdekje edhe një punonjës policie dhe po kështu kishte kërcënuar edhe një gjykatës. Procedurat gjyqësore shtyheshin shpesh për arsye se B-ja nuk paraqitej në seancat gjyqësore. Gjykata urdhëroi që B-ja t'i nënshtrohej një ekzaminimi psikiatrik pasi B-ja kishte çrregullime të rënda mendore, që ishin kryesisht rezultat i faktit që ai kishte qenë i arrestuar dhe i ishte nënshtuar torturave në një kamp përqendrimi gjatë Luftës së Homeland-it në vitin 1992. B-ja ishte dënuar disa herë, por dënimet/ vendimet gjyqësore ose nuk ishin zbatuar, ose nuk parashikonin burg, ose ai ishte liruar nga arresti.

A-ja nisi një kërkesë drejt GJEDNJ-së, ku pretendonte se Kroacia, që nuk i kishte siguruar asaj mbrojtjen e duhur, kishte shkelur nenet 2, 3 dhe 8 të KEDNJ-së. Krahas kësaj A-ja pretendonte se meqenëse Kroacia nuk kishte mundur të zbatonte vendimet e saj, ajo nuk kishte mundur të siguronte ndonjë mjet juridik efektiv, me anë të së cilës të siguronte mbrojtje nga B-ja, duke shkelur kështu nenin 13. Më tej, A-ja iu përmbajt mendimit se meqenëse dhuna në familje ushtrohej kryesisht ndaj grave, ligjet përkatëse të Kroacisë nuk ishin efektive dhe si të tilla ato ishin diskrimin-

uese ndaj grave dhe shkelnin kështu nenin 14.

Qeveria argumentoi se viktimat e dhunës në familje mbroheshin nga e drejta penale dhe se qeveria kishte iniciuar veprime penale dhe kishte zbatuar sanksione penale kundër B-së. Qeveria vuri në dukje se ajo kishte zbatuar dy strategji kombëtare lidhur me dhunën në familje. Ndërkohë ajo argumentoi se nuk e kishte trajtuar A-në në mënyrë diskriminuese dhe se ajo i kishte marrë në konsideratë ankesat e A-së. Qeveria pretendonte gjithashtu se asnjë zyrtar nuk ishte përpjekur ta bindte A-në të hiqte dorë nga ankesat e saj ndaj B-së.

**Gjykata u shpreh se :**

- (1) dështimi i qeverisë për të marrë masa me vendim gjykate për të adresuar problemet psikiatrike të B-së dhe për të mbrojtur A-në nga dhuna që ushtronte B-ja ishte një shkelje e detyrimit pozitiv të qeverisë për të siguruar të drejtën e A-së për të respektuar jetën e saj private, duke shkelur kështu, nenin 8;
- (2) meqenëse gjykata kishte zbuluar se ishte shkelur neni 8, nuk kemi të bëjmë me çështje të veçanta që mbeten për t'u analizuar sipas neneve 2, 3 dhe 13;
- (3) ajo hodhi poshtë padinë e A-së sipas së cilës qeveria kishte shkelur nenin 14, pasi A-ja nuk kishte mundur të sillte prova të mjaftueshme *prima facie*, sipas të cilave masat që kishte marrë qeveria në lidhje me dhunën në familje apo mbi efektet e masave të tilla, kishin qenë diskriminuese;
- (4) Qeveria do t'i paguaj A-së 9.000 Euro për dëmet jo-pasurore dhe 4.470 Euro për shpenzimet.

## 3

### GRATË, DHUNA; JETA PRIVATE; LIRIA & SIGURIA

#### Hajduova kundër Sllovakisë

**Vendimi i GJEDNJ-së , 30 nëntor 2010**

**Shkelje e nenit 8- mbi të drejtën për të respektuar jetën private dhe familjare- të KEDNJ-së.**

Në vitin 2001, A-ja, bashkëshorti i H-së e sulmoi verbalisht dhe fizikisht H-në në publik dhe

në dy raste të tjera e kërcënoi se do ta vriste atë dhe shumë persona të tjerë. Në vitin 2002, A-ja u shpall fajtor nga Gjykata e Rrethit të Sllovakisë. Gjatë procedurave gjyqësore, u paraqitën prova ekspertize që tregonin se A-ja vuante nga çrregullime bipolare dhe se mbi këtë bazë, gjykata e rrethit vendosi që A-ja të shtrohej më mirë në spital e t'i nënshtrohej një trajtimi psikiatrik, sesa të dënohej me burg. A-ja u shtrua për një periudhë të shkurtër në spital por nuk e mori trajtimin psikiatrik që i nevojitej. Me të dalë nga spitali A-ja e kërcënoi H-në dhe gjykatësin e saj verbalisht dhe të dy këta parashtruan një padi penale shtesë kundër A-së. Më vonë, Gjykata e Rrethit vendosi ta rishtrijë A-në në spital.

Nga ana e tij, H-ja paraqiti një padi në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën pretendonte se ishin shkelur nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së, të nenit 16 (1) (që garanton të drejtën e paprekshmërisë së shtëpisë dhe privacinë) dhe të nenit 19 (2) (që garanton të drejtën për t'u mbrojtur nga ndërhyrjet e pajustificueshme në jetën private dhe familjare) të Kushtetutës së Sllovakisë. Në tetor 2002, Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë padinë e H-së duke u shprehur se nuk shihet ndonjë shkelje të nenit 5 (1) të KEDNJ-së dhe duke iu përmbajtur mendimit se H-ja duhet ta kishte drejtuar padinë e tij në një gjykatë me juridiksion të zakonshëm.

Në janar 2003, H-ja paraqiti në GJEDNJ një padi kundër Republikës sllovaqe, duke pretenduar se autoritetet e vendit kishin shkelur të drejtat të sanksionuara në nenet 5 dhe 8 të KEDNJ-së, pasi nuk kishin mundur të siguronin shtrimin e A-së në spital për trajtim psikiatrik pasi ai u gjend fajtor. H-ja argumentoi se e drejta për të respektuar jetën private kërkon respekt për integritetin fizik dhe psikologjik të njeriut. Sllovakia argumentoi se çështja ishte e papranueshme sepse H-ja nuk i kishte ezauruar mjetet juridike në vend duke shkelur kështu të drejtën për mbrojtjen e integritetit të saj personal në përputhje me nenin 11 të kodit Civil të gjykatave të vendit me juridiksion të zakonshëm. H-ja, nga ana e saj, argumentoi se nuk kishte ndonjë precedent për përdorimin e nenit 11 në rastet kur paraqiten fakte të njëjta.

#### Gjykata u shpreh se :

- (1) padia lidhur me nenin 8 ishte e pranueshme pasi mjetet juridike vendase nuk ishin të mjaftueshme;
- (2) ankesa lidhur me nenin 5 ishte e papranueshme sepse neni 5 mbron të drejtën e individëve

për liri fizike, jo për siguri fizike;

- (3) Sllovakia kishte shkelur nenin 8 pasi nuk kishte mundur ta mbante A-në në trajtim psikiatrik pasi ai u gjend fajtor, sikurse parashihet në ligj;
- (4) Sllovakia duhet t'i paguaj H-së 4 000 Euro për ankthin e stresin e përjetuar si dhe 1 000 Euro për shpenzimet.

## 4

### DETYRIMI POZITIV I SHTETEVE PËR TË NGRITUR DHE ZBATUAR ME EFEKTIVITET NJË SISTEM PENAL QË NDËSHKON TË GJITHA FORMAT E MARRËDHËNIEVE SEKSUALE ME DHUNË.

#### M.C. kundër Bullgarisë

#### Vendim i GJEDNJ-së, 4 dhjetor 2003

#### Kërkesa e pranuar

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, M.C., është shtetase bullgare lindur më 1980, që pretendonte se kur kishte qenë 14 vjeç, që është edhe mosha e lejuar për kryerjen e marrëdhënieve seksuale të vullnetshme në Bullgari, ishte përdhunuar nga dy djem, A. dhe P. Përkatësisht 20 dhe 21 vjeç.
2. M.C. pretendonte se më 31 korrik 1995 ajo shkoi në një disko me dy djemtë dhe me një shoqen e saj. Në vijim ajo kërkoi që të shkonin së bashku në një disko tjetër. Në kthim, A. sugjeroi që të ndalonin për të notuar në një rezervuar. M.C. qëndroi në makinë. P. u kthye përpara të tjerëve, dhe sipas pretendimeve të kërkueses e detyroi atë që të kryenin marrëdhënie seksuale. M.C. pretendonte se mbeti në një gjendje shumë të shqetësuar. Në orët e para të mëngjesit vijues, kërkuesja u çua në një shtëpi. Atje, sipas pretendimit të saj, A. e detyroi që të kryenin marrëdhënie seksuale ndërsa ajo vazhdonte të qante gjatë dhe pas përdhunimit. Më vonë ajo u gjet nga e ëma dhe u çua në spital ku analizat mjekësore arritën në përfundimin se membrana e saj vaginale ishte çarë. A. edhe P.

- e mohuan faktin që ta kishin përdhunuar M.C.
3. Ndjekja penale në lidhje me këtë ngjarje, nuk gjeti prova të mjaftueshme që M.C ishte detyruar të kryente marrëdhënie seksuale me A. dhe P. Hetimi u mbyll në 17 mars 1997 nga prokurori i rrethit i cili arriti në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për përdorimin e forcës ose për kërcënime për kryerjen e marrëdhëniesve të tilla. Në mënyrë të veçantë nuk u vërtetua që kërkuesja të kishte rezistuar ose të kishte bërë përpjekje për të kërkuar ndihmë nga persona të tjerë. Kërkuesja apeloj ndaj këtij vendimi, por pa sukses.
  4. Mendimet me shkrim të ekspertëve, të paraqitura përpara Gjykatës së Strasburgut nga M.C., diagnostikuar “frikë e ngrirë” që është një sindromë traumatike psikologjike infantile dhe që konsiderohet si pasojë më normale e përdhunimit, kur viktimat e terrorizuar ose nënshtrihen në mënyrë pasive, ose përpiqet t'i largohen psikologjikisht konceptit të përdhunimit. Nga 25 raste përdhunimi të analizuar në Bullgari në lidhje me vajza të moshës nga 14 deri 20 vjeç, 24 prej viktimave u ishin përgjigjur përdhunuesve të tyre në këtë mënyrë.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. M.C. u ankua se e drejta dhe praktika bullgare nuk ofronin mbrojtje efektive ndaj përdhunimit dhe abuzimit seksual, përderisa hetohen vetëm rastet kur viktimat rezistojnë në mënyrë aktive. Ajo ankohej gjithashtu se autoritetet nuk i kishin hetuar në mënyrë efektive ngjarjet në fjalë. Për pretendimet e saj ajo mbështetej në nenin 3 (ndalimi i trajtimit degradues), neni 8 (e drejta për respektim të jetës private), neni 13 (e drejta për mjet efektiv) dhe në nenin 14 (ndalimi i diskriminimit).
- A. Në lidhje me nenet 3 dhe 8 të Konventës**
6. Gjykata vuri në dukje se, në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës, shtetet anëtare kanë një detyrim pozitiv të dyfishtë. Nga njëra anë ato duhet të nxjerrin një legjislacion penal që të ndëshkojë në mënyrë efektive përdhunimin dhe nga ana tjetër, duhet ta zbatojnë me efikasitet këtë legjislacion në hetim dhe ndjekje penale.

7. Në vijim, Gjykata vuri re se, historikisht, në bazë të së drejtës dhe praktikës juridike të shteteve të ndryshme, normalisht kërkohej prova e përdorimit të forcës fizike nga përdhunuesi dhe e rezistencës fizike nga ana e viktimës. Megjithatë, dukej se nuk ishte më një praktikë e kërkuar në vendet e Evropës. Në vendet e *common-law-t*, ashtu si edhe në Evropën kontinentale por edhe më gjerë, legjislacioni dhe praktika nuk kërkonin ekzistencën e një reference në lidhje me përdorimin e forcës fizike. Madje, megjithëse në shumë prej vendeve evropiane të ndikuara nga sistemi kontinental i *civil-law* përkufizimi i përdhunimit përbante referenca në përdorimin e dhunës ose të kërcënimit për dhunë nga shkaktuesi i saj, nga jurisprudenca dhe doktrina juridike duket se mungesa e pëlqimit, dhe mospërdorimi i forcës, përbënin elementin thelbësor në përkufizimin e përdhunimit.
8. Gjykata vuri re gjithashtu se, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë rënë dakord që penalizmi i akteve seksuale të pavullnetshme, pavarësisht nëse viktimat ka rezistuar apo jo, ishte i nevojshëm për mbrojtjen e grave ndaj dhunës dhe kanë kërkuar vënien në jetë të reformave të mëtejshme në këtë drejtim. Nga ana tjetër, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ka arritur në përfundimin se, në të drejtën ndërkombëtare private, çdo penetrim seksual pa vullnetin e viktimës përbën përdhunim, duke pasqyruar kështu një tendencë universale që e sheh mungesën e pëlqimit si një mjet thelbësor të përdhunimit dhe të abuzimit seksual. Në përgjithësi, ligji dhe praktika ligjore në lidhje me përdhunimin janë në zhvillim e sipër për të pasqyruar qëndrimet sociale në ndryshim, të cilat kërkojnë respektim të autonomisë seksuale të individit dhe barazi. Duke pasur parasysh standardet dhe tendencat aktuale, detyrimi pozitiv i shteteve anëtare, në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës, kërkon penalizmin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual të pavullnetshëm, edhe kur viktimat nuk ka rezistuar fizikisht.
9. Kërkuesja pretendon se në rastin e saj, qëndrimi i autoriteteve justifikohet me një legjislacion të mangët dhe pasqyrore një praktikë për ndjekjen e përdhunuesve vetëm

kur ka pasur prova për të një rezistencë fizike të fortë nga ana e viktimës. Qeveria Bullgare nuk ishte në gjendje të ofronte kopje të vendimeve gjyqësore ose mendimin juridik bullgar, që hidhnin poshtë pretendimet e kërkuases për një përjasje të ngushtë në konceptimin dhe penalizimin e përdhunimit. Pretendimi i saj bazohej në argumente të lojlikshëm, të cilët nuk u hodhën poshtë.

10. Ofrimi i dy versioneve të papajtueshme në lidhje me faktet, natyrisht që kërkonte vlerësim të kujdesshëm të kontekstit në lidhje me besueshmërinë e deklaratave të bëra, si dhe verifikimin e të gjitha rrethanave. Megjithatë, ishte bërë shumë pak për vlerësimin e besueshmërisë së versionit të ngjarjeve të ofruar nga P. dhe A., apo për të provuar besueshmërinë e dëshmitarëve të thirrur nga të akuzuarit, ose përcaktimin e kohës së saktë të ngjarjes. As kërkuësja dhe as përfaqësuesit e saj nuk kishin qenë në gjendje t'u bënin pyetje dëshmitarëve, të cilët kërkuësja i kishte akuzuar për dëshmi të rreme. Në vijim të këtyre fakteve, autoritetet nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim për të shfrytëzuar ndonjë mundësi për qartësimin e të gjitha rrethanave që nuk kishin vlerësuar si duhej besueshmërinë e deklaratave që ishin bërë e që ishin të papajtueshme me njëra-tjetrën. Arsyeja e këtyre mosveprimeve duket të ishte për shkak të faktit se, hetuesi dhe prokurori vlerësonin se ishin përpara “marrëdhënieve seksuale të detyrueshme mes personave që njihen” dhe, në mungesë të një prove “të drejtpërdrejtë” përdhunimi të tilla si, gjurmë dhune dhe rezistence ose thirrje për ndihmë, ata nuk mund të deduktonin një provë për një mungesë pëlqimi dhe, për këtë arsye, një përdhunim, duke u nisur vetëm nga vlerësimi i të gjitha rrethanave të ngjarjes.

11. Pa shprehur ndonjë mendim në lidhje me fajësinë ose jo të P. dhe A., Gjykata konstatoi se efektiviteti i hetimit të çështjes së kërkuarit dhe, në veçanti, qëndrimi i mbajtur nga hetuesi dhe prokurorët, nuk respektonte detyrimet pozitive të Bullgarisë në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës. Nën dritën e standardeve të zbatueshme të së drejtës moderne ndërkombëtare dhe të krahasueshme, këto detyrime kërkojnë ngritjen dhe funksionimin efektiv të një

sistemi ligjor penal që dënon të gjitha format e përdhunimit dhe abuzimit seksual.

#### B. Në lidhje me nenet 13 dhe 14 të Konventës

12. Gjykata konstatoi se nuk dilte në pah ndonjë problem i veçantë në bazë të nenit 13 dhe se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtohej ankesa në bazë të nenit 14.

#### C. Neni 41

13. Gjykata i akordoi kërkuases 8000 Euro shpërblim për dëm jomaterial dhe 4110 Euro për shpenzime dhe pagesa.

## 5

### PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA; SEANCË DËGJIMORE KORREKTE; DETYRIMET POZITIVE

#### Farkas kundër Rumanisë

#### Vendimi i GJEDNJ-së, 14 shtator 2010

#### E hedhur poshtë si e papranueshme

F-ja është një shtetas rumun, i cili qysh në moshën 10 vjeçare ka vuajtur nga distrofia muskulare dhe mezi lëviz. Pasi u transferua në një vend të ri pune nga punëdhënësi i tij, F-ja u detyrua të pranonte të ndërpriste kontratën e punës pasi pozicioni i ri i punës nuk përshpallte me aftësitë e kufizuara të tij. F-ja u përpoq ta kundërshtonte pushimin e tij nga puna në gjykatë. Por, F-ja pretendonte se godinat e gjykatës lokale nuk u krijonin akses personave me aftësi të kufizuar. Ai u përpoq gjithashtu të kontaktonte një gjykatës për të kontestuar zgjidhjen e kontratës së tij të punës, por, sipas tij, asnjë nga zyrat e gjykatës nuk ishte e përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara fizike. Përveç kësaj, po për të njëjtat arsye praktike, F-ja pretendonte se nuk mund të shkonte në postë, nga ku mund të kontaktonte gjykatësin. F-ja nuk mund të gjente ndonjë punë tjetër dhe u detyrua të ndërpriste trajtimin mjekësor, që kushtonte shumë shtrenjtë, nëse marrim parasysh pagesën për aftësi të kufizuar që F-ja merrte nga komitete të ndryshme. Duke mos patur akses në mjete transporti dhe në institucionet e ndryshme publike, F-ja u ndje plotësisht i izoluar dhe i përjashtuar nga shoqëria.

F-ja paraqiti pranë GJEDNJ-së një padi kundër Rumanisë, ku pretendonte se ishin shkelur të drejtat e tij, të sanksionuara në nenet 6 (1), 8 dhe 14 të KEDNJ-së. Ai argumentoi se nuk mund të kundërshtonte vendimet e punëdhënësit të tij dhe të komiteteve që alokonin pagesa për persona me aftësi të kufizuar apo ofronin masa të tjera në mbështetje të personave me aftësi të kufizuar, për shkak të mungesës të aksesit fizik në godinat e gjykatave, zyrat e gjykatësve dhe në postë. F-ja pretendonte se pagesa e aftësisë së kufizuar dhe vendimet mbështetëse, se mungesa e aksesit fizik për personat me aftësi të kufizuar dhe mungesa e masave pozitive nga shteti për t'u krijuar akses personave me aftësi të kufizuara pati pasoja serioze në jetën e tij personale dhe të familjes së tij dhe kontribuoi në marginalizimin e tij nga shoqëria. F-ja pretendonte gjithashtu, se ishte viktimë e diskriminimit.

Rumania argumentoi se, në fakt, F-ja ishte në gjendje të bënte disa hapa dhe se aksesit në institucionet gjyqësore dhe zyrat e postës, gjithsesi, nuk përbënte ndonjë pengesë në periudhën për të cilën pretendonte F-ja dhe se, përkundrazi, ato ishin të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar, madje F-ja mund të kishte kontaktuar me Dhomën e Avokatëve, me postë ose faks.

#### Gjykata u shpreh se:

- (1) nuk ekzistonin pengesa të pakapërcyeshme që të mund të kompromentonin aksesin e F-së në gjykatat lokale në përputhje me nenin 6 (1), përsa kohë që ekzistonin edhe mënyra të tjera indirekte për të realizuar procedurat ligjore, si me anën e një ndërmjetësi, ashtu edhe me postë;
- (2) nuk ka mjaftueshmërisht ndonjë lidhje “direkte apo të drejtpërdrejtë” midis masave që priteshin të merreshin nga shteti dhe pasojave në jetën private të F-së për të justifikuar ndonjë shkelje të mundshme të nenit 8 ;
- (3) meqenëse nenet 6 (1) dhe 8 nuk gjejnë zbatim në këtë rast, atëherë nuk kemi asnjë shfaqje të trajtimit diskriminues ndaj F-së nga autoritetet lokale e kombëtare;
- (4) sipas nenit 35 (1), meqenëse F-ja nuk i kishte ezauruar të gjitha mjetet juridike të Rumanisë, F-ja nuk ka të drejtë të paraqes një padi të tillë para Gjykatës;
- (5) për pasojë kërkesa është rrëzuar.

## 6

### DISKRIMINIM; LEVIZJE; MIGRACION; JETË FAMILJARE

#### Kiyutin kundër Rusisë

Vendimi i GJEDNJ-së, 10 mars 2011

#### Shkelje e nenit 14- për ndalimin e diskriminimit- dhe nenit 8- mbi të drejtën për të respektuar jetën private dhe atë familjare- të KEDNJ-së

K-ja u lind në RSS Uzbeke të Bashkimit Sovjetik dhe pas shpërbërjes së BRSS-së mori shtetësinë uzbeke. Në tetor të vitit 2002, vëllai i K-së bleu një shtëpi në Rajonin Oryol të Rusisë. Në vitin 2003 K-ja, gjysmë vëllai i tij dhe nëna e tyre u shpërngulën në këtë shtëpi. Në korrik të vitit 2003, K-ja u martua me një vajzë të kombësisë ruse dhe në janar të vitit 2004 ata u bënë me një vajzë. Në gushtin e vitit 2003 ai aplikoi për leje-qëndrimi, për të cilën iu kërkua t'i nënshtrohej një ekzaminimi mjekësor, nga i cili rezultoi të ishte HIV-pozitiv. Kërkesa e tij për leje-qëndrimi iu refuzua, pasi ai doli pozitiv në testin për HIV. Ky refuzim u dha nga gjykata rajonale e Oryol-it, më 13 tetor 2004.

Në prill të vitit 2009 K-ja paraqiti një kërkesë të re për leje-qëndrimi të përkohshme. Më 26 qershor 2009, Shërbimi Federal i Migracionit në Rajonin e Oryol-it e refuzoi kërkesën e K-së për leje-qëndrimi, bazuar në paragrafin 7(1)(13) të Ligjit për Shtetasit e Huaj, që kufizon dhënien e lejeve të tilla për shtetasit e huaj, të cilët nuk mund të provojnë statusin e tyre HIV-negativ. Apelimet e K-së kundër këtij dispozitivi u hodhën poshtë.

K-ja iu drejtua GJEDNJ-së me pretendimin se Rusia e kishte diskriminuar atë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore lidhur me kërkesën për leje-qëndrim, duke shkelur kështu nenet 8, 13, 14 dhe 15 të KEDNJ-së. K-ja pretendonte veçanërisht se refuzimi i kërkesës për leje-qëndrimi cenonte të drejtën e tij për të jetuar me familjen e vet dhe ishte në kundërshtim me qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit publik.

Qeveria, nga ana e saj, u përgjigj se K-ja vazhdonte të jetonte ende me familjen e vet në Rajonin Oryol dhe se ai nuk ishte dëbuar. Për pasojë, refuzimi i lejes së qëndrimit nuk kishte ndërhyrë në të drejtën e tij të respektimit të jetës familjare dhe madje, edhe nëse kjo ndodhte, ndërhyrja

justifikohej nga paragrafi 7 (1) (13) i Ligjit për Shtetasit e Huaj. Më tej, qeveria argumentoi se ndërhyrje të tilla justifikoheshin nga shqetësimi i Rusisë për përhapjen e një epidemie HIV.

K-ja ishte kundërpërgjigjur se ai nuk ishte dëbuar ende për arsye të qëndrimit "shih e bëj" të qeverisë, e cila thjesht po priste rezultatet e procedurave të ndryshme ligjore. K-ja pretendonte gjithashtu se gjykatat ruse ishin shprehur se K-ja përbente një rrezik të madh shëndetësor, por se ato nuk e kishin analizuar mënyrën e tij të jetesës dhe nuk e kishin shpjeguar se në ç'mënyrë K-ja paraqiste një kërcënim të tillë.

### Ndërhyrja e Personit të Tretë në gjykim.

Organizata joqeveritare INTERIGHTS ndërhyri në gjykim si palë e tretë dhe parashtroi se dispozitat e përgjithshme kundër diskriminimit të traktateve kryesore mbi të drejtat e njeriut ishin interpretuar si dispozita që ndalonin diskriminimin nisur nga statusi HIV. Ata argumentuan se personat me HIV duhet të përfitojnë nga ndalimi i diskriminimit nisur nga aftësitë e kufizuara të tyre, sikurse sanksionohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe në sistemet e tjera ligjore. Lidhur me standardet kundër diskriminimit, personat me HIV formojnë një grup vulnerabël të veçantë, sikurse janë p. sh. romët dhe homoseksualët, që u japin shteteve një marzh të vogël vlerësimi përsa u përket praktikave diskriminuese.

Një nga justifikimet e mundshme për trajtimin jo të barabartë të K-së, pra kërcënimin që praqet ai për shëndetin publik, mund ta justifikojë trajtimin e diferencuar ndaj tij. Megjithatë, INTERIGHTS vuri në dukje se ekzistojnë dëshmi që tregojnë se ndalimi i udhëtimeve dhe i imigrimit të personave me HIV nuk ka qenë efikas në parandalimin e përhapjes së HIV-it. Një tjetër justifikim i mundshëm për trajtimin e pabarabartë të K-së ishte arsyetimi publik i kostos, megjithatë u theksua se GJEDNJ-ja më herët, ishte shprehur se burimet e pamjaftueshme nuk përbëjnë një justifikim për adoptimin e politikave shëndetësore të bazuara në kritere arbitrare.

### Gjykata u shpreh se:

- (1) ankesa lidhur me refuzimin e lejes së qëndrimit është e pranueshme, por pjesa e mbetur e kërkesës është e papranueshme;
- (2) ky rast hyn në "përcaktimet" e nenit 8, pasi

koncepti i "jetës familjare" duhet të përfshijë marrëdhëniet që burojnë nga një martesë e vërtetë, nga e cila lindi edhe fëmija i K-së;

- (3) një dallim i bërë në statusin shëndetësor të dikujt, si në rastin e infektimit me HIV, mbulohet me termin "status tjetër" në tekstin e nenit 14, prandaj në këtë rast gjen zbatim neni 14 së bashku me nenin 8;
- (4) personat me HIV përfaqësojnë një grup vulnerabël, prandaj, vendimit të qeverisë për ta trajtuar grupin e personave të infektuar me HIV ndryshe, duhet t'i jepet vetëm një marzh i vogël vlerësimi nga Gjykata;
- (5) qeverisë i jepej vetëm një marzh i vogël vlerësimi, pasi përjashtimi i aplikuesve me HIV nga e drejta për leje qëndrimi nuk është një marrëveshje e përcaktuar konsensuale e nivelit Evropian;
- (6) kufizimet lidhur me statusin HIV për rezidentët afatgjatë nuk kanë qenë efikase në parandalimin e përhapjes së HIV-it;
- (7) Qeveria nuk konfirmoi në mënyrë bindëse se K-ja do të përfaqësonte një barrë financiare për shtetin;
- (8) meqenëse mbrojtja e shëndetit publik është synim legjitim, qeveria nuk arriti të paraqes argumente bindëse për të treguar se refuzimi i kërkesës së K-së për leje qëndrimi nuk u bë për arsye të gjendjes së tij shëndetësore;
- (9) nga këndvështrimi i gjithçkaje sa u tha më lartë, qeveria ka tejkaluar marzhin e ngushtë të vlerësimit të ofruar, duke shkelur kështu nenin 14, i marrë në lidhje me nenin 8;
- (10) qeveria duhet t'i paguaj K-së 15 mijë Euro për dëmet jopasurore dhe 350 Euro për shpenzimet.

## 7

### ARSIMIMI; FEJA

#### Lautsi & Orsi kundër Italisë

**Vendimi i GJEDNJ-së (Dhomës së Madhe), më 18 mars 2011**

Asnjë shkelje e nenit 2 të protokollit nr.1-mbi të drejtën për arsim- të KEDNJ-së

Në vitin shkollor 2001-2002, L-ja i futi të dy djemtë e tij në një shkollë shtetërore në Abano Terme të Italisë. Në muret e çdo klase të shkollës ishte fiksuar nga një kryq, dekretuar nga ligjet italiane. L-ja e kundërshtoi kryqin si simbol fetar por ai nuk ia arriti t'a bindte shkollën t'i hiqte kryqet. Duke mos arritur dot ta bënte këtë, iu drejtua gjykatave italiane të detyronin shkollën t'i hiqte kryqet.

Në vitin 2006 L-ja iu drejtua GJEDNJ-së, në emrin e saj dhe të fëmijëve të saj, duke pretenduar se Italia kishte shkelur nenin 2 të Protokollit nr. 1, duke dhunuar të drejtën për arsim dhe se nuk kishte respektuar të drejtat e prindërve për t'i siguruar ata se një arsimim i tillë ishte në përputhje me besimet e tyre fetare dhe filozofike. L-ja u ankua me tej se Italia kishte shkelur nenin 9 duke dhunuar të drejtën për lirinë e mendimit. Në 3 nëntor 2009 Dhoma e GJEDNJ-së vendosi që:

- (a) Italia ishte e detyruar të shmangte imponimin e besimeve në vende të frekuentuara nga persona vulnerabël;
- (b) liria “negative“ e fesë nuk kufizohej me mungesën e edukimit fetar, por zgjerohej në praktikat që shprehin një besim; një fe apo ateizmin;
- (c) Italia kishte për detyrë të mbështeste neutralitetin fetar në arsimin publik, ku pjesëmarrja ishte e detyrueshme;
- (d) kuptimi fetar i kryqit ishte mbizotërues;
- (e) si rezultat i gjithë sa u tha më lart, Italia e kishte shkelur nenin 2 të protokollit nr. 1, së bashku me nenin 9 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-së).

Më 1 mars 2010 u pranua kërkesa e Italisë për ta adresuar çështjen në Dhomën e Lartë të GJEDNJ-së. Para Dhomës së Lartë, pala kërkuese parashtroi se ekspozimi i kryqeve në klasa ishte një ndërhyrje e paligjshme në të drejtën e djemve të L-së për lirinë e mendimit e të ndërgjegjes dhe cenonte parimin e pluralizmit arsimor, sepse ekspozimi i kryqeve shprehte preferencën e shtetit për një fe të caktuar. Meqenëse L-ja ishte në favor të anti-laicizmit, kryqi dhunonte të drejtën e saj për t'i arsimuar fëmijët e saj në përputhje me bindjet e saj filozofike. Pala kërkuese argumentoi se kryqi ishte një simbol fetar që nuk i atribuohet një vlere kulturore. Pala kërkuese pohoi se parimi i sekularizmit (antilaicizmit) kërkon para së gjithash, neutralitet nga ana e shtetit, i cili duhet të qëndrojë jashtë sferës fetare dhe të

mbajë të njëjtin qëndrim ndaj të gjitha rrymave fetare. Pala kërkuese u mjaftua me faktin se ekspozimi i kryqeve nuk ishte në përputhje me një demokraci pluraliste e të hapur dhe me respektin për të drejtat e liritë personale të sanksionuara në Kushtetutën Italiane dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Italia u përgjigj se, meqenëse Dhoma nuk kishte kryer ndonjë studim ligjor krahasues mbi këto çështje, nuk ekzistonte asnjë provë që të dëshmonte se nuk ka ndonjë qasje të përbashkët në Evropë lidhur me këto çështje. Për pasojë, Italia u mjaftua me atë që Dhoma dështoi në dhënien e një marzhi të gjerë vlerësimi për të cilën ajo kishte të drejtë. Italia argumentoi gjithashtu se Dhoma ngatërroi “neutralitetin” si një koncept gjithëpërfshirës me “sekularizmin” si një koncept përjashtues, duke favorizuar në këtë mënyrë një zgjidhje antifetare të çështjes.

Italia pretendoi se edhe kur shenja e kryqit perceptohej si simbol fetar ajo përfaqësonte gjithashtu, një simbol të kulturës dhe identitetit të parimeve dhe vlerave që krijojnë bazën e demokracisë. Italia u mjaftua më tej me faktin se kryqi përfaqësonte një “simbol pasiv” dhe se, vetëm ekspozimi i tij nuk mund të krahasohej me aktivitetet aktive fetare. Italia argumentoi gjithashtu se, kryqi ishte shprehje e një tipari kombëtar që i atribuohet zhvillimit historik, kulturor dhe territorial të Italisë dhe se ekspozimi i tij ishte një çështje që lidhej me respektin për një traditë të vjetër shumëshekullore. Italia pranoi se neni 2 i Protokollit nr. 1 ishte i zbatueshëm vetëm për kurrikulën shkollore dhe se Dhoma nuk do të mund të konstatonte ndonjë shkelje, pa zbuluar më parë që prezenca e kryqit kufizonte në mënyrë të ndjeshme aftësinë e L-së për t'i rritur fëmijët e saj, në përputhje me bindjet e saj. Italia vuri theksin në nevojën për të marrë parasysh të drejtën e prindërve, të cilët dëshironin ekspozimin e kryqeve në klasa, si shprehje të vullnetit të shumicës në Itali.

### **Ndërhyrja e palës së tretë në gjykim.**

Qeveritë e Armenisë, Bullgarisë, Qipros, të Federatës Ruse, të Greqisë, Lituanisë, Maltës dhe të Republikës së San Marinos ndërhyjnë në mbështetje të Italisë duke argumentuar se Dhoma “ngatërroi” neutralitetin “ me “sekularizmin”, duke shtuar se sekularizmi nuk ishte një pozicion politik neutral. Ata pretendonin se një shtet nuk ishte neutral nëse mbështeste laicizimin në raport me fenë. Principata



e Monakos ndërhyri në mbështetje të pikëpamjes së Italisë se kryqi ishte “një simbol pasiv” që reflektonte identitetin kombëtar të rrënjosur në histori. Qeveria e Rumanisë ndërhyri në mbështetje të Italisë, duke parashtruar se Dhoma kishte dështuar në marrjen në konsideratë në mënyrë të mjaftueshme të marzhit të gjerë të vlerësimit ndaj shteteve, ku merren parasysh çështje sensitive dhe për të cilat nuk ka konsensus të gjerë Evropian.

Qendra Evropiane për Ligjin dhe Drejtësinë ndërhyri gjithashtu, në mbështetje të Italisë duke argumentuar se, meqenëse Dhoma nuk kishte qenë në gjendje të vërtetonte se ishin cenuar “bindjet intime apo personale të fëmijëve të L-së”, Dhoma kishte krijuar një detyrim të ri për t’u siguruar se mjedisi arsimor ishte plotësisht laik, duke tejkaluar kështu juridiksionin e saj si dhe fushën e zbatimit të tij.

Komiteti Qendror i Katolikëve Gjermanë (Zentralkomitee der deutsche Katholiken), Javët sociale të Francës (Semaines sociales de France) dhe Shoqata Italiane e Punëtorëve të krishterë (Associazione cristiane lavoratori italiani) ndërhyne në mbështetje të Italisë, duke mbrojtur mendimin se shtetit i duhet dhënë një hapësirë më e gjerë vlerësimi, pasi marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë në vende të ndryshme janë të ndryshme dhe se ato ishin të rrënjosura thellë në traditën dhe kulturën e vendeve. 33 anëtarët e Parlamentit Evropian ndërhyne duke vënë në dukje se GJEDNJ-ja nuk ishte një institucion konstitucional dhe se ajo duhet të njihte një hapësirë të gjerë e të veçantë vlerësimi në favor të shteteve lidhur me marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë, si dhe në fushën e arsimit. Ata argumentuan se prezenca e simboleve fetare në hapësirat publike nuk duhet të shihet si formë indoktrinimi, por si shprehje e unitetit dhe identitetit kulturor.

Monitoruesi grek i Helsinkit ndërhyri në mbështetje të palës paditëse dhe argumentoi se kryqi ishte simbol fetar dhe se ekspozimi i tij në një shkollë shtetërore mund të konsiderohej si një mesazh shtetëror në mbështetje të një feje të caktuar. Shoqata kombëtare e mendimit të lirë (Associazione nazionale del libero Pensiero), ndërhyri në mbështetje të palës paditëse, duke argumentuar se prezenca e simboleve fetare në shkollat shtetërore ishte në kundërshtim me nenet 9 dhe 2 të Protokollit nr.1, pasi kufizimet që i imponohen palës paditëse nuk ishin “parashkruar në ligj” brenda kuptimit të jurisprudencës (të së

drejtës sipas praktikës së mëparshme) të GJEDNJ-së. Organizata EUROJURIS ndërhyri në mbështetje të palës paditëse duke argumentuar se kryqi ishte një simbol fetar, me të cilin nuk mund të identifikohen personat që nuk janë të krishterë dhe se sipas parimit të sekularizmit, shkollat nuk duhet të jenë vend për proselitizëm<sup>5</sup>. Komiteti Ndërkombëtar i Juristëve, INTERRIGHTS dhe Human Rights Watch ndërhyne gjithashtu në mbështetje të palës paditëse duke argumentuar se ekspozimi i detyrueshëm i simboleve fetare nuk ishte në përputhje me parimin e neutralitetit dhe të drejtat e prindërve dhe nxënësve, bazuar në nenet 9 dhe 2 të Protokollit nr. 1. Ata argumentuan se pluralizmi arsimor ishte një parim i sanksionuar i jurisprudencës dhe instrumenteve ndërkombëtare. Ata mbështeten mendimin se neutraliteti i shtetit lidhur me besimet fetare ishte veçanërisht i rëndësishëm në klasat e mësimit, pasi fëmijët janë vulnerabël ndaj indoktrinimit.

#### Gjykata u shpreh se :

- (1) çështja para se ajo të prekte vetëm pajtueshmërinë e ekspozimit të kryqeve në shkollat shtetërore italiane me nenet 2 të Protokollit nr. 1 dhe nenin 9;
- (2) mbështetësit e sekularizmit mund të pretendojnë pikëpamje që arrijnë nivelin e forcës bindëse, seriozitetit, kohezionit dhe rëndësisë së kërkuar për t’i konsideruar si “bindje” sipas nenit 9 dhe si “bindje filozofike” sipas nenit 2 të Protokollit nr.1;
- (3) shtetet mbajnë përgjegjësinë për të siguruar në mënyrë neutrale dhe të paanshme ushtrimin e besimeve feve dhe bindjeve të ndryshme fetare;
- (4) shtetet gëzojnë një marzh të gjerë vlerësimi në përcaktimin e hapave që duhet të ndërmarrin për të siguruar përputhje me KEDNJ-në, duke treguar vëmendjen e duhur ndaj nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve;
- (5) shteteve u ndalohet të ushtrojnë indoktrinimin, duke mos respektuar kështu bindjet fetare dhe filozofike të prindërve;
- (6) çështja e rregullimit të mjedisit shkollor, përfshi këtu prezencën e kryqeve hyn në

5 Proselitizëm= përpjekje për të konvertuar pikëpamjen dhe veçanërisht besimin fetar të dikujt.

fushën e veprimit të nenit 9 të Protokollit nr.1;

- (7) vendimi për të përjetësuar traditën, përfshi këtu edhe ekspozimin e kryqeve, ishte në marzhin e vlerësimit të shteteve;
- (8) mungesa e konsensusit Evropian lidhur me praninë e simboleve fetare në shkollat shtetërore favorizon zbatimin e marzhit të vlerësimit;
- (9) ekspozimi i kryqit është një “simbol pasiv“, dhe si i tillë ai nuk mendohet se ka ndikim tek nxënësit nëse krahasohet me bisedat didaktike apo pjesëmarrjen në aktivitete fetare;
- (10) ai nuk është dakord me vendimin e Dhomës për të ndjekur kazusin Dahlab kundër Zvicrës dhe ta trajtojë ekspozimin e kryqeve si një “simbol të jashtëm të fuqishëm”;
- (11) ekspozimi i kryqeve ishte bërë brenda kufijve të marzhit të vlerësimit dhe të detyrimit të shtetit për të respektuar të drejtën e prindërve për të siguruar arsimim dhe mësimdhënie në përputhje me besimet e tyre filozofike;
- (12) nuk ka patur asnjë cenim të nenit 2 të Protokollit nr. 1 lidhur me L-në dhe se sipas nenit 9 nuk mund të parashtrahet si çështje më vete;
- (13) nuk pati asnjë arsye për ta shqyrtuar çështjen në bazë të nenit 14, pasi çështjet tashmë ishin zgjidhur në përputhje me nenin 2 të Protokollit nr.1.

## 8

### LIRIA & SIGURIA, ARRESTIMI; TRAJTIM ÇNJERËZOR DHE POSHTËRUES

#### Kharchenko kundër Ukrainës

Vendimi i GJEDNJ-së, 10 shkurt 2011

**Shkelje e nenit 3 – ndalimi i torturës ose i trajtimit çnjerezor apo poshtërues dhe e neneve 5 (1), 5(3) dhe 5 (4), mbi të drejtën për liri dhe siguri të KEDNJ-së**

#### Asnjë shkelje e nenit 6 (1) mbi të drejtën për një gjyq korrekt–të KEDNJ-së

K-ja u caktua si dëshmitar në një çështje të ngritur kundër një shoqërie të përfshirë në shpërdorime e përvetësime. Gjatë procesit të hetimit, prokurori ngriti padi penale kundër K-së si i dyshuar në përfshirjen e tij në shpërdorime e përvetësime dhe në 7 prill 2001, K –ja u arrestua nga autoritetet në zbatim të urdhrit të prokurorit.

Koha e arrestit, bazuar në kërkesën e prokurorit, skadonte në qershor 2001. Deri në shtator 2001 prokurori nuk e paditi K-në për vjedhje. Gjatë kësaj periudhe, K-ja mbeti në arrest pa asnjë urdhër gjykate apo një rishqyrtim juridik të çështjes së tij. Më në fund, në tetor 2001 gjykata e rrethit organizoi një seancë përgatitore dëgjimore për këtë çështje, gjatë së cilës gjykatësi shqyrtoi padinë si dhe një kërkesë të K-së për t’u liruar nga burgju. Gjykata e rrethit vendosi ta ridërgojë çështjen për hetime të mëtejshme shtesë dhe e refuzoi kërkesën e K-së për ta liruar atë, bazuar në vendimin origjinal të prokurorit për ta arrestuar atë. Prokurori pretendonte se e mbante K-në në arrest për të parandaluar ndonjë shmangie apo pengesë të drejtësisë nga K-ja, si dhe të siguronte daljen e tij para gjyqit. Gjykata e rrethit nuk bëri asnjë analizë të mëtejshme dhe nuk dha asnjë shpjegim për vendimin e saj dhe K-ja e apeloj çështjen. Gjykata e Apelit e anuloi vendimin e gjykatës së rrethit dhe urdhëroi ridërgimin e çështjes në gjykatën e rrethit për ta shqyrtuar atë në bazë të të mirave dhe të këqijave.

Në tri raste shtesë, gjykata e rrethit organizoi seanca dëgjimore për çështjen në fjalë dhe në çdo rast, ajo urdhëroi që çështja të rikthehej për hetime të mëtejshme ndërkohë që lirimi i K-së u refuzua. Gjykata e rrethit kurrë nuk dha shpjegime e nuk bëri asnjë analizë mbi vendimin e saj dhe u mbështet vetëm në arsyet që prokurori kishte dhënë qysh në fillim për arrestimin e K-së. Në të gjitha rastet K-ja e apeloj çështjen, ndërkohë që Gjykata e Apelit pasi e anulonte vendimin e gjykatës së rrethit e urdhëronte atë ta rikthente çështjen në gjykatën e rrethit.

Me në fund, K-ja u lirua nga burgju me 4 gusht 2003, pasi kishte qëndruar i arrestuar për një periudhë kohe prej gjithsej 2 vjet e 4 muaj. Në fund të vitit 2004 u rrëzuan të gjitha akuzat kundër tij.

Gjatë periudhës kur kishte qëndruar në arrest K-ja në periudha të ndryshme kohe, kishte kaluar në 16 qeli të ndryshme. Në të gjitha qelitet ku kishte qenë, ishin shpesh të mbipopulluara me të burgosur

përtej kapacitetit të tyre. Të gjitha qelitë kishin një furnizim të vazhdueshëm me ujë të ftohtë, ndriçim natyror dhe artificial, si dhe një banjë më vete dhe ventilim. Qysh para se të futej në burg, K-ja vuante nga probleme shëndetësore kronike. Gjatë periudhës kur ishte i burgosur ai iu nënshtrua të paktën një herë në vit analizave mjekësore. Në një rast, K-ja u ankua se kishte dhimbje kraharori dhe marrje mendsh. Ai mori mjekim dhe ditën e nesërme u dërgua në klinikën shëndetësore të burgut. K-ja qëndroi në klinikë dy muaj, ku u trajtua me medikamente dhe iu nënshtrua analizave të rregullta mjekësore. Pasi u largua nga klinika dhe derisa u lirua, K-ja nuk kërkoi më asnjë trajtim mjekësor për ndonjë shqetësim tjetër shëndetësor. Disa ditë pas lirimimit të tij nga burgu, K-ja u shtrua në spital ku iu nënshtrua një trajtimi të përgjithshëm mjekësor për sëmundjen e tij kronike.

K-ja paraqiti një padi kundër shtetit pranë GJEDNJ-së, në të cilën pretendonte se konstatonte një numër shkeljesh të KEDNJ-së. Së pari, K-ja pretendonte se kushtet e burgut ishin të këqija, për shkak të mbipopullimit të qelive, ventilimit të dobët dhe të një ambienti me lagështi e të ftohtë. Shteti i hodhi poshtë pretendimet e K-së por nuk mundi të paraqes asnjë dëshmi për t'i përgënjeshtuar ato. Së dyti, K-ja pretendonte se kishte marrë trajtim mjekësor jo të përshtatshëm për gjendjen e tij shëndetësore. Në përgjithësi, shteti i hodhi poshtë akuzat e tij dhe bëri me dije se K-ja kishte marrë trajtim mjekësor menjëherë sapo ishte ankuar për dhimbje kraharori dhe se kur ishte liruar ishte në gjendje të mirë shëndetësore. Së fundi, K-ja drejtoi një numër akuzash ndaj shtetit për shkelje procedurale, se ai p.sh., ishte arrestuar në mënyrë të paligjshme, se periudha e arrestit të tij kishte qenë tejet e gjatë dhe e pajustifikuar, se shteti nuk kishte mundur të realizonte një gjykim të shpejtë të çështjes së tij, se periudha e proceseve gjyqësore kishte qenë jashtëzakonisht e gjatë dhe se ai nuk kishte patur mjete juridike efektive kundër kohëzgjatjes së procedurave të tilla. Shteti u mbështet në kodin e procedurave penale për të hedhur poshtë akuzat e K-së.

#### Gjykata u shpreh se :

1. kushtet fizike të arrestimit të K-së përbënin një trajtim poshtëruar në shkelje të nenit 3;
2. shteti kishte shkelur nenin 5 (1), pasi K-ja kishte qëndruar në burg arbitrarisht pas qershorit, kur kërkesa fillestare e prokurorit për arrestimin e tij kishte skaduar;
3. qëndrimi i K-së në paraburgim për një periudhë dy vjet e katër muaj ishte jashtëzakonisht e gjatë dhe e paarsyeshme dhe shkelte nenin 5 (3);
4. gjykatat kishin dështuar për t'i siguruar K-së një shqyrtim të shpejtuar mbi ligjshmërinë e arrestimit të tij, duke shkelur kështu nenin 5 (4);
5. kohëzgjatja e procedurave penale kundër K-së nuk e cenonte nenin 6 (1), pasi ato nuk ishin as të tepruara dhe as të paarsyeshme;
6. Shteti duhet t'i paguaj K-së 20 000 Euro për dëmet jopasurore.

## 9

### JETA; LIRIA & SIGURIA; TORTURA; MJETET JURIDIKE.

#### Carabulea kundër Rumanisë

##### Vendimi i GJEDNJ-së, 13 korrik 2010

**Shkeljet e nenit 2-të së drejtës për jetën (aspekte thelbësore dhe procedurale), e nenit 3- për parandalimin e torturës ose të trajtimit jonjerëzor ose poshtëruar (aspekte thelbësore dhe procedurale), si dhe nenin 13- mbi të drejtën për një mjet efikas - të KEDNJ-së.**

Në prill të vitit 2006, një stacion policie në Bukuresht lëshoi një urdhër arresti për GC-në, i dyshuar për vjedhje. Ditën e arrestimit, policia e pikasi GC-në në një makinë dhe iu vu pas. Pas një aksidenti të vogël automobilistik, policia e kapi GC-në dhe hartoi një raport për shkelje të rregullave të drejtimit të makinës pa leje qarkullimi. Raporti i policisë mbi incidentin vinte në dukje se nuk pati asnjë dëm në automjetet e përfshira në aksident dhe se nuk pati asnjë të plagosur. Nga të dhënat e policisë vihej në dukje se GC-ja ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe se nuk pati as të nxira e as shenja në trup. GC-ja, as formalisht, nuk iu nënshtrua ndonjë ekzaminimi mjekësor.

Familja e GC-së e vizitoi atë disa herë në burg. Në çdo vizitë ai dukej se po përkeqësohej gjithnjë e më shumë. Tri ditë pas arrestimit, GC-ja u shtrua në repartin e shërbimit intensiv në një spitali. Policia e mbajti GC-në në një dhomë të veçantë, nën mbikëqyrje të vazhdueshme policore. Gjendja shëndetësore e GC-së vazhdonte të përkeqësohej. Policia refuzoi të lejonte familjarët e tij ta vizitonin

dhe mjekët nuk duhet të takonin familjarët e t'u shpjegonin gjendjen shëndetësore të GC-së. Por familjarët të GC-së arritën ta takonin atë vjedhurazi herë pas here dhe GC-ja u kishte treguar se ishte rrahur nga policia gjatë qëndrimit i izoluar në burg.

GC-ja vdiq dy javë pasi ishte shtruar në spital. Pas vdekjes së GC-së, policia dështoi në përpjekjet e saj për të njoftuar familjarët mbi vdekjen e tij dhe kreu një autopsi pa i vënë ata në dijeni dhe pa lejen e tyre. Kur familjarëve iu lejua të shihnin kufomën e GC-së, ata fotografuan vendet e mavisosura si dhe shenja të tjera në trupin e tij. Dy herë familja i kërkoi qeverisë të hetonte mbi shkakun e vdekjes së GC-së. Prokurorët e caktuar për rastin në fjalë kryen hetime të përcipta duke intervistuar vetëm policët dhe duke riparë raportin e autopsisë. Në të dy rastet, prokurorët arritën në konkluzionin se GC-ja kishte vdekur për shkaqe natyrore.

VC-ja, vëllai i GC-së i drejtoi GJEDNJ-së një padi kundër Rumanisë, në të cilën pretendonte se ishin bërë një numër shkeljesh të KEDNJ-së. VC-ja pretendonte se me vëllanë e tij policia kishte abuzuar duke ushtruar dhunë fizike, se policia nuk kishte mundur të siguronte shërbimin e nevojshëm mjekësor për GC-në, se qeveria kishte dështuar në kryerjen e një hetimi të efektshëm mbi shkaqet që çuan në vdekjen e GC-së, se familja nuk kishte patur një mjet efikas ligjor kundër abuzimeve të policisë dhe se policia e kishte diskriminuar atë për shkak të përkatësisë së tij etnike rome.

Qeveria i mohoi të gjitha akuzat, duke argumentuar se plagët që kishte marrë GC-ja ishin rezultat i aksidentit automobilistik që kishte pësuar në momentin e arrestimit dhe gjendjes së tij të mëparshme shëndetësore. Qeveria paraqiti një numër të dhënash policore dhe raportet mjekësore për të përgënjeshtuar pretendimet, sipas të cilave policia kishte ushtruar dhunën ndaj GC-në dhe se hetimi mbi vdekjen e GC-së nuk kishte qenë korrekt, megjithëse sipas Gjykatës shumë nga dokumentet e parashtruara nga qeveria dukeshin se ishin të falsifikuara apo të sajuara.

#### **Gjykata u shpreh se :**

- (1) qeveria dështoi në dhënien e një trajtimi mjekësor të përshtatshëm për GC-në dhe po kështu, në paraqitjen e ndonjë arsyeje bindëse lidhur me plagët në trupin e GC-së për të përgënjeshtuar pretendimet e VC-së sipas të cilave me GC-në ishte abuzuar duke shkelur thelbin e nenit 2;
- (2) qeveria kishte dështuar në kryerjen e një hetimi të hollësishëm mbi vdekjen e GC-së duke dhunuar kështu anën procedurale të neneve 2

dhe 3;

- (3) abuzimi i rëndë fizik i policisë, i kombinuar me trajtimin jashtëzakonisht mizor ndaj familjes së GC-së nënkuptonin torturë dhe përbënin kështu shkelje të nenit 3;
- (4) VC-së, që përfaqësohej personalisht dhe vajzës së vogël të GC-së iu mohua aksesimi për një mjet efikas në nivel shtetëror kundër abuzimeve të policisë, çka përbënte një shkelje të nenit 13;
- (5) nuk është e nevojshme të përcaktohet nëse qeveria e kishte shkelur nenin 6 (1), sepse këto ankesa gjenden të përshtatshme për t'u shqyrtuar nëse i referohemi detyrimeve të përgjithshme të qeverisë sipas nenit 13 për të garantuar një mjet efektiv ligjor në rastin e shkeljeve që i bëhen KEDNJ-së.
- (6) për shkak të veprimeve të mëparshme, nuk është nevoja të përcaktohet nëse qeveria e ka shkelur nenin 14 lidhur me nenet 2,3 dhe 13;
- (7) qeveria duhet të paguajë një dëmshpërblim në të holla prej 3.030 Eurosh për VC-në, një dëm jopasuror prej 10 000 Eurosh për VC-në dhe një shumë prej 35000 Eurosh, të administruara në mirëbesim, për vajzën e GC-së, si dhe 4 340 Euro për shpenzimet .

## 10

### JETA, VETËVRASJE

#### **Tsintsabadze kundër Gjeorgjisë**

**Vendimi i GJEDNJ-së , 15 shkurt 2011**

***Shkelje e nenit 2- të drejtës për jetën – të KEDNJ-së***

Në 30 shtator 2005, T-ja, një i burgosur në një burg gjeorgjian, u gjet i varur në depon e burgut. Po atë mbrëmje autoritetet e burgut filluan një hetim, që përfshiu një autopsi, grumbullimin e provave nga skena e krimit, dhe marrjen në pyetje e një numri rojesh burgu, të burgosurish të tjerë, shokë të viktimës si dhe prindërit e T-së. Mes provave të grumbulluara ishte edhe një copë litari, i përdorur si lak, karriget mbi të cilat supozohet se kishte qëndruar T-ja për të varur veten dhe një shënim ( i datës 28 tetor 2005), i cili mendohet se ishte shkruar nga vetë T-ja para se të vdiste, për të shpjeguar arsyet e kryerjes së vetëvrasjes. Në 29 tetor 2005 nisi një ndjekje penale publike kundër një personi apo personave të panjohur, të cilët e kishin shtyrë

T-në të kryente vetëvrasje, por prokurori rajonal hoqi dorë nga çështje më 22 nëntor 2005 për arsye të mungesës së provave.

Pala paditëse, nëna e T-së e kundërshtoi vendimin në Gjykatën e qytetit Kutaisi, duke pretenduar se autoritetet e kishin trajtuar vdekjen e T-së si një vetëvrasje qysh nga fillimi dhe se nuk kishin kryer hetimin e duhur. Gjykata e qytetit Kutaisi e hodhi poshtë ankesën e palës paditëse më 9 janar 2006 duke e cilësuar atë të pabazuar. Pala paditëse e apeloj çështjen në Gjykatën e Apelit të Kutaisit, e cila gjithashtu për të njëjtat shkaqe e hodhi poshtë padinë. Pothuajse në të njëjtën kohë zyra e mbrojtësit publik filloi një hetim mbi vdekjen e T-së. Hetimi ngriti çështje të tilla sipas të cilave si provat e mbledhura, ashtu edhe konkluzionet e nxjerra nga hetuesit e mëparshëm, përfshi këtu dëshminë e një të burgosuri (bashkëvuajtsi), i cili pretendonte se e kishte parë T-në të rrihej e të tërhiqej zvarrë në gjendje të fikti në depon e burgut. Ekzaminimi i trupit të T-së tregonte shenjat të një personi që kishte qenë rrahur shumë keq.

Në gusht 2006, pala paditëse i drejtoi GJEDNJ-së një padi kundër Gjeorgjisë, ku pretendonte se T-ja ishte vrarë në burg, se vrasja e tij ishte maskuar e paraqitur si vetëvrasje dhe se shteti kishte dështuar në kryerjen e një hetimi korrekt, duke shkelur kështu, nenin 2 të KEDNJ-së.

Shteti i mbahej mendimit se djali i paditëses kishte kryer vetëvrasje në burg dhe se shteti nuk mbante përgjegjësi për vdekjen e T-së sepse ai nuk mund ta parashikonte vetëvrasjen e tij. Shteti pretendonte gjithashtu se hetimi mbi vdekjen e tij ishte bërë në përputhje me kërkesat e nenit 2, sipas të cilit hetimi filloi menjëherë sapo u zbulua trupi i T-së, se shteti kishte marrë në pyetje gjithë dëshmitarët e mundshëm dhe se ai kishte kryer një ekzaminim mjeko-ligjor. Shteti i përmbahej gjithashtu mendimit se paditësja kishte patur mundësinë të kundërshtonte ndërprerjen e hetimeve para gjykatave të vendit.

#### Gjykata u shpreh se:

- (1) neni 2 (1) jo vetëm e ndalon shtetin që qëllimisht e në mënyrë të paligjshme t'i marrë jetën dikujt, por ai i kërkon gjithashtu shtetit të ndërmarrë hapat e duhur që të sigurojë jetën e personave nën juridiksionin e vet;
- (2) shteti mban përgjegjësinë që me prova të jap shpjegimin e duhur për lëndimet që mund të

pësojë një person gjatë periudhës kur është i ndaluar (arrestuar);

- (3) detyrimi që ka shteti për të mbrojtur jetën në përputhje me KEDNJ-në kërkon një hetim zyrtar efektiv (që duhet të jetë i pavarur dhe objektiv) dhe autoritetet duhet të ndjekin të gjitha linjat e besueshme të hetimit.
- (4) të afërmit duhet të përfshihen në hetim në masën e nevojshme për të garantuar interesat legjitime të tij apo saj;
- (5) hetimi i kryer për çështjen në fjalë kishte mospërputhje dhe mangësi serioze;
- (6) gjetja e vetëvrasjes nga ana e autoriteteve nuk mbështet një hetim të hollësishëm.
- (7) hetimi mbi një vetëvrasje të mundshme ishte i pamjaftueshëm bazuar në akuzat bindëse të ngritura nga pala paditëse.
- (8) shteti dështoi në paraqitjen e provave për të dhënë një shpjegim të kënaqshëm dhe bindës mbi vdekjen e T-së duke shkelur kështu nenin 2;
- (9) paditësja u shpërblye me 15 000 Euro për dëmet- jopasurore dhe me 4 047 Euro për shpenzimet.

## 11

### LËVIZJE; AZIL; JETË, TRAJTIM ÇNJERËZOR DHE POSHTËRUES; MJETE JURIDIKE

#### M.S.S kundër Belgjikës dhe Greqisë

##### Vendimi i GJEDNJ-së, 21 janar 2011

*Shkelje e nenit 3-mbi parandalimin e torturës apo të trajtimit çnjerëzor ose poshtërues- nga Belgjika dhe Greqia dhe e nenit 13- mbi të drejtën për mjete efektive nga të dyja Belgjika dhe Greqia- të KEDNJ-së*

M.S.S., një shtetas afgan ishte përkthyes për forcat ndërkombëtare të stacionuara në Kabul. Në vitin 2008, ai u arratis pas përpjekjes së Talebanëve për ta vrarë. Sapo mbërriti në Greqi, M.S.S.-ja u mbajt në gjendje arresti për një javë dhe më pas u urdhërua të largohej nga vendi M.S.S.-ja nuk aplikoi për azil në Greqi. Menjëherë pasi u lirua,

M.S.S-ja udhëtoi drejt Belgjikës ku edhe kërkoi azil. Autoritetet belge vendosën ta rikthenin M.S.S-në sërish në Greqi dhe të lejonin Greqinë të merrte në shqyrtim kërkesën e tij për azil. M.S.S-ja paraqiti një kërkesë për të pezulluar transferimin e tij në Greqi, por kërkesa iu hodh poshtë. Më 15 qershor 2009 M.S.S-ja u deportua në Greqi, ku u arrestua sërish. Gjatë kohës kur nuk ishte ende i arrestuar, M.S.S-ja ishte i pastrehë dhe flinte në një park.

Në qershor 2009, M.S.S-ja parashtroi një padi pranë GJEDNJ-së, në të cilën pretendonte se Greqia dhe Belgjika kishin shkelur nenet 2, 3 dhe 13 të KEDNJ-së. M.S.S-ja akuzonte Greqinë se nuk i kishte rregulluar kushtet e tij të varfra të jetesës dhe se në kushtet e paraburgimit kishte përjetuar një trajtim poshtëruës. U paraqitën dëshmi sipas të cilave azil-kërkuesit në paraburgim detyroheshin të pinin ujë në WC-ve, se në ambientet e paraburgimit nuk kishte hapësirë të mjaftueshme për të paraburgosurit që të mund të flinin në të njëjtën kohë, se mundësitë për të përdorur WC-në ishin jashtëzakonisht të kufizuara, se të paraburgosurit nuk lejoheshin të bënin ushtrime jashtë dhe nuk kishin as letër higjienike dhe as sapun. M.S.S-ja deklaroi se autoritetet belge dhe greke nuk e morën si duhet në konsideratë kërkesën e tij për azil, si dhe frikën e tij për të mos u rikthyer me forcë në Afganistan. M.S.S-ja deklaroi se duke e kthyer në Greqi, autoritetet belge nuk kishin marrë në konsideratë paaftësinë e procesit të azilit në Greqi si dhe rrezikun e pranishëm që M.S.S-ja mund të rikthehej në Afganistan. M.S.S-ja deklaroi gjithashtu se Belgjika kishte injoruar rrezikun me të cilin M.S.S-së i duhet të konfrontohej me një trajtim poshtëruës në paraburgim dhe të jetonte në kushte çnjerëzore. Dhe së fundi, M.S.S-ja deklaroi se sipas ligjit belge nuk ekzistonte asnjë mjet ligjor, sikurse kërkohet në nenin 13, që do ta lejonte atë të ankohej për shkeljet e pretenduara të neneve 2 dhe 3.

Greqia u përgjigj se M.S.S-ja nuk kishte shfaqur asnjë shenjë se kishte patur një trajtim çnjerëzor ose poshtëruës, se qendrat e akomodimit ishin të pajisura në mënyrën e duhur dhe humane dhe se M.S.S-ja nuk kishte qenë në paraburgim për periudha kohe të gjata.

Nga ana e saj, Greqia pretendonte se statusi si i pastrehë i M.S.S-së ishte rezultat i zgjedhjes dhe mosveprimit të tij dhe se KEDNJ-ja nuk garanton të drejtën për akomodim apo për azil politik. Më tej Greqia u përgjigj se M.S.S-ja kishte neglizhuar në kryerjen e procedurave për të kërkuar azil dhe

se, pavarësisht nga neglizhenca e tij, Greqia kishte ndjekur procedurat e përshtatshme ligjore në shqyrtimin e kërkesës së tij.

Belgjika ishte e mendimit se sipas Rregullores së Dublin-it, ajo nuk mbante përgjegjësi për shqyrtimin e kërkesës së azil-kërkuesit. Belgjika pretendonte gjithashtu se, nuk kishte asnjë informacion që tregonte se M.S.S-ja kishte qenë objekt i keqtrajtimit në Greqi, çka cenonte nenin 3 dhe se M.S.S-ja nuk ishte informuar për këtë në padinë e tij ndaj Greqisë. Belgjika pretendonte gjithashtu se, ajo kishte marrë parasysh mundësinë që M.S.S-ja qysh në kohën kur ndodhej në Greqi kishte mundësi t'i drejtohej GJEDNJ-së.

#### Gjykata u shpreh se:

- (1) Greqia kishte cenuar nenin 3, duke e paraburgosur M.S.S-në në kushte shumë të këqija
- (2) duke qenë se Greqia nuk i kishte kushtuar vëmendjen e duhur vulnerabilitetit të M.S.S-së si azil-kërkues, Greqia cenonte nenin 3 duke dështuar në zbutjen e varfërisë dhe statusit të tij si i pastrehë në këto rrethana;
- (3) Greqia kishte shkelur nenin 13, lidhur me nenin 3, duke shqyrtuar jo si duhet kërkesën e M.S.S-së për azil e duke e ekspozuar atë ndaj rrezikut për deportim në Afganistan;
- (4) Belgjika kishte dhunuar nenin 3 duke e rikthyer M.S.S-në në Greqi, ku një proces i mangët për azil mund ta bënte M.S.S-në objekt të rrezikut për rikthimin e tij në Afganistan;
- (5) Belgjika kishte shkelur nenin 3 duke e kthyer M.S.S-në në Greqi, ku arrestimi dhe kushtet e jetesës se tij shkelnin nenin 3;
- (6) Belgjika kishte cenuar nenin 13, në lidhje me nenin 3, pasi nuk kishte mundur të merrte masat e duhura për M.S.S-në që të kundërshtonte urdhrin për dëbim.
- (7) Greqia duhet t'i paguaj M.S.S-së 1000 Euro si dëm jopasuror dhe 4 725 Euro për shpenzimet.
- (8) Belgjika duhet t'i paguaj M.S.S-së 24 900 Euro për dëmet jopasurore dhe 7.350 Euro për shpenzimet.

## Vendime të Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale (KEDS)

### 1

#### STREHIMI; JETA FAMILJARE

##### Qendra e të drejtave për strehim dhe dëbime kundër Italisë

**Vendimi i KEDS-së (Komitetit Evropian për të drejtat sociale), 25 qershor 2010**

*Shkelje e nenit 16- e të drejtës së familjes për mbrojtje sociale, ligjore dhe ekonomike; -e nenit 19- e të drejtës për të mbrojtur dhe asistuar punëtorët emigrantë; -e nenit 30- e së drejtës për t'u mbrojtur nga varfëria dhe përjashtimi social; -e nenit 31- e të drejtës për strehim-të lidhura me nenin E të RESC-së (Kartës Sociale Evropiane, e rishikuar)*

Qendra e të drejtave për strehim dhe dëbime (QDSD-ja) parashtroi një ankesë pranë KEDS-së më 29 maj 2009, me anë të së cilës pretendonte se gjendja e romëve dhe e sintëve në Itali përbente shkelje të neneve 16, 19, 30 dhe 31 si dhe të nenit E, të marrë së bashku me këto nene, si dhe të Kartës Sociale Evropiane, të rishikuar. Sipas QDSD-së numri i romëve rezidentë në Itali është afërsisht 160 mijë, nga të cilët rreth 70 mijë kanë shtetësi italiane. Pjesa e mbetur janë shtetas nga shtete të tjera apo persona të cilët nuk kanë leje qëndrimi. Gjatë një procesi të mëparshëm, *Qendra Evropiane e të drejtave të romëve (QEDR-ja) kundër Italisë*, KEDS-ja nxori në dhjetor 2005, një vendim sipas të cilit gjendja e strehimit të romëve në Itali shkelte Kartën e Rishikuar.

QDSD-ja pretendonte se qeveria nuk kishte zbatuar si duhet vendimin e *QEDR-së kundër Italisë* dhe kishte ngritur çështje të reja lidhur me “Paktet për siguri” ose “masat e sigurisë”, të miratuara nga qeveria, për të cilat QDSD-ja pretendonte se ishin pjesë e strategjisë së qeverisë kundër romëve dhe sintëve. QDSD-ja pretendonte se qeveria nuk kishte një strategji kombëtare për t'a bërë strehimin të përballeshëm dhe të arritshëm për romët dhe sintët dhe se “masat e sigurisë” përforconin keqperceptimin se të gjithë romët dhe sintët janë “nomadë” dhe i dërgonin ata në kampe të izoluar. QDSD-ja pretendonte gjithashtu se “masat e sigurisë” rezultonin në dhunë kundër romëve dhe sintëve, të

cilët dëboheshin me forcë nga kampet, ndërkohë që qeveria nuk u siguronte atyre asnjë kusht alternativ të përshtatshëm për strehim. QDSD-ja deklaroi se qeveria në mënyrë sistematike i kishte përjashtuar romët dhe sintët nga përfitimet e statusit ligjor dhe nga përfitime të tjera sociale, si dhe i kishte izoluar ata në kampe, duke u mohuar atyre në këtë mënyrë, të drejtën për të marrë pjesë në veprimtari civile dhe politike. QDSD-ja pretendonte gjithashtu se procedurat për identifikimin e romëve dhe të sintëve ishin diskriminuese. QDSD-ja argumentoi gjithashtu se në dekrete të caktuara qeveritare romët dhe sintët zgjidheshin si objektiv për shqetësimet e sigurisë, ç'ka legjitimonte veprimet raciste dhe ksenofobe. QDSD-ja pretendonte, së fundi, se “masat e sigurisë” i jepnin mundësi qeverisë të paracaktonte grupe të tëra personash, si kërcënim për sigurinë publike dhe të justifikonte dëbimin e tyre kolektiv nga Italia, duke shkelur kështu standardet e të drejtave të njeriut.

Qeveria u përgjigj se situata e strehimit është komplekse dhe se, nëse romët dhe sintët nuk dëshirojnë të pranojnë asistencën që u vihet në dispozicion, asnjë strategji e saj nuk do të ishte efektive. Qeveria iu përmbajt mendimit se për të siguruar kushte të përshtatshme strehimi është e nevojshme të ndërmerren hapa përmes financimit të projekteve të veçanta. Po kështu, qeveria bëri me dije faktin se në Itali jetojnë ilegalisht shumë romë e sintë.

Qeveria pretendonte se dëbimet justifikoheshin nëse merreshin parasysh shembujt e punësimeve ilegale apo të shkeljes së interesave individuale apo kolektive. Qeveria pretendonte gjithashtu se autoritetet i respektonin rregullat praktike të procedurës dhe se shumë romë e sintë ishin larguar vetë me iniciativën e tyre. Qeveria u përgjigj se kishte bërë ç'është e mundur për të siguruar strehim të përshtatshëm dhe se, po grumbullonte informacion mbi natyrën dhe masën e nevojave të familjeve rome dhe sinte. Qeveria vuri në dukje se zyra e saj kombëtare kundër diskriminimit racial po përgatiste marrjen e masave për të luftuar diskriminimin racial dhe ksenofobinë ndaj romëve dhe sintëve. Dhe së fundi, qeveria pretendonte se emigrantët që nuk e kanë marrë ende shtetësinë mund të jenë objekt dëbimesh për disa arsye specifike dhe se shtetet janë të autorizuar t'i dëbojnë banorët e ligjshëm, të

cilët rrezikojnë sigurinë kombëtare ose që cenojnë interesin ose moralin publik.

**Komiteti u shpreh se :**

- (1) kushtet e jetesës së romëve dhe sintëve në kampe, të cilat ishin përkeqësuar si rezultat i aplikimit të “masave të sigurisë”, përbëjnë një shkelje të nenit E, i marrë në lidhje me nenin 31 (1);
- (2) praktikat qeveritare të dëbimeve nuk ishin ndërmarrë në respekt të dinjitetit njerëzor, ç’ka cenon nenin E të marrë së bashku me nenin 31 (2);
- (3) dështimi i qeverisë për të ndërmarrë hapat e duhur për të përmirësuar mundësinë e romëve dhe sintëve për strehim si dhe izolimi nga ana e qeverisë të romëve dhe sintëve në kampe përbën një shkelje të nenit E, marrë në lidhje me nenin 31 (3);
- (4) dështimi i qeverisë për të promovuar strehim me qëllim për të luftuar segregacionin dhe varfërinë apo për të lehtësuar dhe inkurajuar mundësitë për pajisjen e romëve dhe sintëve me dokumente identifikimi i kufizonte aftësitë e tyre për të marrë pjesë në proceset e vendim-marrjes dhe çonte në trajtimin diskriminues të tyre, duke shkelur kështu nenin E të marrë së bashku me nenin 30;
- (5) qasja e qeverisë për të mbledhur informacion mbi romët dhe sintët nuk kishte masa mbrojtëse të përshtatshme për të mbrojtur privacinë apo penguar abuzimin me to dhe përbënte një pengesë për mbrojtjen nga arbitrariteti, duke shkelur kështu nenin E të marrë së bashku me nenin 16;
- (6) përdorimi i një retorike politike ksenofobe kundër romëve dhe sintëve përbën një shkelje të nenit E të marrë së bashku me nenin 19 (1);
- (7) gjetja e një shkeljeje të nenit E të marrë së bashku me nenin 31, që i referohet të drejtës për strehim, nënkupton gjetjen e shkeljes së nenit E të marrë së bashku me nenin 19 (4) (c);
- (8) praktikat e lejuara nga ”masat e sigurisë”, veçanërisht praktika qeveritare e dëbimeve kolektive, përfaqësojnë një kuadër ligjor diskriminues që shënjestron romët dhe sintët, duke cenuar kështu nenin E të marrë në lidhje me nenin 19 (8).